

HYRJE

Që nga themelimi i tij, e deri më sot, Bashkimi European (BE) ka kaluar në një varg zhvillimesh të ndryshme, që besoj se mund t'i ndajmë në dy tabore: në zhvillime pozitive dhe zhvillime negative.

Një nga zhvillimet e rëndësishme të viteve të fundit është edhe Brexit – dalja e Britanisë së Madhe nga BE-ja. Kjo ngjarje e papritur shkaktori shumë reagime, ndërkaq tërhoqi vëmendjen e studiuesve dhe hulumtuesve të politikave europiane. Brexit tërhoqi edhe vëmendjen time, duke u bërë temë e hulumtimit tim.

Shtjellimi i temës fillon me historikun e themelimit të BE-së, për të vazhduar me zgjerimin e parë të tij, e më pastaj edhe rrugën e Britanisë së Madhe drejt anëtarësimit në BE.

Në hulumtim, një hapësirë do t'i jap ndikimit të Britanisë së Madhe në zhvillimet brenda BE-së, gjatë periudhës së qëndrimit britanik në BE.

Më tutje, vend të posaçëm në temë zë periudha e fillimit të krizës së daljes së Britanisë së Madhe, fushata dhe votimi, për ta përmbyllur këtë pjesë me bisedimet Britani e Madhe – BE. Këtyre zhvillimeve do t'u qasem me një analizë thelbësore të shkaqeve që çuan deri në këtë dalje të bujshme. Gjithashtu, me një seriozitet të lartë do t'i qasem edhe procesit të vështirë të bisedimeve.

Padyshim se kjo dalje e Britanisë së Madhe nga BE-ja ka lënë gjurmë te të dyja palët, kështu që tema ime nuk mund të konsiderohet si e plotë nëse nuk analizohen edhe pasojat e shkaktuara nga ky zhvillim i papritur.

Në fund, nga ky hulumtim do të mundohem që të jap mendimet e mia rreth temës, duke u bazuar në analizën e materialit të shfrytëzuar.

KAPITULLI I

Nga themelimi i Bashkimit European e deri te anëtarësimi i Britanisë së Madhe

1. Themelimi i Bashkimit European

Filozofët dhe largpamësit, shumë kohë para se Bashkimi European (BE) të bëhej një synim politik, ëndërronin për një arritje të këtillë. Ata e kishin në mendjen e tyre, madje edhe se sim und të dukej. Victor Hugo, për shembull, mendonte se mund të arrihej projekti “Shtetet e Bashkuara të Europës” si frymëzim i idealeve humaniste. Megjithatë, kjo ëndërr u shkërmoq nga luftërat e gjysmës së parë të shekullit XX që e shkatërruan kontinentin e Europës. Mirëpo, Lufta e Dytë Botërore solli në pah një nismë shprese, pasi njerëzit të cilët e kundërshtuan totalitarizmin e periudhës së luftës, ishin këmbëngulës në synimin e tyre të madh – dhënies fund të urrejtjes dhe rivalitetit në Europë. Këta krijuan kushtet e një paqeje afatgjate. Në pesë vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, shetarë të guximshëm si Robert Schuman, Konrad Adenauer, Alcide de Gasperi dhe Winston Churchill u vendosën në ballë të një epoke të re të krijimit të strukturave të reja në Europën Perëndimore. Qëllimi i tyre bazohej në interesa të përbashkëta të vendosura mbi traktate që garantonin sundimin e ligjit dhe barazinë ndërmjet të gjithë shteteve. Emrave të lartpërmendur u parapriu një tjetër personalitet, Jean Monnet, konceptuesi i vërtetë i idesë së një Europe të bashkuar. Duke marrë idenë e Monnet-it, shtetari francez, Robert Schuman, më 9 maj 1950 propozoi zyrtarisht themelimin e Bashkësinë Europiane të Thëngjillit dhe të Çelikut (BETHÇ). Ky propozim synonte vendosjen e prodhimit të thëngjillit dhe të çelikut nën një Autoritet të Lartë. Ishin përkërisht këto dy lëndë të para që u shfryrëzuan për luftë, ndërkaq tani u shndërruan në instrumente të pajtimit dhe të paqes.¹ Kështu, në Paris, më 18 prill 1951 Belgjika, Gjermania, Franca, Italia Luksemburgu dhe Holanda nënshkruan Traktatin e Bashkësisë

¹ Fontaine, P. (2010). *Europe in 12 lessons*, Luxembourg: Publication Office of the European Union, fq. 5.

Europiane të Thëngjillit dhe të Çelikut. Selia Qendrore e BETHÇ-së ishte në Luksemburg.² Institucionet e saj ishin Autoriteti i Lartë, Asambleja e Përbashkët, Këshilli i Posaçëm i Ministrave dhe Gjykata e Drejtësisë. Nga këto institucione, Autoriteti i Lartë kishte parimin inovativ të tiparit mbikombëtar, ndonëse emërimi bëhej nga marrëveshja e qeverive kombëtare. Anëtarët e tij nuk përfaqësonin interesat kombëtare, por betoheshin për ta mbrojtur interesin e përgjithshëm të Bashkësisë si një tërësi.³ Deri këtu erdhi si rezultat i marrjes në konsideratë të ndikimit shkatërrues të Luftës së Dytë Botërore dhe kërcënimit të vazhdueshëm të përplasjes Lindje-Perëndim. Kjo do të thotë se pajtimi franko-gjerman u bë prioriteti kryesor, ndërkaq vendimi i bashkimit të industrive të thëngjillit dhe të çelikut ishte hapi i pare drejt integritimit europian.⁴ Projekti europian ishte një tentim për të tejkaluar konfliktet nacionaliste të gjysmës së parë të shekullit XX. Rivaliteti franko-gjerman nuk guxonte që të ndodh më. E për t'u arritur kjo, një tjetër traktat do të jetë hapi i radhës i forcimit të bashkëpunimit të filluar në vitin 1951. Ky hap do të ndihmojë në forcimin e nocionit të një të ardhme të përbashkët të të gjithë gjashtë shteteve europiane nënshkuresë të traktatit të parë. Në Romë, më 1957 u themelua Bashkësia Ekonomike Europiane (BEE) – pararendësja e Bashkimit Europian. BEE-ja nuk ishte thjeshtë një vazhdimësi e BETHÇ-së, por kishte synime të thellimit të bashkëpunimit në sferën e tregtisë, si dhe në sferën politike. Kjo ambicie e këtij traktati u përshkrua si një ‘bashkim ndonjëherë më i afërt i popujve të Europës’.⁵ Në Romë, gjashtë shtetet anëtare zgjeruan bashkimin e tyre edhe në drejtim të energjisë nukleare, duke themeluar edhe Bashkësinë Europiane të Energjisë Atomike (BEEA). Qëllimet e gjashtëshes europiane ishin përfshirë në Preambulën e traktatit ku thuhet se ‘energjid atomike paraqet një burim të rëndësishëm për zhvillimin dhe gjallërimin e industrisë dhe do të pranojë avancimin e kauzës së paqes’.⁶

² IP/02/898, “Fifty years at the service of peace and prosperity: the European Coal and Steel Community (ECSC) treaty expires”, Brussels, 19 June 2002, https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_02_898 (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

³ REPERES – module 8-0 – explanatory notes – *Birth of the European Union and chronology of the integration* – EN Author & ©: Richard Stock, European Network for Education and Training (EUNET), 2011 English translation: Julie Gratz, Centre européen Robert Schuman, fq: 2.

⁴ FACT SHEETS ON THE EUROPEAN UNION, *The historical development of European integration*, 18 June 2018, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/PERI/2018/618969/IPOL_PERI\(2018\)618969_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/PERI/2018/618969/IPOL_PERI(2018)618969_EN.pdf)

⁵ James, W. (2006). *History of the European Union*, CIVITAS Institute for the Study of Civil Society 2015, fq: 1.

⁶ Handrlica, J. (2018). *The Splendid Durability of the Provisional: A Tribute to Euratom*, in *Croatian Yearbook of European Law&Policy* 14 (2018), fq: 161-162.

2. Anëtarësimi i Britanisë së Madhe në Bashkimin Europain

Kur në maj të vitit 1950 u publikua plani Schuman që synonte sovranitetin e ndarë në sektorë të rëndësishëm ekonomik dhe krijimin e institucioneve mbikombëtare, reagoi Britania e Madhe. Ajo u shpreh e dyshimtë dhe me tone negative. Ministri i atëhershëm i laburistëve, Herbert Morriso pati deklaruar se “nuk është diçka e mire, nuk mund ta bëjmë një gjë të tillë, xehetarët e Durham-it nuk do ta pranojnë këtë, xehetarët e Durham-it të shfrytëzuar si sinonim i klasës punëtore britanike”. Ndërkaq, Kryeministri i mëvonshëm James Callaghan kishte një mendim tjetër. Ai konsideronte se Britania duhej të përfshihej në bisedime. Ky qëndrim u duk si një qasje funksionale për bashkëpunim në disa fusha të posaçme. Mirëpo shtetari britanik Ernest Bevin iu përgjigj Callaghan-it se “ata nuk na duan”. Megjithatë, Bevin mori pjesë në Konferencën e Mesinës më 1955, ndonëse me entuziazëm të dobët dhe pa ndonjë zotim, duke mbajtur qëndrim krejtësisht të kundërt për një komunitet europian. Ai pati deklaruar se “traktati i ardhshëm që ju jeni duke e diskutuar nuk ka gjasa që të arrihet; nëse do të arrihet, nuk do të ketë gjasa që të ratifikohet; nëse do të ratifikohet, nuk do të ketë gjasa të zbatohet. E nëse do të zbatohet, do të jetë krejtësisht i papranueshëm për Britaninë e Madhe”.⁷ Qëndrimet e këtilla të shtetarëve britanikë do të ndryshojnë, kur më 1961 do të kërkojnë që t’i bashkohen BEE-së, por Kryetari i atëhershëm i Francës Charles de Gaulle e kundërshtoi dy here, duke përdorur Veto, të cilës do t’i qasem në vijim të temës. Kjo bëri që anëtarësimi i Britanisë së Madhe të vonohet për një dekadë e më tepër.⁸ Qeverisë laburiste të Clement Attlee-së iu drejtua një ofertë për pjesëmarrje, por Attlee e refuzoi zyrtarisht. Rrjedhimisht gjashtë shtetet europiane, Franca, Gjermania, Luksemburgu, Italia, Belgjika dhe Holanda vazhduan tutje pa Britaninë e Madhe dhe themeluan BETHÇ-në për të cilën diskutuam më lartë. Ata vazhduan një hap më përpara duke u shndërruar në një tregë të përbashkët të përgjithshëm. Më 1957 e nënshkruan Traktatin e Romës duke themeluar Bashkësinë Ekonomike Europiane dhe Bashkësinë Europiane të Energjisë Atomike, mirëpo qeveria konservatore e Anthony Eden nuk e njohu rëndësinë e traktatit duke e refuzuar nënshkrimin, ndonëse ata e kishin biseduar bashkimin me gjashtë shtetet tjera,

⁷ Siddappa Honnapura, V. (2016). *The Relationship between UK and the European Union: From 1945 to BREXIT*, in Romanian Journal of Social Sciences (RJSS), 2016, fq: 58-59.

⁸ Ludlow, P. (2016). *Revisiting the first UK application to the EEC: Does Harold Macmillan’s predicament have any relevance to today’s debate?*, in Mile End Institute: *Britain and the European Union: Lessons from History*, London 2016, fq: 7.

megjithatë vendosën të mos bëhen pjesë e Bashkësisë, duke i vlerësuar planet si tepër ambicioze.⁹ Bashkëpunimi nëpërmjet BEE-së solli frytet e saj për gjashtë shtetet anëtare, duke rimëkëmbur ekonomitë e tyre të pasluftës, mirëpo çështja e anëtarësimit të Britanisë së Madhe në këtë projekt të madh europian shkaktoi përplasje ndërmjet partive politike kryesore britanike, madje edhe brenda tyre. Partia Laburiste konsideronte se politikat ekonomike të BEE-së do të kërcënonin mirëqenien e punëtorëve, ndërkaj Partia Konservatore ishte për një anëtarësim, duke besuar se bashkimi me gjashtë shtetet tjera do të ndihmojnë rritjen ekonomike.¹⁰ Me fjalë tjera, për shumicën, anëtarësimi i Britanisë së Madhe u bë një çështje e parëndësishme, madje e mërzitshme, por për një pakicë të konsiderueshme brenda të dy taboreve, anëtarësimi u bë një nevojë e patjetërsueshme apo një neveri e plotë. Mospajtimi ndërmjet palëve ishte i thellë. Njëra palë konsideronte se vendi i Britanisë së Madhe në Europë është një çështje vitale, ndërkaj pala tjetër konsideronte se kjo çështje është e interesit dhe e rëndësisë së vogël.¹¹ Sidoqoftë, më 1961 Britania e Madhe aplikoi për anëtarësim në BEE. Mirëpo, anëtarësimi i saj, siç u përmend më lartë, u pengua dy here nga Franca, kryetari i së cilës, Charles de Gaulle përdori mekanizmin e Veto-s. Sipas tij, me anëtarësimin e Britanisë së Madhe, brenda Europës dobësohet zëri i Francës. Ai madje konsiderohet se brenda Europës dhe të forcohej edhe ndikimi amerikan, si rezultat i marrëdhënieve të afërta anglo-amerikane. Në vitin 1967 Britania e Madhe provoi sërish anëtarësimin në BEE, mirëpo sërish brenda saj kishte një votë kundër – ajo e Francës.¹² De Gaulle ishte i qartë se ende vazhdonte ta kundërshtonte anëtarësimin e Britanisë së Madhe, duke e konsideruar si “kali trojan për Amerikën”. Për më tepër, ai kishte edhe rezerva të aspektit ekonomik, duke u shprehur se kandidati për anëtarësim kishte një ekonomi mjaft të dobët dhe kjo do ta dëmtonte tejmasë gjashtëshen europiane. Po këtë vit u zhvilluan edhe bisedimet e anëtarësimit të cilat, edhe pse përparuan, përfunduan pa rezultat sepse më 1968 Franca, edhe

⁹ Perisic, B. (2010). *Britain and Europe: a History of Difficult Relations*, Institute for Cultural Diplomacy, Berlin 2010, fq: 4.

¹⁰ London Chamber of Commerce and Industry. (2013). *Help or Hindrance? The value of EU membership to London business*, London 2013, fq: 5.

¹¹ Ludlow, P. (2016). *Revisiting the first UK application to the EEC: Does Harold Macmillan's predicament have any relevance to today's debate?*, in Mile End Institute: Britain and the European Union: Lessons from History, London 2016, fq: 8.

¹² Siddappa Honnapura, V. (2016). *The Relationship between UK and the European Union: From 1945 to BREXIT*, in Romanian Journal of Social Sciences (RJSS), 2016, fq: 60-61.

formalisht, vendosi Veto.¹³ Pengesa ‘de Gaulle’ do të largohet shumë shpejtë, pasi vendin e tij do ta zë një tjetër, Georges Pompidou, i cili kishte një mendim tjetër për Britaninë e Madhe. Pompidou shihte te fqiu i tij verior një aleat të fuqishëm brenda BE-së. Ai ishte në mënyrë të konsiderueshme më pro bashkësive europiane dhe më i hapur për anëtarësimin e Britanisë së Madhe. Pretendentin për anëtarësim, Pompidou e shihte si kundërpeshë ndaj Gjermanisë së fortë ekonomikisht. Ndryshime pati edhe në Britaninë e Madhe ku më 1970, pas kryeministrit laburist Harold Wilson, në qeverisje erdhi Edward Heath nga Partia Konservatore. Kryeministri i ri ishte krejtësisht i përkushtuar ndaj idesë së anëtarësimit të vendit të tij në Europë. Heath kishte mendim ndryshe për Commonwealth-in dhe SHBA-të. Ai deklaronte se Londra duhej “të kthehet më shumë drejt Parisit, Bonit e Romës”. Si rezultat i kësaj qasjeje, më 1970, Britania e Madhe i filloi bisedimet e anëtarësimit.¹⁴

Përfundimisht, më 1973, Britania e Madhe me kryeministër Edward Heath, iu bashkua BEE-së. Propozimi i Heath mori një mbështetje të madhe prej 67%. Megjithatë, anëtarësimi nuk kaloi edhe aq lehtë në zhvillimet e brendshme në Britaninë e Madhe. Grevat, problemet energjetike, rritja e çmimit të naftës dhe inflacioni e shoqëruan periudhën e pasanëtarësimit. Në zgjedhjet e vitit 1974, ish-Kryeministri laburist, Harold Wilson u rikthye në krye të shtetit, duke e kundërshtuar anëtarësimin sipas kushteve të konservatorëve. Përplasjet brendapartiake kishin bërë që Wilson të njoftojë se do të tentojë rinegocim për një marrëveshje më të kënaqshme të cilën do ta hidhte në referendum. Ai shqetësohej për politikën e përbashkëta bujqësore dhe kontributin e vendit të tij në buxhetin e përbashkët. Megjithatë, referendumi rikonfirmoi mbështetjen e anëtarësimit të Britanisë së Madhe në BEE.¹⁵ Bashkë me këtë shtet, BEE-së iu bashkuan edhe Danimarka dhe Irlanda.¹⁶

¹³ Ronek, G. (2013). *Britain's Membership in the European Communities and the European Union*, in POLISH POLITICAL SCIENCE VOL XLII 2013, Poland 2013, fq: 227-228.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Siddappa Honnapura, V. (2016). *The Relationship between UK and the European Union: From 1945 to BREXIT*, in Romanian Journal of Social Sciences (RJSS), 2016, fq: 61-62.

¹⁶ *Enlargement of the European Union An historic opportunity*, 2001, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/archives/pdf/press_corner/publications/corpus_en.pdf

KAPITULLI II

Marrëdhëniet e Britanisë së Madhe në Bashkimin European

Dyshimi britanik për Europën është i shumëllojshëm. Mbase kjo ndodh për shkak të aspektit gjeografik që ka – një komb ujdhesë në skaj të kontinentit. Ky pozicionim ka ndikuar që të krijohet besimi i pengimit të pushtimit që mund të vijë nga kontinenti i Europës, madje Britania e Madhe ndoshta nuk ka besuar ndonjëherë se është pjesë e Europës. Rrjedhimisht, disa festa të rëndësishme të ishullit britanik, siç është ajo e Ditës së Guy Fawkes-it, dëshmojnë se britanikët konsideronin një rrezik që ishullit të tyre u vjen nga kontinenti i Europës.¹⁷

Që nga fillimi, marrëdhëniet e Britanisë së Madhe me procesit e bashkimit europian kanë patur zhvillime për dhe kundër. Të gjithë e kujtojmë fjalimin e famshëm të Winston Churchill në Cyrih të Zvicrës më 1946, megjithëse nuk është e qartë nëse ai e shihte vendin e tij si pjesë të Europës.¹⁸ Shpesh Churchill konsiderohet si një lider pro europian, mirëpo ai deklaroi se “Ne jemi me Europën, por jo nga ajo”, që nënkutpon se kjo nuk do të thotë se një bashkim paraqet shndërrim në europian. Për të, marrëdhëniet e Britanisë së Madhe me Europën ishin po aq të rëndësishme sa me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Por, perandoria e njohur e Britanisë së Madhe me kolonitë nëpër botë u rënuar dhe nga SHBA-të erdhi një këshillë nga ish-kryetari amerikan John F. Kennedy për pasardhësin e Churchill-it, Harold Macmillan. Ndoshta e papritur, por porosia ishte që nëse SHBA-të do të duhej të zgjidhnin ndërmjet Europës së bashkuar dhe një unioni tregar të udhëhequr nga britanikët, atëherë Amerika do të zgjidhte kontinentin, përkatësisht me Europën e bashkuar.¹⁹

Që në fillim të këtij shtjellimi shtohet dilema se përse integrimi europian ka qenë një çështje problematike. E përgjigjja që na çon në qendër të debatit është se kjo çështje ndërlihet me aspektet e sovranitetit, situatës ekonomike dhe politike në Europë. Në Britaninë e Madhe

¹⁷ Jeet, H. *Britain's Long, Tortured Relationship With Europe*, June 24, 2016, <https://newrepublic.com/article/134642/britains-long-tortured-relationship-europe> (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

¹⁸ GED Study, *Costs and benefits of a United Kingdom exit from the European Union*, Bertelsmann Stiftung, Germany 2015, fq: 10

¹⁹ Jeet, H. *Britain's Long, Tortured Relationship With Europe*, June 24, 2016, <https://newrepublic.com/article/134642/britains-long-tortured-relationship-europe> (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

ekziston një besim i palëkundshëm se sovraniteti parlamentar është simbol i ‘lirisë’ dhe i britanizmit.²⁰

Çështjet e sovranitetit ndikuan që Britania e Madhe ta parafytyrojë veten si fituese të Luftës së Dytë Botërore, diçka e kundërt nga shumica e vendeve europiane që ishin okupuar. Gjithashtu, shteti i ujdhesës vazhdonte të besonte se ende e kishte rolin e lojtarit global. Këto dy aspekte e bënë këtë vend që të mos ketë vullnet “t’i bashkohej Europës” në fushën ekonomike, pasi Britania e Madhe e kishte shtetëzuar prodhimin e thëngjillit dhe të çelikut.²¹ Bashkimi i sovraniteve kombëtare, si diçka e nevojshme për të mbajtur BE-në, u pa nga britanikët si një lojë pa fitore, prandaj edhe lindi dilema, kryesisht te elita konservatore, nëse Britania e Madhe duhej ta sakrifikonte mëtej sovranitetin ekonomik për pasuri, dhe nëse e bëte këtë, të humbiste sovranitetin e rëndësishëm politik, rrjedhimisht thelbin e britanizmit.²²

Duke u bazuar nga kjo që u tha më lartë, mund të përfundojmë se Britania e Madhe rrallë here ka patur qasje të butë ndaj integritetit europian, duke e fituar kështu epitetin e të qenët ‘partner i vështirë’. Kjo marrëdhënie tani sikur u karakterizua nga Veto-ja, përplasjet, akuza shantazhi, që Britania e Madhe luan bixhoz me të ardhmen e saj.²³

Britania e Madhe nuk e nënshkroi Traktatin e Romës të vitit 1957, kur gjashtë shtete europiane – Gjermania, Franca, Italia, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu – themeluan Bashkësinë Ekonomike Europiane. Por, duke u mbështetur në politikën tradicionale ‘përça e sundo’, britanikët, më 1960, si kundërpeshë ndaj BEE-së, u bënë pjesë e Asociacionit të Tregtisë së Lirë Europiane (ATLE). Zhvillim ekonomik e nxiti shtetin e ujdhesës që të mendonte të ishte pjesë e një asociacioni, sepse dëshironte që t’u ikte tarifave të jashtme të BEE-së për mallrat britanike. Një motiv tjetër ishte edhe tentimi për penguar formimin e një blloku politik, prandaj Britania e Madhe u reshtua kundër gjashtë vendeve europiane që themeluan BEE-në, për të

²⁰ Baker, D. (2001). *Britain and Europe: The Argument Continues*, in Hansard Society for Parliamentary Government 2001 *Parliamentary Affairs* (2001), 54, fq: 276-277.

²¹ Haagedoorn, S. (2017), *The historical evolution of EU-UK relations*, <https://www.consilium.europa.eu/fr/documents-publications/library/library-blog/posts/the-historical-evolution-of-eu-uk-relations/> (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

²² Baker, D. (2001). *Britain and Europe: The Argument Continues*, in Hansard Society for Parliamentary Government 2001 *Parliamentary Affairs* (2001), 54, fq: 276-277.

²³ Oliver, T. (2015), *Europe's British question: the UK-EU relationship in a changing Europe and multipolar world*, in *Global Society*, 29 (3), fq: 409-426.

realizuar ëndrën e një bashkimi politik. Mirëpo, BEE-ja përparoi, ndërkaq asociacioni ngeci, prandaj Britania e Madhe, më 1963, aplikoi për anëtarësim në BEE.²⁴

Para se të ndodh aplikimi, në pah doli çështja se cili do të ishte roli në Europë i kombit të ujdhesës? Kërkesa për anëtarësim u pa si e motivuar nga frika e izolimit pasi filloi ngritja e bllokut të ri të fortë europian perëndimor. Si rezultat i Luftës së Ftohtë kundër Bashkimit Sovjetik, qeveritë në Paris e Bon, si dhe udhëheqja e bllokut në Bruksel, e vazhduan rrugën drejt një integrimi ekonomik gjithnjë më të afërt.²⁵

Marrëdhëniet Britani e Madhe – BE janë ndikuar edhe nga qëndrimi i vendeve tjera europiane. Në kapitullin e parë të temës që shtjellojmë kemi përmendur se tentimi i parë dhe i dytë i Britanisë së Madhe për anëtarësim në BEE, më 1963 dhe 1967, hasi në Veto-n e kryetarit francez, Charles de Gaulle. Por, me largimin e tij dhe ardhjen e Pompidou-së në krye të Francës, ndryshoi edhe qëndrimi francez ndaj anëtarësimit britanik në BEE.²⁶ Më 1973, në atë që njihet si zgjerimi i parë, Britania e Madhe u anëtarësua në Bashkësinë Ekonomike Europiane. Bashkë me të, në BEE u anëtarësuan edhe Irlanda dhe Danimarka.²⁷

Që në fillim të anëtarësimit, opinion dhe politikanët ishin të ndarë për rëndësinë e hapit të madh britanik – anëtarësimit në BEE. Atëbotë gazeta “the Guardian” kishte shkruar se “në këtë rast duhet të pranohet se një pjesë e madhe e vendit nuk është e mahnitur për këtë arritje. Rrugëtimi në Europë do të jetë me përplasje dhe mosmarrëveshje”. Vetëm dy vite më vonë, më 1975, Britania e Madhe mbajti referendumin e parë në lidhje me anëtarësimin në Bashkësinë Europiane. Në atë kohë shteti udhëhiqej nga një kryeministër laburist, brenda partisë së të cilit kishte një përçarje sepse njëra palë mbante qëndrime të forta kundër Europës. Ndërkaq, konservatorët e udhëhequr nga Margaret Thatcher përkrahnin qëndrëmin në Bashkësi. Madje, Thatcher bëri thirrje për një “Po masive për Europën”. Këtë e shoqëroi edhe me mënyrën e

²⁴ Skidelsky, R. (2018). *The UK was never truly part of the European Union*, <https://www.fnlonon.com/articles/britain-was-never-truly-part-of-the-eu-20180717> (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

²⁵ Moris, C. *12 big moments in the UK-EU relationship*, https://www.bbc.co.uk/news/extra/D6MgynFwGo/12_big_moments_in_UK_EU_relationship (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

²⁶ Shih te KAPITULLI I i temës së magjistraturës, Nga themelimi i Bashkimit European e deri te anëtarësimi i Britanisë së Madhe, 1. Themelimi i Bashkimit European, fq: 4-5.

²⁷ *A growing Community – the first Enlargement*, https://europa.eu/european-union/about-eu/history/1970-1979_en (qasja e fundit: 25 maj 2020)

veshjes së saj me temë europiane. Referendumi rezultoi me 67% për qëndrimin në Bashkësi. Ky zhvillim kaq dramatik nuk e zgjodhi dilemën tashmë të njohur të rolit të Britanisë së Madhe brenda Europës.²⁸

Ky anëtarësim i vonshëm i Britanisë së madhe u shoqërua me vështirësi të pranimit të realitetit të ri dhe të zhvillimeve të reja që do të rrjedhin. Ende ekzistonte ndjesia se anëtarësimi në BEE paraqiste heqje dorë nga roli i madh i vendit në arenën më të gjërë globale. Në të njëjtën kohë, anëtarësimi paraqiste edhe largim nga paqëndrueshmëria e ndikuar nga zhgënjimi i dështimit të alternativës tjetër të bashkimit – Asociacioni i Tregtisë së Lirë Europiane. Kalimi nga një bashkëpunim i tillë në një anëtarësim tjetër, largimi nga tregjet e dikurshme perandorake dhe kriza e shkaktuar e viteve 70 ndikuan që Britania e Madhe të mos e kapë hapin e ngritjes ekonomike që ndodhi në fillim e hershëm të integritetit europian.²⁹

Është e qartë se Britania e Madhe është një komb ujdhesë. Këtu e ka burimin edhe dilema e një qëndrimi dyshues britanik ndaj Europës. Vendi ka jetuar një izolim të shkëlqyer, është mbrojtur nga marina dhe perandoria. Ndërkaq, historiani Vernor Bogdanor anëtarësimin e sheh si një përfundim të izolimit. Sipas tij, kjo periudhë e gjatë ka lënë ndikimin e saj te popullsia britanike e cila nuk dëshiron lidhje me kontinentin europian. Mirëpo, sot, Bashkimi European ka edhe shtete tjera ujdhesë, siç janë Irlanda, Malta e Qiproja, por ata nuk janë aq kundër delegimit të pushtetit në Bruksel. Ndoshta rrënjët e një kundërshtimi britanik për të deleguar pushtetin qenron pikërisht te mentaliteti i tyre prej një kombi ujdhesë që dikur ishte një perandori globale, pasi Britania e Madhe është mësuar që të jep e jo të marrë urdhëra.³⁰

Por, Britania e Madhe nuk ishte një shtet për t'u konsideruar si anëtar i plotë i projektit European. Këndurshimet brenda Bashkësisë do të vijojnë në vitin 1979. Qëllimi i Brukselit ishte që të stabilizohej kursi i këmbimit të monedhave brenda anëtarëve të BEE-së. Ky hap shihet si pararendëse e eurozonës. Në këtë rast, Britania e Madhe vendosi që ta mbrojë monedhën e saj, duke mos u bërë pjesë e Sistemit Monetar European. Disa vite më vonë, më 1983, Partia Laburiste, që në atë vit ishte në opozitë, në fushatën e saj zgjedhore premtoi tërheqje nga BEE-ja, madje pa

28 Kirby, J. *A short history of the long road to Brexit*, <https://www.vox.com/2020/1/31/21083573/brexit-news-boris-johnson-timeline-eu-uk> (qasja e fundit: 30 nëntor 2020)

29 Oliver, T. (2015), *Europe's British question: the UK-EU relationship in a changing Europe and multipolar world*, in *Global Society*, 29 (3), fq: 409-426.

30 Wilson, S. *Britain and the EU: A long and rocky relationship*, (2014) <https://www.bbc.com/news/uk-politics-26515129> (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

e mbajtur një referendum. Zgjedhjet përfunduan me humbjen e laburistëve, rrjedhimisht u besua se marrëdhëniet e Britanisë së Madhe me BEE-në u qetësuan, por nuk ndodhi ashtu me qeverisjen konservatore të Margaret Thatcher.³¹

Në Britaninë e Madhe vazhdonte të mbijetojë për një kohë të gjatë mendimi se ky vend i jepte BEE-së më shumë sesa që merrte. Kontributi financiar i shteteve anëtare ishte i rregulluar në bazë të TVSH-së së secilit shtet anëtar. Pjesëmarrja e Britanisë së Madhe e bazuar në prodhimin e brendshëm bruto, ishte më e lartë krahasuar me anëtarët tjerë, ndërkaq kjo dukej që bëhej më e madhe kur mirej parasysht edhe çështja e bujqësisë. Rreth 70 përqind e buxhetit të BEE-së shkonte te Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB), diçka që zbatonte politika subvencionimi për bujqit dhe programet tjera. Në këtë rast, Britania e Madhe nuk ishte e kënaqur nga ajo që përfitonte prej PPB-së sepse sektori britanik i bujqësisë ishte i vogël. Si rezultat i kësaj të vërtete, në qershor të vitit 1984, qeveria konservatore e Thatcher këmbënguli për një negociim të kthimit të 66 përqind të kontributit të shtetit që ajo udhëhiqte. Bisedimet ishin mjaft të vështira dhe paraqesin një tendosje mjaft të lartë ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BEE-së. Ky zhvillim bëri që Britania e Madhe të mbetet shteti i vetëm me kthim të përhershëm, diçka shtesë ndaj statusit të saj të jashtëm në Europë.³²

Qeverisja e Thatcher u shndërrua në një qeverisje konfrontuese me BEE-në, edhe pse ajo luajti rol udhëheqës në fushatën e qëndrimit të Britanisë së Madhe në Bashkësi, kur më 1975 u mbajt referendumi i parë. Më 1980-tën Thatcher deklaroi se “Ajo çfarë ne kërkojmë është që të na kthehet një shumë e madhe e parave tona”. Duke e nisur fushatën për zvogëlimin e kontributit të Britanisë së Madhe në buxhetin e PPB-së, Thatcher shtoi se “Ne ju bëjmë me dije se thjeshtë nuk mund ta përballojmë”.³³ Gjatë kësaj periudhe të përplasjes, PPB-ja përfshinte 70% të buxhetit të BEE-së, përfitimet e së cilës u ndjenë më tepër në Francë, si shteti me sektorin më të madh bujqësor, ndërkaq Britania e Madhe përfitonte shumë pak.³⁴

³¹ Mackenzie, L. *Britain and the EU: The History of a Not So Special Relationship*, 2018, <https://www.historyhit.com/britain-and-the-eu-the-history-of-a-not-so-special-relationship/> (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

³² Po aty.

³³ Moris, C. *12 big moments in the UK-EU relationship*, https://www.bbc.co.uk/news/extra/D6MgynFwGo/12_big_moments_in_UK_EU_relationship (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

³⁴ Po aty. Politika e Përbashkët Bujqësore ishte një mekanizëm që subvenciononte bujqit dhe stabilizonte çmimin e ushqimit.

Në fillim të viteve 90 të shekullit të kaluar Britania e Madhe iu bashkua Mekanizmit të Kursit të Këmbimit (MKK), një tjetër pararendës i euro zonës, edhe pse kryeministrja Thatcher ishte e rezervuar. Monedha britanike u stabilizua me markën gjermane. Mirëpo, zhvillimet e mëtutjeshme ishin fatale për kryeministren, e cila u detyrua që të japë dorëheqje vetëm një muaj më vonë. Kjo erdhi si rezultat i përçarjes së shkaktuar, si dhe mendimet e polarizuara për Europën.³⁵

Vitet në vijim do të dëshmojnë se në Britaninë e Madhe do të rritet euroskepticizmi. Në shtator të vitit 1992 Britania e Madhe doli nga MKK-ja pasi qeveria nuk arriti që të pengojë dobësimin e monedhës britanike deri nën vlerën më të ulët kufitare. Ky zhvillim njihet si “e premtja e zezë”. Kjo ishte njëra nga çështjet e vështira me të cilat u përball qeveria konservatore e John Major-it. Ai u përball me një kundërshtim të ashpër brenda partisë së tij e që kishte të bëjë me ligjet që duhej t’i hapnin rrugë Traktatit të Maastricht-it – marrëveshja që e formalizoi Bashkimin Europian të sotëm, duke i bashkërenduar sferat e sigurisë, të drejtësisë dhe të politikës së brendshme dhe të jashtme. Ndonëse pati mjaft përplasje, ligjet u votuan dhe në nëntor të vitit 1993 traktati hyri në fuqi. Me këtë rast, situata e kryeministrit Major u rëndua së tepërmi, pasi që kundërshtarët arritën që ta mundin qeverisjen e tij, një ditë para votimit. Pozita e tij u vështirësua së tepërmi kur u publikuan video incizime ku Major i quante “bastardë” kundërshtarët e tij.³⁶

Gjatë periudhës në vazhdim, Britania e Madhe nuk e pranoi monedhën ‘euro’, që u fut në përdorim nga 11 shtetet anëtare, sa ishin më 1999. Shteti ujdhesë nuk iu bashkua as Marrëveshjes së Schengen-it për të hequr kontrollin e brendshëm kufitar ndërmjet shteteve anëtare dhe për të lejuar qytetarët që të lëvizin lirshëm në 25 shtete. Kjo nënkupton se politikanët britanikë e kanë kundërshtuar integrimin e mëtutjeshëm europian drejt një kontrolli më të madh të centralizuar të Europës.³⁷

³⁵ Mackenzie, L. *Britain and the EU: The History of a Not So Special Relationship*, 2018, <https://www.historyhit.com/britain-and-the-eu-the-history-of-a-not-so-special-relationship/> (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

³⁶ Po aty.

³⁷ Nugent, C. (2019). *It's Complicated: From the Roman Empire to Brexit, Britain Has Always Struggled to Define Its Relationship With Europe*, <https://time.com/5563689/britain-europe-relationship-history/> (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

Megjithatë, marrëdhëniet Britani e Madhe – BE kanë pasur edhe prirje pozitive. Në vitin 1962 eksporti britanik në BEE ishte 35%, ndërkaj në vitin 1973 u rrit në 42%. Prirja pozitive është më e forte te importi. Në vitet 1962-1973 përqindja u rrit nga 30% në 43%. Kjo prirje vazhdoi edhe pas anëtarësimit të Britanisë së Madhe në BEE. Marrëdhëniet tregtare Britani e Madhe – BE u thelluan edhe më tutje. Si eksporti, ashtu edhe importi britanik u rrit në rreth 60%. Në fund të viteve 90 të shekullit të kaluar pati një ndërprerje të kësaj prirje, si në eksport, ashtu edhe në import. Më tepër u prek importi, si rezultat i rënies së konkurrencës në Europë, pasi në ndarjen ndërkombëtare të punës u futën edhe pjesëmarrës tjerë, si Kina. Një tjetër ndikim ishte edhe kriza e vazhdueshme në vendet e euro zones.³⁸

Fillimshekulli i ri solli zhvillime të reja në Bashkimin European. Në vitin 2004 ndodhi zgjerimi më i madh i tij deri tani. Dhjetë vende ish-komuniste të Europës lindore dhe qendrore u anëtarësuan në BE. Kryeministri i atëhershëm britanik, Tony Blair e cilësoi këtë si një “mundësi të madhe për Britaninë”. Ai pati deklaruar se “Vendet që vijnë në Europë ndajnë mendimin tone të një Europe të shteteve kombëtare, që punojnë së bashku për të mirën e përbashkët për të gjithë”. Mirëpo, vetëm Britania e Madhe, Irlanda dhe Suedia i hapën dyert e tregut të punës për qytetarët e vendeve të reja anëtare. Kështu, emigrantët e ardhur nxitën debat për emigrimin, lëvizjen e lirë dhe çeljen e kufijve.³⁹

Çështjen e emigrimit e shfrytëzoi më së miri Partia e Pavarësisë e Britanisë së Madhe. Gjatë fushatës zgjedhore, kjo parti e ndërlidhi emigrimin me anëtarësimin në BE. Në zgjedhjet europiane të vitit 2004, kjo parti u radhit e treta, ndërkaj një dekadë më vonë, nën udhëheqjen e Nigel Farage, u radhit e para. Tre vite më vonë u nënshkrua Traktati i Lisbonës. Në krye të Britanisë së madhe ishte Gordon Brown. Ndonëse e nënshkroi traktatin, shteti i tij ishte i ndarë. Kritikët e konsideruan traktatin si kërcënim të mëtutjeshëm të sovranitetit kombëtar, pasi përfshinte elementet kryesore të zbatimit të dështuar të vitit 2004 të Kushtetutës së BE-së. Megjithatë, parlamenti britanik e ratifikoi Traktatin e Lisbonës, edhe pse euroskeptikët ishin tepër të zëshëm. Zëri i tyre nuk u shua as kur në krye të Britanisë së Madhe erdhi David Cameron i Partisë Konservatore, ndonëse u zotua se do t'i shuaj zërat kundër. Në vitin 2013 ai

³⁸ GED Study, *Costs and benefits of a United Kingdom exit from the European Union*, Bertelsmann Stiftung, Germany 2015, fq: 10.

³⁹ Moris, C. *12 big moments in the UK-EU relationship*, https://www.bbc.co.uk/news/extra/D6MgynFwGo/12_big_moments_in_UK_EU_relationship (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

u zotua se, nëse i fiton zgjedhjet, do t'i rinegociojë marrëdhëniet e Britanisë së Madhe me BE-në dhe më pastaj të shpall mbajtjen e një referendumi për qëndrim ose dalje nga BE-ja. Cameroon pati deklaruar se “është koha që të zgjidhet pështja europiane në politikën britanike. I them popullit britnaik: ky do të jetë vendim i juaj”. Në zgjedhjet e vitit 2015 fitoi Partia Konservatore dhe lideri Cameroon ishte i detyruar që të mbajë premtimin. Personalisht ai bëri fushatë për qëndrim të Britanisë së Madhe në BE.⁴⁰

⁴⁰ Moris, C. *12 big moments in the UK-EU relationship*, https://www.bbc.co.uk/news/extra/D6MgynFwGo/12_big_moments_in_UK_EU_relationship (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

KAPITULLI III

Dalja e Britanisë së madhe nga Bashkimi European

1. Fillimi i krizës

Marrëdhëniet e Britanisë së Madhe me Bashkimin European (BE) kanë qenë çështje mjaft të diskutuara, por edhe e polarizuara brenda shoqërisë dhe politikës britanike. Para daljes së Britanisë së madhe, dihet se BE-ja ishte një institucion i 28 shteteve anëtare pjesë e kontinentit të Europës. Struktura e BE-së është një rrjet i institucioneve mbikombëtare të shteteve anëtare që veprojnë nëpërmjet bashkëpunimit për zgjidhje ndrqeveritare. Nëpërmjet ligjeve të homogjenizuara, BE-ja e ka ndërtuar tregun e vetëm, ndërkaq këto logje vlejnë në secilin shtet anëtar. Ndërkaq, ndryshimi më i rëndësishëm thelbësor që ndodhi në BE ishte Traktati i Lisbonës, që hyri në fuqi më 2009, por u nënshkrua dy vite më përpara. Para këtij traktati, si ndryshim thelbësor është bashkimi monetar që ndodhi në vitin 1999, por që u zbatua tërësisht në vitin 2002, megjithëse jo të gjithë shtetet anëtare janë pjesë e këtij bashkimi.⁴¹

Në vitet e fundit, mosbesimi në BE, siç njihet si euroskepticizëm, është rritur vazhdimisht brenda vendeve anëtare të saj. Nga ana tjetër, edhe partitë dhe lëvizjet populiste janë shfaqur në Europë. Krahës shumë qëndrimeve kontraverze, dalja nga BE-ja zë vend të rëndësishëm në programin e tyre politik që e ofrojnë.⁴² Gjithashtu, studiuesit pretendojnë se rritja e paprecedentë e lëvizjeve dhe idealeve populiste është shfaqur në vitet e fundit në shoqëritë e industrializuara. Këto lëvizje synojnë që të lëkundin sferën politike, qo do të thotë se kanë arritur të kenë ndikim në mendimin e publikut, rrjedhimisht e kanë rritur edhe numrin e tyre nëpër kuvendet e vendeve europiane, të Amerikës Latine dhe në SHBA. Besohet se pikërisht ideologjia populiste ndihmoi që në krye të SHBA-së të vijë Donald Trump, por e kundërta ndodhi në Britaninë e Madhe. Këtu, kryeministri David Cameron dha dorëheqje si rezultat i trysnisë së madhe nga populistët e Partisë së Pavarësisë së Britanisë së Madhe (PPBM) të udhëhequr nga Nigel Farage. Rritja e populistëve, si partia e Farage, mund të konsiderohen si shtytësit më të mëdhenj të daljeve nga

⁴¹ Clemens, B. (2014), *IEA Brexit Prize: Britain outside the European Union*, London 2014, fq: 8.

⁴² Taylor, G. (2017), *UNDERSTANDING BREXIT, Why Britain Voted to Leave the European Union*, 2017, fq: 9.

BE-ja. Në këtë grup mund t'i radhisim edhe Frontin Naciona në Francë, Partinë e Lirisë në Holandë, Alternativën për Gjermaninë, Partinë e Lirisë së Austrisë, Ligën Italiane.⁴³

Le t'i kthehemi Britanisë së Madhe, marrëdhënia e së cilës me Bashkimin Europian ka nxitur komentime të konsiderueshme. Daja e këtij shteti anëtar nga BE-ja – e njohur si Brexit – tërhoqi vëmendje të madhe, si në vet Britaninë e Madhe, ashtu edhe në pjesën tjetër të BE-së, e më gjërë. Qarqet britanike, si dhe ato të pjesës tjetër të BE-së, të nxitur nga marrëdhëniet e tendosura, filluan të mendonin se ndoshta një marrëdhënie e re e Britanisë së Madhe me BE-në mund të jetë më e parapëlqyeshme jashtë. Siç u tha edhe më lartë, ky zhvillim konsiderohet se erdhi si rezultat i rritjes së mbështetjes ndaj PPBM-së së Nigel Farage. Edhe anketat e kësaj periudhe tregonin një nivel në rritje të euroskepticizmit, zhvillim që ndodhi edhe si rezultat i qasjes së qeverisë, ndaj ligjeve të BE-së dhe detyrimeve ndaj saj. Në këtë drejtim, një fjalim i kryeministrit David Cameron, në vitin 2013, e ngacmoi situatën dhe zgjoi edhe më shumë vëmendjen për një referendum të ri për dalje ose qëndrim të Britanisë së Madhe në BE. Atëbotë, Cameroun deklaroi se një qeverisje e ardhshme konservatore do të kërkojë rinegocimin e marrëdhënieve të vendit të tij me BE-në, e që do të hidhej në referendum për të marrë mendimin e popullit britanik.⁴⁴ Sipas fjalimit të tij, Cameroun mendonte se BE-ja kishte nevojë për një “ndryshim themelor dhe të arritshëm”. Deklarimi i tij bëri që të kuptohej se ai kishte për qëllim që të gjente një “ujdi të re” për Britaninë e Madhe në BE, e më pastaj të mbahet referendumi ku votuesit do të vendosnin “të qëndrojmë në BE me këto kushte të reja ose të dalim”. Megjithatë, kushtet e synuara ndryshoheshin herë pas here, por morën formën përfundimtare në letrën e nëntorit të vitit 2015, e dërguar nga Donald Tusk, atëbotë kryetar i Këshillit Europian.⁴⁵

Njoftimi i kryeministrit Cameroun për rinegocim të marrëdhënieve të Britanisë së Madhe me BE-në, e më pastaj edhe referendumi, që pritej të ndodhte në vitin 2017, nuk mund të konsiderohet si një veprim i papritshëm ose surprizë sepse anëtari ishullor i BE-së ka patur vështirësi qysh në fillim të integritit europian në vitet 1950. Britania e Madhe e konsideronte

⁴³ Ababaker, A; Njilo, G; Chima, A. (2019), *The Impact of Brexit on the Future of the European Union*, 2019, fq: 8. https://www.researchgate.net/publication/330637924_The_Impact_of_Brexit_on_the_Future_of_the_European_Union (qasja e fundit: 10 tetor 2020)

⁴⁴ Möller, A; Oliver, T. (2014). *The United Kingdom and the European Union: What would a “Brexit” mean for the EU and other States around the World?*, DGAPanalyse, 2014, fq: 9.

⁴⁵ House of Commons Treasury Committee. (2016), *The economic and financial costs and benefits of the UK's EU membership*, First Report of Session 2016–17, 2016, fq: 29.

veten si një fuqi më superiore sesa ajo europiane dhe kjo ndodhi si rezultat i të qenët fituese në Luftën e Dytë Botërore. Veç kësaj, anëtarësimi në BE nuk shihej si një dëshirë e shtetit britanik, por si një nevojë mbijetese e cila u shkaktua nga kriza të shumëta të asaj periudhe. Cameroon e bëri të qartë se për vendin e tij BE-ja ishte “rruga deri në përfundim”, por që ky përfundim nuk ishte “një union gjithnjë më i afërt”. Megjithatë, Britania e Madhe ka dhënë kontributin e saj në BE, edhe pse shpesh në kahje të kundërta. Në shumë raste, ajo ka qenë lojtare konstruktive, duke i dhënë shtytje integritetit europian, por kjo mbase nuk është kuptuar aq mjaftueshëm nga populli britanik. Rrjedhimisht, dështimi që të sqarohet ky kontribut dhe sfidat e keqkuptimit e kanë nxitur rritjen e euroskepticizmit në politikën britanike.⁴⁶

Në rritjen e mosbesimit ka ndikuar edhe situata dhe zhvillimet në BE. Nevoja e ndërmarrjes së hapave shtesë të integritetit për t’u përballur me krizën e euro zonës ka ndikuar në ngritjen e çështjeve tjera, si ajo nëse Britania e Madhe do të vazhdojë drejt integritetit. Dalja në pah e mundësive të reja tregtare, si Azia, apo edhe mundësia e një zone të lirë transatlantike sikur tërhoqi vëmendjen e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Europian, që shpesh është parë edhe si e rrëmbyer nga krizat.⁴⁷

Zhvillimet në BE përmenden edhe nga David Cameroon. Sipas tij, disa ndryshime të ndërthurura në BE janë jashtë “zonës së rehatisë” së Britanisë së Madhe, dhe se këtu ka ndikuar edhe dështimi për t’u konsultuar me popullin britanik rreth ndryshimeve në BE. Cameroon thekson se kjo ka bërë që pëlqimi demokratik i BE-së në Britani të Madhe të ishte tepër i ulët. Më tutje, Cameroon pati deklaruar se injorimi i kësaj gjendje do të ndikonte që të rritej mbështetja për dalje nga BE-ja, dhe se kjo do ta përkeqësonte situatën. Si zgjidhje më të mirë, Cameroon e propozonte konsultimin me popullin, por me qëllimin e vetëm – rinegocimin e marrëdhënieve të vendit të tij me BE-në, për të përcaktuar pozitën e Britanisë së Madhe një një Bashkim Europian në ndryshim. Dhe si përfundim, pasi që të jetë arritur një marrëveshje e re, Cameroon propozoi që e njëjta të hidhej në referendum, ku britanikët do të vendosin për qëndrim, apo dalje nga BE-ja.⁴⁸

⁴⁶ Oliver, T. (2013). *Europe without Britain, Assessing the Impact on the European Union of a British Withdrawal*, SWP Research Paper, Berlin 2013, fq: 7

⁴⁷ Möller, A; Oliver, T. (2014). *The United Kingdom and the European Union: What would a “Brexit” mean for the EU and other States around the World?*, DGAPanalyse, 2014, fq: 9.

⁴⁸ Oliver, T. (2013). *Europe without Britain, Assessing the Impact on the European Union of a British Withdrawal*, SWP Research Paper, Berlin 2013, fq: 7

Çështja e daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja ishte një problem edhe i koalicionit qeveritar të vitit 2010 ndërmjet konservatorëve dhe liberal demokratëve. Nëse konservatorët ishin gjithnjë e më shumë mosbesues ndaj Europës, liberal demokratët ishin eurofilët më të mëdhenjë ndër partitë politike britanike. Disa nga konservatorët madje qartë shpreheshin për dalje nga BE-ja. Megjithatë, duke marrë parasysh kundërshtimin me të cilin u përballën disa qeveri europiane, kur para votuesve e vunë propozim-kushtetutën e BE-së, dhe duke marrë parasysh mundin që BE-ja jepte për t'u forcuar pas krizës financiare të vitit 2008, dukej sikur qeveria britanike nuk do të përballej me shumë kundërshtim për pundësinë e ndryshimit të marrëdhënieve të Britanisë së Madhe me BE-në.⁴⁹ Një tjetër çështje që ka ndikuar në marrëdhëniet e Britanisë së Madhe me BE-në është edhe frika nga humbja e sovranitetit kombëtar dhe nga ndikimi. Kjo ka bërë që vendi ishullor të qëndrojë anash kur në vitet 1950 gjashtë vendet themeluese (Belgjika, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda dhe Gjermania Perëndimore) i hodhën hapat e parë të integritit europian. Vetëm pas 20 vitesh, më 1973 Britania e Madhe iu bashkua gjashtëshes. Siç u tha edhe më lartë, kjo ndodhi si rezultat i përfitimeve ekonomike, por edhe për të patur rolin e saj në formën e integritit. Mirëpo, anëtarësimi nuk e pakësoi dyshimin për BE-në. Britania e Madhe “e përjashtoi veten” nga disa aspekte të rëndësishme të integritit europian, si modhea euro dhe Schengen-i. Euroskeptikët britanikë i kanë shprehur vërejtjet e tyre për BE-në. Sipas tyre, BE-ja ka punuar më shumë për traktate të brendshme sesa ecja me pragmatizëm ndaj çështjeve parësore si: konkurrenca ekonomike, promovimi i politikës së përbashkët energjetike, ose edhe përmirësimi i kapaciteteve mbrojtëse europiane.⁵⁰ Në këto marrëdhënie Britani e Madhe – BE, të shoqëruara me kriza e dyshime, në çështjen europiane u fut edhe debati për migrimin, por çështja kryesore në prag të referendumit ishte ajo e aspektit ekonomik. Megjithatë, në ditën e referendumit, çështja kryesore nuk të ishte nëse populli britanik e pëlqen BE-në, por nëse Britania e Madhe do të rrezikonte që të vazhdonte e vetme tutje.⁵¹

⁴⁹ Curtice, J; Evans, G. *Britain and Europe Are we all Eurosceptics now?*, British Social Attitude 32, NatCen Social Research, fq: 2. https://www.bsa.natcen.ac.uk/media/38975/bsa32_eu.pdf

⁵⁰ Mix, E. D. (2020). *The United Kingdom: Background, Brexit, and Relations with the United States*, 2020, Congressional Research Service, fq: 4.

⁵¹ Leonard, M. (2015). *The British problem and what it means for Europe*, London 2015, European Council on Foreign Relations/128, fq: 6. <https://ecfr.eu/publication/the-british-problem-and-what-it-means-for-europe311252/>

2. Fushata dhe votimi

Traktati i Lisbonës, që erdhi si zëvendësim i atij të Kushtetutës, përmban nenin 50, me të cilin Bashkimi Europian ofron edhe mundësinë e daljes vullnetare të ndonjë shteti anëtar, nëse e dëshiron një gjë të tillë. Klausola e daljes nga BE-ja përcakton se një shtet anëtar duket paraprakisht ta njoftojë Këshillin Europian për dëshirën e tij të daljes nga BE-ja. Në përputhje me kërkesën, edhe Këshilli i përgatit parametrat bazale mbi të cilat një ujdë e daljes duhet të arrihet me shtetin anëtarë. Tutje, këshilli vepron nëpërmjet shumicës së kualifikuar dhe pas sigurimit të pëqimit të BE-së, fillon me përgatitjen e ujdës për BE-në.⁵² Rrjedhimisht, Britania e Madhe duhej të ndiqte këtë rrugë.

Si një vend që kërkoi daljen nga BE-ja, debati politik për Europën, brenda Britanisë së Madhe, u përcaktua nga elita e cila nuk e pëqente Europën, ndërkaq lidërshipi i rrymave politike u pozicionuan ngadalë në të qenët pro-BE-së dhe pro reformave. Megjithatë, ekzistonte një dallimi madh ndërmjet kryeministrit euroskeptik, i cili e udhëhoqi një parti të ndarë në Europë, duke qenë i vullnetshëm të rrezikojë anëtarësinë e vendit të tij, dhe një lideri opozitar të Partisë Laburiste dhe një të Partisë Liberal Demokratike, të cilët gëzonin mbështetjen e madhe të partive të tyre, duke u radhitur në krahun pro-BE-së. Nëse Partia Konservatore vendosi që daljen ta ketë shtyllë qendrore të platformës zgjedhore, Partia Laburiste dhe ajo Liberal Demokratike u shprehën se një referendum për dalje do të vinte në shprehje që të mbështetej vetëm nëse do të kërkohej transferimi i sovranitetit të shtetit në Bruksel. Partitë tjera, të Gjellbërtit, PPBM-ja u shprehën pro daljes. Kishte edhe parti tjera më të vogla që ishin kundër.⁵³

Ndërkohë që tashmë pritej referendumi, analizat bëheshin edhe në aspekt të asaj se çfarë votuesish kishte shoqëria britanike. Në vitet e hershme të viteve 2000, Britania e Madhe kishte votues në rritje të marginalizuar dhe politikisht të pakënaqur. Nga ana tjetër, një shtresë e klasës punëtore me aftësi të ulëta, që ishin të bardhë, vlerat dhe lidhjet e identitetit të të cilëve ishin gjithnjë në kundërshtim me konsensusin e zakonshëm liberal. Rrjedhimisht, ekzistenca e votuesve të këtillë ofronin mundësinë e krijimit të celulave për një lëvizje të re politike. Që të arrihej kjo, këta votues kishin nevojë për një çështje dhe një strukturë politike rreth së cilës do të

⁵² Clemens, B. (2014), *IEA Brexit Prize: Britain outside the European Union*, London 2014, fq: 10-11.

⁵³ Leonard, M. (2015). *The British problem and what it means for Europe*, London 2015, European Council on Foreign Relations/128, fq: 4.
<https://ecfr.eu/publication/the-british-problem-and-what-it-means-for-europe311252/>

mbilidheshin për ta kristalizuar pakënaqësinë e tyre të madhe dhe për t'u mobilizuar në një strukturë me politikat zgjedhore sipas pakënaqësisë së tyre. Ekzistimi i votuesve dhe i strukturave politike të këtilla erdhi në mes të viteve 2000, e ndikuar edhe nga imigrimi i popullsisë së disa vendeve të BE-së drejt Britanisë së Madhe. Kjo ndikoi në rritjene mbështetjes për sfiduesit e rinj politik, që më pastaj u shndërruan në motorin kryesor që e udhëhoqi këtë masë votuesish drejt kundërshtimit të anëtarësimit në BE, kundërshtimit të imigracionit, ndryshimeve etnike, dhe kundër vlerave sociale liberale dhe kosmopolitane, që e kishin mbizotëruar përcaktimin politik.⁵⁴

Një nga partitë që e shfrytëzoi votuesin e këtillë është Partia e Pavarësisë e Britanisë së Madhe (PPBM), e themeluar në vitin 1993, me të vetmin tipar, euroskepticizmin. Në fillim kjo parti nuk pati sukses, por në vitin 2015 arriti majat, duke u bërë partia më e suksesshme në skenën politike. Duke qenë pro daljes nga BE-ja dhe kundër imigracionit, PPBM-ja arriti që ta tërheq votuesin dhe mendimin e ashpër kundër anëtarësimit në BE. E udhëhequr nga Nigel Farage, PPBM-ja arriti të forcohej sidomos pas zgjedhjeve të vitit 2010. Ata madje e tejkaluan Partinë Liberal Demokratike. Anketat politike e nxorën të tretën më të popullarizuar në vitin 2012. Më tutje, kjo parti u fut në këshillat lokal në vitin 2013, ndërkaq fitoi në zgjedhjet e vitit 2014 për Parlamentin European (PE). PPBM-ja arriti që të tërheq dy anëtarë konservatorë të Parlamentit, ndërkaq në vitin 2015, në zgjedhjet e përgjithshme arriti 12.6% të votave kombëtare, por pa ulëse në Parlament, Farage dha dorëheqje. E gjithë kjo, sipas analizave, u arrit kryesisht duke tërhequr votat e konservatorëve social, të cilët nuk kishin ndonjë arsimim të kualifikuar, të cilët paraprakisht kishin votuar për Partinë Konservatore, por ishin të përcaktuar kundër imigracionit dhe anëtarësimit në BE. Ata ishin ndjerrë të pakënaqur me dy partitë kryesore, dhe kjo u shfrytëzua nga PPBM-ja. Kjo rritje e kësaj partie, si dhe euroskeptikët brenda konservatorëve, ndikoi që në vitin 2013 David Cameron-i të zotohet për një referendum, ku do të votohej për anëtarësinë në BE, ose jo. nëse konservatorët do t'i fitojnë zgjedhjet e vitit 2015. Kjo edhe ndodhi. Britania e Madhe u fut në rrugën drejt referendumit, ndërkaq Nigel Farage rimori kreun e PPBM-së, për të udhëhequr fushatën e “daljes”.⁵⁵

⁵⁴ Ford, R; Goodwin, M. (2017). *Britain After Brexit: A Nation Divided*, Journal of Democracy 28 (January 2017), fq: 4.

⁵⁵ Po aty, fq: 7-8.

Siç u tha më lartë, imigracioni ishte një nga pikat kyçe të fushatës për Brexit me të vetmin qëllim – shkaktimin e kundërshtimit të ashpër kundër elitës politike të Europës. Në këtë mënyrë, aspekti i tregtisë, përkatësisht rënia e ekonomisë u la në hije. Argumenti këtu ishte se BE-ja po shndërrohej në një supser shtet që e cenon sovranitetin kombëtar të shtetit. Sipas palës që ishte pro Brexit-it, Britania e Madhe ishte aq e fuqoshme sa të veprojë pa qenë anëtare e ndonjë blloku, dhe se mund të negociojë traktate më të favorshme tregtime. Këtu doli dhe dilema e radhës, nëse ky vend mundej që të siguronte një ujdi tregtie me Europën, e që do t'i mundësonte kontrollini mbi imigracionin dhe qasje preferenciale në tregum e vetëm pa taksa të BE-së prej 500 milionë njerëzish, shtylla kurizore e bllokut më të madh botëror të tregtisë. Megjithatë, kancelarja gjermane, Angela Merkel dhe liderët tjerë të BE-së dëshironin që të parandalonin çarjen e mëtejme të bllokut. Ata ishin të mendimit se nuk duhej lehuar që Britania e Madhe të merrte më të mirën e anëtarësimit, pa vuajtur pasoja. Për më tepër, vota për dalje nga BE-ja tashmë e kishte dëmtuar shumë ekonominë britanike dhe shumë afaristë tashmë e kishin gritur zërin e qetësimit.⁵⁶

Para ditës së referendumit, opinioni britanik u pyet për qëndrimin e tyre, një praktikë që ndodh thajse në të gjithë vendet e botës, kur kemi të bëjmë me votime. Anketat tregonin së rezultat tepër të përafërt, ndërkaq rezultati erdhi mjaft befasues. Nga ana tjetër, ishte e qartë se në atë kohë të pasreferendumit nuk shteti britanik nuk kishte një plan të qartë se cila rrugë do të ndiqej më tutje. Mirëpo, një debat i gjërë u zhvillua edhe për Nenin 50 të Traktatit të Lisbonës – dispozita që ia mundëson një shteti anëtar daljen nga BE-ja. Që të ndodh kjo, shteti anëtar duhet që ta aktivizojë këtë nen. Situata ishte e tillë sa që vonesa e aktivizimit të këtij neni shkaktoi mostolerancë në Bruksel dhe në disa shtete anëtare, por institucionet e BE-së nuk kishin mundësi që ta përshpejtonin këtë veprim që duhej të ndërmerret nga Britania e Madhe. Nga këtu, paralajmërimet ishin të ethshme, sepse politika ishte shndërruar në një të atillë që e papritura tashmë ishte bërë tejet normale. Thersa May e kishte emëruar ministrin David Davis që të vazhdonte me procesin e daljes, që tashmë njihet si Brexit. Sinjalet nga Westminster linin të kuptohej se aktivizimi i nenit 50 nuk do të ndodh para fundit të vitit 2016.⁵⁷

⁵⁶ Huton, R. (2019), *The roots of Brexit*, <https://www.bloomberg.com/quicktake/will-uk-leave-eu> (qasja e fundit: 21 nëntor 2020)

⁵⁷ Beg, I. (2016), *Brexit: Why, What Next and How?*, Brexit: Why, What Next and How? CESifo Forum 2/2016 (June), fq: 35-36

Referendumi Brexit kishte dy fushata përballë njëra-tjetrës. “Britania më e fortë në Europë dhe “Votoni daljen” ishin dy kundërshtarët e ashpër me ideologji të ndryshme – ekonomia kundër imigracionit. Fushata për BE-në u cilësua si krahu që dëshiron të hedh një hap më tutje pa i ditur pasojat e mëtutjeshme, ndërkaq fushata e daljes u cilësua si krahu i marrjes së sërishme të kontrollit. Retorika e fushatës ishte tepër e ashpre. Krahu i qëndrimit kërkonte sa më tepër mbështetje për t’i ikur katastrofës ekonomike, ndërkaq krahu i daljes kërkonte sa më tepër mbështetje të atyre që e kishin frikë imigracionin. Duke trumbetuar pasigurinë ekonomike që do të pasonte Brexit-in, krahu i qëndrimit besonte se do t’i bindë votuesit të zgjedhin status quo-në e të qenët në BE, pasi që tashmë ishte arritur një mendim i lartë se dalja do të shkaktojë krizë ekonomike në vend. Nga ana tjetër, krahu i daljes e prezantoi referendumin si një mundësi unike të marrjes në kontroll të ligjbërjes britanike, të kufijve dhe kufizimin e imigracionit drejt Britanisë së Madhe. Duke marrë parasysh se ekonomia dhe imigracioni e kishin pushtuar hapësirën e analizave në medie, u la të kuptohet se të dy fushatat ishin të suksesshme në fushatë. Ekonomia mori vëmendje më të madhe në javët e para të fushatës, ndërkaq imigracioni mori vëmendje më të madhe në javët e fundit. Për çudo, çështjet tjera, si sovraniteti, siguria, demokracia ishin tejet marginale në raportimin e medieve gjatë referendumit.⁵⁸

Më 23 qershor të vitit 2016, votuesit e Britanisë së Madhe iu drejtuan kutive të votimit. Ata zgjedhën më shumë qëndrimit në BE dhe daljes. 52% e tyre i than PO daljes nga BE-ja, ndërkaq 48% i thanë PO qëndrimit në BE. Ndikimi i referendumit ishte i menjëhershëm. Vlera e funtës britanike pësoi një rënie të thiktë, e ndjekur nga çoroditja dhe pasiguria. Lideri i Partisë Konservatore - njëherit edhe kryeministër – dha dorëheqje duke filluar garën e re brenda kësaj partie për një lider të ri. Kjo votë, e cilësuar si historike, nxori në pah një sërë çështjesh për Britaninë e Madhe, si populizmin dhe idenë e kombit dhe të kombësisë. Gjithashtu, referendumi nxiti edhe një mënyrë analizash se çfarë i motivoi votuesit që të zgjedhin daljen nga BE-ja.⁵⁹ Shumica e votuesve në Angli dhe Uels e mbështetën Brexit-in, veçanërisht në zonat rurale dhe në qytetet e vogla. Shumica e votuesve që e mbështetën qëndrimin në BE ishin në Londër, pastaj në Skotlandë dhe Irlandën e Veriut. Një numër jashtëzakonisht i madh i votuesve të rinj në moshë

⁵⁸ Hobolt, S. (2016). *The Brexit vote: a divided nation, a dividend continent*, Routledge 2016, Journal of European Public Policy, 23 (9), Fq: 1259-1277.

⁵⁹ Abrams, D; Travaglino, A, G. (2018), *Immigration, political trust, and Brexit – Testing an aversion amplification hypothesis*, British Journal of Social Psychology, April 2018, Volume 57, fq: 310.

ishin kundër daljes, ndërkaq votuesit më të moshuar e mbështetën Brexit-in.⁶⁰ Sipas rezultateve zyrtare të Komisionit Elektoral, jo më pak se 72% e britanikëve me të drejtë vote u bënë pjesë e referendumit. Këto të dhëna tregojnë se kjo nuk ishte ndonjë përqindje edhe aq mbresëlënëse, pasi që zgjedhjet e pasluftës, deri në vitin 2001, gjithnjë arritën një dalje prej mbi 70%. Mirëpo, në katër zgjedhjet e fundit të përgjithshme përqindja e daljes në votim ishte tepër e ulët. Në referendumin e fundit të mbajtur para Brexit-it, të thirrur, nëse Dhona e Përbashkët duhet të zgjidhet me votë alternative apo me modelin e tanishëm të sistemit pluralit të anëtarit të vetëm, vetëm 42% dolën në votim. Kjo nënkupton se në referendumin e fundit për daljen nga BE-ja, votuan një numër i madh qytetarësh britanikë me të drejtë vote. Dilema që del në pah nga votuesit në Brexit është nëse kësaj radhe votuan më shumë njerëz se sa në rastet tjera, atëherë a do të thotë kjo se votuesi që arriti në vendet e votimit ishte i ndryshëm? Ndoshta ata që nuk kishin edhe aq interesim për të qenë pjesë e procesit politik të daljes, e konsideruan referendumin si një mundësi për të treguar se ishin të pakënaqur me mënyrën se si ishin qeverisur deri në atë çast, prandaj edhe dolën më masovikisht se në rastet tjera. Kuptohet se është e pritshme që të ketë shumë votues, nëse ata e konsiderojnë referendumin si mënyrë të shprehjes së pakënaqësisë së tyre me mënyrën se si ishin qeverisur në përgjithësi.⁶¹

Shikuar nga këndvështrime të shumëta, rezultati i referendumit të Britanisë së Madhe, për qëndrim ose dalje nga BE-ja, nuk ishte ndonjë befasi. Fillimisht, vlerësohet se opinioni britanik ka qenë votuesi më mosbesues ose më euroskeptik brenda BE-së që nga viti 1973 kur Britania e Madhe u bë anëtare e bllokut evropian, ndërkaq anketat treguan se gara do të jetë mjaft e ashpër dhe rezultati mjaft i ngushtë. Së dyti, ndryshe nga pozicionet pro BE-së në shumicën e vendeve tjera të qeverive të BE-së, figura të rëndësishme të partisë qeverisëse konservatore në Britaninë e Madhe mbajtën qëndrim të ashpër kundër BE-së, duke e ngritur euroskepticizmin britanik në një nivel më të lartë se kurdoherë. Së treti, referendumi për integrimin evropian është mjaft i paparashikueshëm. Shpesh votuesit mund ta kundërshtojnë një propozim që u bëhet nga qeveritë e tyre. Kjo mund të ndodh edhe nëse arrihet një pajtim ndërmjet partive politike kryesore dhe ekspertëve. Së fundmi, porosia populiste kundër qëndrimeve të tanishme politike, që korri sukses

⁶⁰ Mueller, B. (2019). *What Is Brexit? A Simple Guide to Why It Matters and What Happens Next*, <https://www.nytimes.com/interactive/2019/world/europe/what-is-brexit.html> (qasja e fundit: 21 nëntor 2020)

⁶¹ Curtice, J. *The vote to leave the EU*, British Social Attitude 34, NatCen Social Research, fq: 4-5. https://www.bsa.natcen.ac.uk/media/39149/bsa34_brexit_final.pdf

të lartë në fushatën për Brexit, ka ndikuar që populistët të kenë sukses përgjatë Europës. Kjo ka ardhur si rezultat i shqetësimeve ndaj imigracionit, mungesës së mundësive ekonomike, si dhe rritja e urrejtjes ndaj klasës politike. Prandaj, referendumi për Brexit paraqet një ngjarje unike, pasi asnjë shtet deri më tani nuk ka vendosur që ta braktisë BE-në. Nga ana tjetër, padyshim se suksesi i votës që Britania e Madhe të del nga BE-ja paraqet një rezultat të fenomenit të veçantë britanik.⁶²

Rezultati prej 52% ndaj 48%, pro Brexit-tit, erdhi pas një fushate dhjetëjavore që, në njëfarë mënyre nxori në pah dyshimet ndaj globalizimit, duke ngritur çështjet që kanë të bëjnë me pasojat nga një Europë e bashkuar. Më tutje, referendumi tronditi tregjet financiare, shkaktoi rënie të monedhës britanike, pasi që ekzistonte një pasiguri se si do të funksionojë Brexit-i. Ndonse votuesi i moshës së re në Londër dhe votuesit e Skotlandës ishin për qëndrim në BE, sërish fitoi Brexit-i. Nga ana tjetër, referendumi u mbajt pikërisht kur mbështetja për euroskepticizmin u rrit tejmasë, ashtu siç u forcua edhe Partia e Pavarësisë e Britanisë së Madhe, e udhëhequr nga Nigel Farage. Si pasojë e Brexit-it, David Cameron dha dorëheqje nga posti i kryeministrit dhe vendin e tij e zuri Theresa May. Ajo e aktivizoi procesin dyvjeçar të negociatave për daljen e Britanisë nga BE-ja. Çështjet si kuotat e peshkimit, shërbimet financiare, standardet e sigurisë, do të bëheshin pikat kyç të bisedimeve.⁶³ Pas rezultatit të këtillë të referendumit britanik, liderët e BE-s u deklaruan publikisht, duke shprehur keqardhjen e tyre për vendimin e popullit britanik. Madje, Presidenti i Këshillit Europain, Donald Tusk deklaroi se “Nuk ka fshehje faktesh që ne dëshironim një rezultat të ndryshëm”. Kancelarja Angela Merkel e quajti votën “ndarje e rrugëve për Europën dhe procesin e bashkimit të Europës”. Ajo gjithashtu ishte shprehur se marrëdhëniet e ardhshme me Britaninë e Madhe duhet të jenë të afërta dhe bashkëpunuese. Edhe në takimin e liderëve të 27 vendeve të BE-së pas referendumit u tha se ata “ndjenin thellësisht keqardhje” për rezultatin e referendumit, por se e respektojnë vullnetin e popullit britanik.⁶⁴

⁶² Hobolt, S. (2016). *The Brexit vote: a divided nation, a dividend continent*, Routledge 2016, Journal of European Public Policy, 23 (9), Fq: 1259-1277.

⁶³ Huton, R. (2019), *The roots of Brexit*, <https://www.bloomberg.com/quicktake/will-uk-leave-eu> (qasja e fundit: 21 nëntor 2020)

⁶⁴ Ries, P. C; Hafner, M; Smith, D. T; Burwell, G. F; Egel, D; Han, E; Stepanek, M; Shatz, J. H. (2017), *After Brexit, Alternate forms of Brexit and their implications for the United Kingdom, the European Union and the United States*, RAND Europe, fq: 5.

3. Bisedimet për dalje nga Bashkimi European

Që nga referendumi i suksesshëm për daljen e Britanisë së Madhe nga Bashkimi European (BE), vendi u përfshi në diskutimin rreth procesit të tërheqjes së vendit, e që njihet si Brexit. Kjo situatë e futi në krizë qeverinë e ndarë mjaft keq, e cila nuk arrinte që të pajtohej për një qasje ndaj vendimit në kohë paqeje, ndoshta më të rëndësishëm në dekadat e fundit. BE-ja e caktoi 31 janarin e vitit 2020 si datën e daljes së Britanisë së Madhe, ndërkaq kjo çështje shkaktoi tërheqjen e kryeministres Theresa May, pasi që dështoi që të ofronte një pëan që do ta kënaqte partinë e saj, koalicionin e partnerit dhe zyrtarët në Bruksel, kryeqendrën e BE-së. Detyrën e mori pasardhësi i saj, Boris Johnson. Konservatorët e zgjedhën Johnson-in pasi që në të shihnin një kundërshtar të guximshëm të daljes së vendit nga BE-ja, prandaj edhe ia besuan procesin e Brexit-it.⁶⁵ Para se të dorëhiqej, Theresa May deklaroi se “Brexit do të thotë Brexit”, dhe kjo e sqaron më së miri se sa koncept i vështirë ishte. Fushata e referendumit dhe rezultati na bënë të besojmë se ky proces mund të zbatohet në disa skenare të pasdaljes së Britanisë së Madhe. Nga ana tjetër, mungesa e një plani konkret nga qeveria bëri që debati të jetë i gjatë dhe i pasigurtë, duke ofruar dy zgjidhje të mundshme, një Brexit të vështirë apo një Brexit të lehtë.⁶⁶ Se cili version të Brexit-it e kishte si mundësi për ta zgjedhur Britania e Madhe nuk varej nga vet ajo, por nga bisedimet me BE-në, pasi që bëhej fjalë për një gamë bisedimesh të ndërlikuara që përfshinin çështje të shumëta. Britania e Madhe duhej që t’i shkëpuste lidhejt e saj me BE-në, duke biseduar edhe për aspektet e marrëdhënieve të saj të ardhshme me BE-në. Qysh në fillim, palët u shprehën se kishin qëllime që të ketë partneritet pozitiv mes tyre. Besohej se bisedime të vazhdueshme dhe jo të menjëhershme do të paraqisnin disavantazh për Britaninë e madhe, dhe se afati prej dy vitesh e favorizonte BE-në, pasi të gjithë 27 anëtarët duhej që ta miratonin zgjatjen e afatit të daljes. Për britanikët një dalje “pa një ujd” ose një Brexit i vështirë do të ishte situata më e vështirë, me humbje të rëndësishme në aspekt të rritjes ekonomike.⁶⁷

⁶⁵ Mueller, B. (2019). *What Is Brexit? A Simple Guide to Why It Matters and What Happens Next*, <https://www.nytimes.com/interactive/2019/world/europe/what-is-brexit.html> (qasja e fundit: 21 nëntor 2020)

⁶⁶ Addler-Nissen, R; Galpin, C; Rosamond, B. (2017). *Performing Brexit: How a post-Brexit world is imagined outside the United Kingdom*, *The British Journal of Politics and International Relations* 2017, Vol. 19(3), fq: 574.

⁶⁷ Ries, P. C; Hafner, M; Smith, D. T; Burwell, G. F; Egel, D; Han, E; Stepanek, M; Shatz, J. H. (2017), *After Brexit, Alternate forms of Brexit and their implications for the United Kingdom, the European Union and the United States*, RAND Europe, fq: 7-8.

Në fund të marsit të vitit 2017 Britania e Madhe e dorëzoi zyrtarisht kërkesën për dalje nga BE-ja duke u batuar në nenin 50 të Traktatit të Lisbonës. Një ditë më vonë, Britania e Madhe do të bëhej vendi i tretë që nuk do të jetë më anëtare e BE-së.⁶⁸ Në kërkesën që aktivizoi nenin 50 të Traktatit të Lisbonës, qeveria britanike ishte e qartë në synimin e saj se Britania e Madhe nuk do të tentojë që të mbetet pjesë e tregut të vetëm, por do të kërkojë një marrëveshje të tregtisë së lirë me BE-në. Gjithashtu, britanikët kërkuan që çështjet që lidhen me largimin nga BE-ja të negociohen njëkohësisht, duke përfshirë aspektet e marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet të dy palëve. Mirëpo, BE-ja u përgjigj me një qasje tjetër, përkatësisht të vazhdueshme në tri faza të ndara: në fazën e aspekteve të daljes së Britanisë së Madhe, pastaj në përgatitjen e një kornize të marrëdhënieve të ardhshme dhe në përgatitjen e dispozitave transitore. Madje BE-ja këmbënguli që të arrihej përparim i dukshëm para arritjes së ujdise përfundimtare. Kryenegociatori i BE-së, Michel Barnier deklaroi se ndoshta afati mund të ishte më herët se tetori i vitit 2018, pasi duhej miratimi i Parlamentit Europian para se marrëveshja të pranohej nga Këshilli Europian.⁶⁹ Megjithatë, afati i parë u caktua të ishte më 29 mars 2019, dy vite pas dorëzimit të kërkesës zyrtare të Britanisë së Madhe për dalje nga BE-ja. Por, gjërat nuk shkoni siç duhej, si rezultat i ndasive brenda Britanisë së Madhe dhe si rezultat i çështjes së kufirit ndërmjet Irlandës së Veriut (pjesë e Britanisë së Madhe), dhe Irlandës (anëtare e BE-së). Parlamenti britani vazhdimisht refuzoi marrëveshjen e daljes, që u negociua nga, atëbotë, qeveria e kryeministres Theresa May dhe BE-ja, duke kundërshtuar njëkohësisht sekarin “pa një ujdë”. Si rezultat i kësaj, liderët e BE-së e vazhduan afatin e dalës së Britanisë së Madhe deri në 31 tetor 2019. Para kësaj date, BE-ja dhe qeveria e udhëhequr nga Boris Johnson e arritën një marrëveshje tjetër, për të cilën Johnson nuk kishte mbështetje të parlamentit. Prandaj, BE-ja i ofroi Britanisë së Madhe edhe një afat tjetër, atë të 31 janarit 2020, ndërkohë që britanikët vendosën të shkonin në zgjedhje të parakohshme të përgjithshme në dhjetor të vitit 2019. Në këto zgjedhje fitues dolën konservatorët e Johnson-it, duke e mandatuar për bisedime.⁷⁰

⁶⁸ Wolff, B. G. (2019). *The implications of a no-deal Brexit: is the European Union prepared?*, Bruegel, Policy Contribution Issue 2, January 2019, fq: 2.

⁶⁹ Ries, P. C.; Hafner, M.; Smith, D. T.; Burwell, G. F.; Egel, D.; Han, E.; Stepanek, M.; Shatz, J. H. (2017), *After Brexit, Alternate forms of Brexit and their implications for the United Kingdom, the European Union and the United States*, RAND Europe, fq: 7-8.

⁷⁰ Mix, E. D. (2020). *Brexit: Status and Outlook*, Congressional Research Service, fq: 1.

Studiues të ndryshëm u morën me çështjen se çfarë do të përfshihet brenda marrëveshjes së daljes nga BE-ja. Christopher Hillion, për shembull, argumentoi se marrëveshja do të përfshinte aspektet teknike brenda sferave ku BE-ja ka kompetenca ekskluzive siç është tregtia. Tutje, ai shtoi se do në marrëveshje do të përfshihej edhe lëvizja e qytetarëve të shtetit që del nga BE-ja dhe të qytetarëve të shteteve anëtare që gjenden brenda shtetit që del nga BE-ja. Edhe të tjerë u morën me këtë çështje. Chalmers dhe Menon theksuan se marrëveshja e daljes do të përfshijë institucionet e BE-së brenda Britanisë së Madhe, stafi britanik në institucionet e BE-së, aspekte buxhetore. Edmondson, Morris, Saluja e Campbell thanë se në marrëveshje do të përfshihet kontributi buxhetor, çështjet financiare e detaje ende të pazgjidhura. Nga ana tjetër, studiuesit argumentuan se këndvështrimi i BE-së për marrëveshjen do të bazohet në udhëzimet e Këshillit European për Brexit dhe deri diku në zgjidhjen që ofron Parlamenti European (PE). Sipas studiuesve, PE-ja ka të drejtën e Veto-s dhe mund të ndikojë në bisedimet për ujdinë përfundimtare.⁷¹ Ndër çështjet tjera që mendohej se do të përfshihen në marrëveshje ishte edhe kufiri i Irlandës së Veriut, pastaj dispozitat transicional administrative e legale që kanë të bëjnë me bazat ushtarake britanike në Qipro dhe transferimi i materialeve të zbërthyeshme ndërmjet Britanisë së Madhe dhe Euroatomit.⁷²

Le t'i shtjellojmë çështjet e lartpërmendura një nga një. Gjatë kësaj periudhe të qëndrimit të Britanisë së Madhe në BE ka patur një lëvizje të madhe të qytetarëve në të dy drejtimet. Kuptohet se pas Brexit, qytetarët britanikë në BE dhe qytetarët e BE-së në Britani të Madhe janë ata që preken nga dalja e britanikëve. Në këtë drejtim, si Këshilli European, ashtu edhe Parlamenti European deklaruan se rregullimi i të drejtave të qytetarëve është një prioritet i lartë në bisedime. Që të dyja institucionet kërkonin që trajtim të drejtë të qytetarëve dhe të familjeve të tyre të shteteve anëtare të BE-së që jetojnë në Britani të Madhe dhe të qytetarëve dhe familjeve të tyre të Britanisë së Madhe që jetojnë në BE. Qytetart duhej të ishin subjekt i parimit të reciprocitetit, barazisë, simetrisë, mosdiskriminimit. Edhe për Britaninë e Madhe çështja e qytetarëve dhe e familjeve të tyre të shteteve anëtare të BE-së ishte një kartë e fuqishme në bisedime. Kjo u pohua nga Sekretari i Shtetit për Çështje të Tregtisë Ndërkombëtare, Liam Fox.

⁷¹ Wel, M; Wessel, A, R. (2017). *The Brexit Roadmap: Mapping the Choices and Consequences during the EU/UK withdrawal and Future Relationship Negotiations*, CLEER Papers 2017/5, fq: 17-23.

⁷² Ries, P. C; Hafner, M; Smith, D. T; Burwell, G. F; Egel, D; Han, E; Stepanek, M; Shatz, J. H. (2017), *After Brexit, Alternate forms of Brexit and their implications for the United Kingdom, the European Union and the United States*, RAND Europe, fq: 10-18.

Megjithatë, çështja e qytetarëve nuk ka ndonjë garancë të statusit të të drejtave të tyre në një shtet anëtar që vendos të dalë nga BE-ja dhe e kundërta. Këtu palët duhej të kishin kujdes edhe në dispozitat e Kartës së të Drejtave Themelore, si dhe në dispozitat e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Deklarata e Fox shkaktoi shqetësim në BE. Madje Parlamenti European deklaroi se da përdor Veto-n ndaj çdo ujdje, nëse nuk i mbron të drejtat e qytetarve.⁷³

Me daljen Britanis së Madhe nga BE-ja, ekzistonin asete pronësore dhe financiare që duhej të përfshiheshin në marrëveshjen përfundimtare. Kjo u bë një çështje mjaft e vështirë në bisedime. Liderët e BE-së vlerësuan se Britania e Madhe duhej të paguante deri 100 bilionë euro për t'i përmbushur detyrimet buxhetor, të pensione ve dhe të institucioneve, ndërkaq liderët britanikë – që prematuan aspekte financiare – e refuzuan idenë e ujdisë financiare. Nga ana tjetër, buxheti i BE-së është mjaft i ndërlikuar. Kjo do të thotë edhe shumë mundësi për mospajtime për të përlloritur detyrimet e Britanisë së Madhe. Shuma mund të përfshinte Kornizën Shumëvjetore Financiare, detyrimet ndaj Bankës Europiane të Investimeve, programet e posaçme siç është mbështetja e refugjatëve sirianë në Turqi, çmimi i lëvizjes së agjencive të BE-së nga Britania e Madhe, projektet e peshkimit dhe të infrastrukturës, si dhe shpenzime tjera që lidhen drejtpërdrejt me daljen. Gjithashtu, Britania e Madhe do të duhej që të kontribuonte edhe më tutje, nëse do të zgjatej periudha transitore. Duke marrë parasysh të gjitha këto argumente, ekzistonte mundësia e një përplasje të fortë.⁷⁴

Një problem tjetër që doli në pah ishte edhe çështja e kufirit të Irlandës së Veriut. Palët kishin për qëllim që të shmangnin një kufi me kontrole të rrepta doganore dhe infrastrukturë fizike ndërmjet Republikës së Irlandës (shtet anëtar në BE) dhe Irlandës së Veriut (pjesë e Britanisë së Madhe). Kjo bëri që qeveria britanike e udhëhequr nga Theresa May të pajtohej me një dispozitë rezervë në ujdinë përfundimtare. Kjo dispozitë do ta mbante Britaninë e Madhe brenda bashkimit doganor të BE-së deri në arritjen e një marrëveshje për marrëdhëniet tregtare në të ardhmen. Qëllimi ishte që të mbrohej tregtia ndërkufitare dhe të ruhej procesi i paqes në konfliktin e gjatë sektarian në Irlandën e Veriut. Gjithashtu, BE-ja e shihte këtë dispozitë si të patjetërsueshëm për të siguruar që Brexit nuk do t'i shkelte rregullat dhe strukturën e tregut të

⁷³ Wel, M; Wessel, A, R. (2017). *The Brexit Roadmap: Mapping the Choices and Consequences during the EU/UK withdrawal and Future Relationship Negotiations*, CLEER Papers 2017/5, fq: 25-34.

⁷⁴ Ries, P. C; Hafner, M; Smith, D. T; Burwell, G. F; Egel, D; Han, E; Stepanek, M; Shatz, J. H. (2017), *After Brexit, Alternate forms of Brexit and their implications for the United Kingdom, the European Union and the United States*, RAND Europe, fq: 10-18.

vetëm të BE-së. Mirëpo, edhe pse u mendua si diçka pozitive, dispozita rezervë u bë një nga pengesat kryesore të mbështetjes parlamentare në Britaninë e Madhe. Kritikët theksuan se qëndrimi i Britanisë Madhe brenda bashkimit doganor të BE-së do ta pengonte shtetin ishullor që të kishte politikën e saj të pavarur tregtare kombëtare.⁷⁵

Gjykata Europaine e Drejtësisë (GJED) ishte gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i bisedimeve që duhej të merrte formën e re të bashkëpunimit pas daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja. 27 shtetet anëtare dhe Britania e Madhe duhej që të bashkëpunonin në pështje civile, tregtare e kriminale, bashkëpunime administrative dhe në zbatimin e ligjeve. Kjo erdhi si kërkesë e Komisionit European nëpërmjet një direktive. Kërkesë tjetër e tij ishte edhe përpilimi i procedurave të sigurimit të zbatimit të marrëveshjes së daljes së Britanisë së Madhe. Rrjedhimisht, nëse do të kishte mospajtime në të ardhmen për ujdinë financiare, do të duhej të kishte procedura për gjetjen e zgjidhjes. Të gjitha këto procedura duhej që të ishin nën juridiksionin e GJED-së. Direktiva thoshte se edhe çështja e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të BE-së në Britani të Madhe ose e qytetarëve britanikë në BE duhej që të ishte nën juridiksionin e GJED-së, nëse mund të dilte ndonjë mospajtim.⁷⁶

Krahas largimit nga BE-ja, Britania e Madhe largohet edhe nga Bashkësia Europiane e Energjisë Atomike (BEEA). Edhe kjo çështje ishte pjesë e direktivës së Komisionit European për bisedimet, sidomos në aspektin e transferit të materialeve të posaçme të zbërthyeshme. Më tutje, Gjibraltari ishte gjithashtu një çështje për t'u negociuar. Nuk mund të ektë një marrëveshje ndërmjet BE-së dhe Britanisë së Madhe, pa një marrëveshje ndërmjet Spanjës dhe Britanisë së Madhe.⁷⁷

Dy vite e gjysmë pas referendumit ku britanikët i thanë PO daljes nga BE-ja, në fillim të nëntorit të vitit 2018 u arrit marrëveshja. Kryeministrja Theresa May njoftoi se kabineti i saj e ka pranuar planin.⁷⁸ Ky lajm u shoqërua me dy dorëheqjet e para nga kabineti i saj. Sekretari i

⁷⁵ Mix, E. D. (2020). The United Kingdom: *Background, Brexit, and Relations with the United States*, 2020, Congressional Research Service, fq: 4.

⁷⁶ Ries, P. C; Hafner, M; Smith, D. T; Burwell, G. F; Egel, D; Han, E; Stepanek, M; Shatz, J. H. (2017), *After Brexit, Alternate forms of Brexit and their implications for the United Kingdom, the European Union and the United States*, RAND Europe, fq: 10-18.

⁷⁷ Po aty, fq: 10-18.

⁷⁸ Henley, J. (2018). *Theresa May's Brexit deal: everything you need to know*, <https://www.theguardian.com/politics/2018/nov/14/theresa-mays-brexit-deal-everything-you-need-to-know> (qasja e fundit: 22 nëntor 2020)

Shtetit, Dominic Raab dhe sekretarja e Punës dhe e Pensioneve, Esther McVey, u shprehën se nuk mundën ta mbështesin projekt-planin e marrëveshjes së arritur të Brexit-it sepse nuk rezultoi me atë që u vendos në referendum.⁷⁹

Pozicioni i kryeministres Theresa May u vështirësua ende më shumë. Plani i saj i Brexit-it dështoi tri herë që të sigurojë mbështetjen parlamentare për t'u zbatuar. May nuk arriti që t'i sigurojë votat aq të nevojshme as nga Partia Laburiste. Në tentimin e saj të fundit për ta siguruar mbështetjen e nevojshme, May ofroi një referendum të dytë për planin, por sërish u refuzua. E gjendur në një situatë të këtyllë kritike, kryeministrja e dytë femër, pas Margareth Thatcher, në maj të vitit 2019 ofroi dorëheqjen e saj nga drejtimi i qeverisë, duke shprehur keqardhje që nuk arriti ta përmyllte Brexit-in.⁸⁰

Një marrëveshje e re u rinegociua ndërmjet Komisionit European dhe qeverisë së Britanisë së Madhe. Marrëveshja e re, e pranuar nga BE-ja e 27 anëtarëve, përsëriste shumicën e elementeve kryesore të marrëveshjes paraprake të nëntorit të vitit 2018, duke përfshirë:

- garancitë në lidhje me rreth tre milionë qytetarë të BE-së në Britaninë e Madhe dhe rreth një milionë qytetarë britanikë në BE;
- zotimin e Britanisë së Madhe për t'i paguar BE-së rreth 46 bilionë euro garanci buxhetore dhe financiare;
- periudhën transitore që di të zgjatë edhe në vitin 2020 ku Britania e Madhe do të duhej që të respektohte të gjitha rregullat e tregut të vetëm të BE-së deri në negociimin e hapave të radhës për marrëdhëniet e ardhshme.

Dallimi kryesor ndërmjet dy marrëveshjeve ishte Protokoli për Irlandën dhe Irlandën e Veriut. Marrëveshja e re parashihte që Irlanda e Veriut të mbetet nën territorin doganor të Britanisë së Madhe, por praktikisht në bashkimin doganor të BE-së. Rrjedhimisht, Irlanda e Veriut mbetet e lidhur me dispozitat rregulluese të BE-së, duke eliminuar kontrollet rregullatore të tregtisë së mallrave me Irlandën; kontrollet fizike për të siguruar zbatimin e aspekteve doganore do të bëheshin në porte ose pika larg kufirit Irlandë e Veriut-Irlandë, katër vite; katër vite pas hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave, Irlanda e Veriut duhet t'i rinovojë të njëjtat; pas përfundimit

⁷⁹ Crerar, P; Weaver, M. (2018). *McVey and Raab quit as May addresses MPs over Brexit deal*, <https://www.theguardian.com/politics/2018/nov/15/dominic-raab-quits-as-brexit-secretary-over-eu-withdrawal-deal> (qasja e fundit: 22 nëntor 2020)

⁸⁰ *Theresa May resigns over Brexit: What happened?* (2019). <https://www.bbc.com/news/uk-politics-48379730> (qasja e fundit: 22 nëntor 2020)

të periudhës transitore (fundi i vitit 2020), Britania e Madhe, përfshi Irlandën e Veriut, do të dalin nga bashkimi doganor i BE-së dhe do ta kenë politikën e tyre tregtare kombëtare.⁸¹

Me 358 vota “për” dhe 234 vota “kundër”, pas tre vitesh të përplasjes së ashpër brenda tij, në dhjetor të vitit 2019 parlamenti i Britanisë së Madhe e pranoi marrëveshjen e arritur ndërmjet qeverisë së udhëhequr nga Boris Johnson dhe BE-së, duke ia çelur rrugën daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja.⁸² Nga ana tjetër, në janar të vitit 2020, me 621 vota “për” dhe 49 vota “kundër”, edhe Parlamenti European e ratifikoi marrëveshjen e Brexit-it.⁸³

⁸¹ Mix. E, D. (2020). The United Kingdom: *Background, Brexit, and Relations with the United States*, 2020, Congressional Research Service, fq: 4-4.

⁸² Stewart, H. (2019). Brexit: *MPs pass withdrawal agreement bill by 124 majority*, <https://www.theguardian.com/politics/2019/dec/20/brexit-pm-asks-britons-to-move-on-as-mps-debate-withdrawal-bill> (qasja e fundit: 22 nëntor 2020)

⁸³ Brexit: *European Parliament overwhelmingly backs terms of UK's exit*, <https://www.bbc.com/news/uk-politics-51287430> (qasja e fundit: 22 nëntor 2020)

KAPITULLI IV

Pasojat e Brexit ndaj Britanisë së Madhe dhe Bashkimit European

Kanë kaluar 75 vjet që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe 25 vjet që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, por Britania e Madhe vazhdon të jetë në vështirësi për të gjetur baraspeshën e saj në qarqet tradicionale të ndikimit botëror. Vendi ishullor duhet ta gjejë veten ndërmjet partneritetit transatlantik, Europës dhe rrjeteve më të gjëra dypalëshe e shumëpalëshe. Britanikët e kanë të qartë se janë një vend mesatar dhe nuk do të jenë më kurrë dominues ekonomik global, apo rajonal. Të qenët lojtar i fortë në një institucion rajonal nuk paraqet domosdo një mundësi të një ndikuesi të rëndësishëm ndërkombëtar. Kjo situatë bën që Britania e Madhe të konsiderohet si një vend që i është dobësuar ndikimi dhe kjo vjen si shqetësim se ky vend mund të mos ketë marrëdhënie konstruktive me partnerët europianë. Që të mos ndodh një trajtim i këtillë dhe që të mos nënvlerësohet, Britania e Madhe duhet që Europën ta trajtojë si pjesë e rrethit të saj të brendshëm të politikës së jashtme dhe të sigurisë dhe të politikës ndërkombëtare ekonomike. Edhe pse Britania e Madhe konsiderohet si qendër ndërkombëtare, do të ishte gabim që të mendohet se mund të veprojë si e vetme në një rrjet ndërkombëtar konkurent në rritje, sepse kjo sjell edhe pasoja negative.⁸⁴

Tashmë është e qartë se pas votës pro daljes nga BE-ja, marrëdhëniet e ardhshme Britani e Madhe – BE sigurisht se do të kenë situata paqartësie dhe papërcaktimi. Duke e konsideruar këtë në nivel ekonomik, mund të supozohet se kjo do të ndikojë në dobësimin e monedhës britanike, rënien e investimeve të drejtpërdrejta vendore dhe të huaja, si dhe në rritjen e shpenzimeve për huazime. Sa më shumë që gjatë kjo paqartësi pas votës për dalje, aq tepër ndikim negativ mund të ketë, por një gjë të tillë mund ta zbutë qeveria nëse është e qartë në synimet që i ka dhe strategjinë që e zgjedh për të vepruar më tutje. Mirëpo, duhet të kihet parasysh se organizimi i referendumit nuk është i ngjashëm si organizimi i zgjedhjeve. Fituesi i referendumit nuk është udhëheqësi i ardhshëm i qeverisë. Padyshim se qeveria e bën të qartë se respektohet vullneti i elektoratit, por me një afat kohor të arsyeshëm. Mirëpo, në aspekt

⁸⁴ Niblet, R. (2015). *Britain, Europe and the World: Rethinking the UK's Circles of Influence*, Chatham House, London, fq: 32-33.

ekonomik, aktivizimi i Nenit 50 të Traktatit të Lisbonës menjëherë pas votës për dalje paraqet drejtim të gabuar që nuk është në interes të vendit.⁸⁵

Edhe Bashkimi European duhet që të marrë një vendim për marrëdhëniet e reja me Britaninë e Madhe. Ky hap mund të paraqetë një mundësi të re në standardin e bashkëpunimit dhe integritit europian. Nëse marrëdhëniet e reja do të jenë të ngjashme si ato me Norvegjinë dhe Zvicrën, atëherë mundësitë ekzistuese mund që të forcohen. Mirëpo, kritikët ndaj veprimeve britanike thonë se rinegociimi i marrëdhënieve me BE-në paraqet një tentim për të shantazhuar pjesën tjetër të BE-së që t'i pranojnë kushtet britanike. Në këtë drejtim, nuk duhet lënë anash edhe mendimi i euroskeptikëve britanikë të cilët vënë në dilemë atë që e konsiderojnë si zgjidhje e centralizuar e integritit europian. Por, një numër i madh euroskeptikësh dhe pro europianësh, si në Britani të Madhe, ashtu edhe kudo në BE, mbase mund të pajtohen se BE-ja po lëviz në një drejtim të gabuar. Prandaj, çdo arritje pozitive në drejtim të marrëdhënieve të reja ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së mund të paraqet një mbështetje demokratike në vendet tjera anëtare, rrjedhimisht një rënie të shqetësimeve për drejtimin e integritit europian.⁸⁶

Bashkimi European, nëpërmjet Këshillit European ritheksoi përcaktimin që të ndërtojë marrëdhënie të afërta me Britaninë e Madhe, duke mbuluar bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik, si dhe sfera tjera, e posaçërisht ato të luftës kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar, sigurisë, mbrojtjes dhe politikës së jashtme.⁸⁷

⁸⁵ House of Commons Treasury Committee. (2016), *The economic and financial costs and benefits of the UK's EU membership*, First Report of Session 2016–17, 2016, fq: 28.

⁸⁶ Oliver, T. (2013). *Europe without Britain, Assessing the Impact on the European Union of a British Withdrawal*, SWP Research Paper, Berlin 2013, fq: 25.

⁸⁷ Mariani, P; Sacerdoti, G. (2019). *Brexit and trade issues*, European Journal of Legal Studies, Special Issue, fq: 193.

1. Ndikimi ekonomik i menjëheshëm i Brexit

Një çështje thelbësore dhe mjaft e diskutueshme gjatë referendimit ishte nëse Britania e Madhe do të jetë më e forte brenda apo jashtë BE-së. Rrjedhimisht, pjesë e këtij debate ishte edhe standardi i mirëqenies, pra nëse do të ishte më i lartë apo më i ulët. Për më tepër, vëmendje e madhe iu kushtua parave që Britania e Madhe i dërgon në Bruksel, si kontribut në buxhetin e BE-së. Çështja këtu kishte të bëjë nëse këto para do të shpenzoheshin për prioritetet e vendit, një nga të cilat ishte edhe sistemi shëndetësor. Kompetenca ekonomike në këto raste më së shumti vlerësohet duke përdorur një numër të vogël të treguesve makroekonomikë, veçanërisht madhësia dhe shkalla e rritjes ekonomike, pastaj shkalla e papunësisë dhe ajo e inflacionit. Kuptohet se përcaktorët e secilës nga këto variabla janë të ndërlikuar. PBB-ja u godit rëndë nga kriza financiare në vitin 2008 dhe kaloi një kohë e gjatë e forcimit, por Britania e Madhe arriti që të rikthehet dhe të ketë një rendiment të mire ekonomik, pasi papunësia dhe inflacioni mbetën ulët, ndonëse të dhënat e prodhimit ishin zhgënjyese. Mirëpo, inflacioni i ulët dhe e normës së interesit, rritja e ngadalshme ekonomike, rendimenti i ulët prodhues janë diçka e zakonshme në ekonominë më të përparuar, si brenda ashtu edhe jashtë BE-së.⁸⁸

Nga ana tjetër, shumë vende të botës kanë përfitur nga globalizimi ekonomik, që ka reflektuar shpresë në të ardhmen. Hapja e vazhdueshme e tregjeve ndaj investimeve dhe tregtisë, përfshi edhe vlerën teknologjike, e kanë nxitur zhvillimin global. Urbanizimi, qasja më e lehtë në arsimin e vajzave (por edhe djemve), si dhe përmirësimi i qeverisjeve kombëtare gjithashtu e kanë ndihmuar këtë proces globalizimi. Mirëpo, ky proces e ka edhe anën negative, pasi tregjet konkurese krijojnë humbësit dhe fituesit. Qeveritë mundohen që të mbështesin ekonominë kombëtare, duke mbështetur industrinë strategjike nëpërmjet investimeve të ndryshme. Prandaj edhe Britania e Madhe do të duhet që të merret me dobësitë e structures ekonomike të vendit për t'i ikur humbjes nga globalizimi. Krahësuar me fqinjët europianë, ekonomia e Britanisë së Madhe është forcuar nga kriza financiare e vitit 2008-2009. Sipas të dhënave të Fondit Ndërkombëtar Monetar (FMN), Britania e Madhe arriti një ngritje prej 4.3% në vitin 2009, përkatësisht rritje prej 3% të PBB-së në vitin 2014. Nga ana tjetër, ky vend e ka nivelin më të ulët të papunësisë në BE – 5.5%. Kjo rritje ekonomike i tërheq imigrantët nga BE-ja e më tutje.

⁸⁸Menon, A; Armstrong, A; Barnard, C; Begg, I; Portes, J. *A successful Brexit: Four Economic Tests*, The UK in a changing Europe, fq: 7. <https://www.piie.com/system/files/documents/a-successful-brexite-four-economic-tests.pdf>

Kjo do të bëjë që, deri në vitin 2050, Britania e Madhe të bëhet vendi i dytë më i madh me popullsi, pas Gjermanisë.⁸⁹

Çdo hulumtim që kryhet nxjerr në pah shqetisimet e çmimit ekonomik, pasi Britania e Madhe përbën 14.8% të zonës ekonomike të BE-së dhe 12.5% të popullsisë. Tutje, 19.4% e eksportit të BE-së, duke lënë anash tregtinë e brendshme, përfaqësohet nga Britania e Madhe. Prandaj, shumë propozime që kanë të bëjnë me marrëdhëniet pas Brexit-it, për qëndrohen te ruajtja e lidhjeve të afërta ekonomike. Mirëpo, ekziston edhe një shqetësim nga humbja e ndikimit ekonomik të Britanisë së Madhe. Mbështetja e forte për tregtinë e lirë mund të ndikojë në një Bashkim European më proteksionist. Por, duhet të shohim nëse Fraca e Gjermania do ta lejojnë një gjë të këtillë, ndërkaq edhe Komisioni European është duke ndjekur një agjendë tregtie neolibérale. Edhe trysnia nga SHBA-të ose Kina, si dhe nga negociatorët e tregtisë ndërkombëtare mund që bëjnë që BE-ja patjetër të pranojë një agjendë ekonomike të jashtme.⁹⁰

Ndikimi ekonomik pas Brexit-it është diskutuar gjërsisht në prag të referendumit dhe ky debat ka vazhduar edhe më tutje. Ata që ishin për qëndrimin e Britanisë së Madhe në BE dhe Thesari kishin një mendim të përbashkët se qëndrimi në BE ishte përparimtar dhe përfitues për ekonominë, ndërkaq ata që ishin për daljen e Britanisë së Madhe nga BE-ja e mbështetën mendimin se ndërprerja e kontributeve në BE do të ndikojnë në lehtësime tatimore, duke i rritur njëkohësisht shpenzimet e qeveritare, si dhe duke çuar në ngritjen ekonomike të njerëzve.⁹¹ Thesari parashikoi se ndikimi i menjëhershëm pas votës për Brexit do të jetë rënia e menjëhershme ekonomike, ndërkaq parashikimi i Bankës së Anglisë ishte se ekonomia britanike do të vazhdojë të rritet, megjithëse guvernatori Mark Carney pati deklaruar se Brexit do të shkaktojë një rënie teknike. Hulumtimet e vendimmarrjes së afaristëve sugjeruan se disa prej tyre janë duke mos bërë hapa drejt investimeve të pakthyeshme deri sa të qartësohen marrëdhëniet e ardhshme të Britanisë së Madhe me BE-në. Megjithatë, amvisëritë vazhduan me shpenzimet, pasi shumica e atyre që votuan menduan se Brexit do të ketë ndikim pozitiv ekonomik. Prandaj,

89 Niblet, R. (2015). *Britain, Europe and the World: Rethinking the UK's Circles of Influence*, Chatham House, London, fq: 5-7.

90 Oliver, T. (2016). *What impact would a Brexit have on the EU?*, Dahrendorf Analysis, fq: 3.

https://www.dahrendorf-forum.eu/wp-content/uploads/2016/03/Dahrendorf-Analysis_Brexit_Tim_Oliver.pdf

91 Haider Ali Zaidi, S; Xin-Yu, W; Ahmed, S; UR Rehman, S; Sajid, M; Hossein Foroozanfar, M; Ashraf Ali, M. (2017). *Brexit: A review of impact on future of United Kingdom outside the European Union*, IJMRM International Journal of Modern Research in Management, fq: 20.

Komiteti i Politikave Monetare të Bankës së Anglisë ndërmori hapa për të ndaluar normat e interest, për të rritur likuiditetin, pastaj sigurimin e qasjes së bankave të financat e lira për të mbështetur dhënien e tyre të afarizmi dhe amvisëritë.⁹²

Edhe pse Britania e Madhe nuk pësoi recession ekonomik që nga referendumi, megjithatë ka të dhëna që dëshmojnë se ekonomia e vendit është dobësuar më tepër se sa që do të ishte, nëse do të votohej për të qëndruar në BE. Funta pësoi devalvim prej 11%, ndërkaq u shfaqën shenja të mosbesimit të investuesve të huaj në të ardhmen ekonomike të Britanisë së Madhe; rritja ekonomike u bë më e dobët që nga viti 2016, ndërkaq ekonomitë tjera kanë shënuar rritje. Qendra për Reformë Europiane vlerësoi se ekonomia e Britanisë së Madhe ishte 2.5% më e dobët në qershor të vitit 2018, ndërkaq edhe hulumtimet tjera përfunduan se ekonomia e Britanisë së Madhe ishte 2% më e dobët. Hulumtimet treguan se edhe eksporti kishte shënuar rritje të ngadalshme se sa që besohej, nëse vota do të ishte për qëndrimin e Britanisë së Madhe në BE, me një rënie prej 5% të firmave që do të eksportonin në BE. Në situatë të këtilla, qeveritë duhet të jenë transparente që të qartësojnë dhe japin përgjigje për situatë të ngjashme, e posaçërisht për ndikimin e Brexit-it në ekonominë e vendit.⁹³

Në përgjithësi, të gjitha hulumtimet ekonomike sugjeruan se Britania e Madhe ka përfituar nga të qenët anëtare e BE-së në katërdhjetë vitet e fundit. Por, duhet të kihet parasysh se kjo nuk do të thotë se me siguri Brexit do ta dëmtojë ekonomikë britanike, pasi vlerësimi i ndikimeve të ardhshme varet nga një humër supozimesh dhe specifikimesh të qarta se çfarë mund të kishte ndodhur në të kundërtën. Tashmë pritet që Brexit të ndikojë në politikat e brendshme në një numër rrugësh, drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të tërthortë, për shembull duke e rritur përqëndërimin në “politikën industriale”. Nëse politikat e ardhme i shohim nëpërmjet supozimeve të tjera, atëherë edhe rezultati do të vlerësohet në mënyrë të ndryshme. Megjithatë, duhet ritheksuar se para se të ndodh referendumi, vlerësimet më të besueshme sugjeronin se Brexit do të ketë ndikim në rënien e prodhimit, si një pasojë e drejtpërdrejtë edhe në kufizimin e tregtisë dhe të investimeve me pjesën tjetër të BE-së. Veç kësaj, disa analiza treguan se për shkak të ndikimit të tërthortë në tregti dhe investime dhe në konkurrencën e prodhimit, edhe shkalla e

⁹² Tetlow, G; Stojanovic, A. (2018). *Understanding the economic impact of Brexit, Institute for Government*, fq: 8-10.

⁹³ Tetlow, G; Stojanovic, A. (2018). *Understanding the economic impact of Brexit, Institute for Government*, fq: 8-10.

rritjes ekonomike do të jetë më e ulët. Vlerësime të tilla nënkuptojnë gjithashtu se ndikimet që godasin financat publike do të kompensojnë më shumë kontributet e pakësuara në buxhetin e BE-së. Në lidhje me këto anaiza, mbështetësit e Brexit-it dhanë argumente gjitha vlerësimet e tilla janë bërë duke i injoruar përfitimet e mundshme nga dalja e Britanisë së Madhe nga BE-ja.⁹⁴

⁹⁴ Menon, A; Armstrong, A; Barnard, C; Begg, I; Portes, J. *A successful Brexit: Four Economic Tests*, The UK in a changing Europe, fq: 8. <https://www.piie.com/system/files/documents/a-successful-brexite-four-economic-tests.pdf>

2. Investimet e drejtpërdrejta të huaja

Investimet e drejtpërdrejta të huaja (IDH) janë ato investime kur kompani të jashtme themelojnë filialet e tyre në një vend tjetër, duke e zgjeruar strukturën ekzistuese ose duke i marrë kompanitë locale. Në këtë drejtim, Britania e Madhe është një pranues i madh i IDH-ve, që vlerësohet deri në një trilion funta, gjysma e të cilave nga shtetet tjera anëtare të BE-së. Kështu thonë të dhënat e vitit 2015 nga Tregtia dhe Investimet e Britanisë së Madhe. Një numër treguesish përcaktojnë nëse një firmë vendos që të zgjedh një vend tjetër për të investuar. Tregjet e mëdha dhe të pasura kanë prirje që të tërheqin më shumë firma të cilat dëshirojnë që të jenë më afër konsumatorëve të tyre. Prandaj, duke marrë parasysh se Britania e Madhe është një vend me sundim të fuqishëm të ligjit, treg pune fleksibil dhe krah pune të arsimuar, paraqet vend tërheqës për IDH-të, pa marrë parasysh nëse është apo jo në BE, mirëpo anëtarësimi në BE i ulë shpenzimet tregtare dhe të investimeve dhe ky fakt e ka ndikimin e vet në treguesit tjerë të IDH-ve. Që të dihet sa më saktë ndikimi i IDH-ve te rezultati i një shteti, duhet që të shihen edhe treguesit e ndikimit te njerëziri dhe te afarizmi, në pika të shumta të ekonomisë. Për të qenë më të qartë me të dhënat, mund t'i analizojmë ato të Alfaros, i cili e vlerëson ndikimin e ndryshimit në rritjen nga IDH-të në 73 shtete. Sipas këtyre të dhënave IDH-të kanë ndikim pozitiv në rritjen e BPB-së, e posaçërisht në shtetet si Britania e Madhe që kanë një sektor mjaft të zhvilluar financiar.⁹⁵ Duke qenë në këtë situatë, ky vend firma të ndryshme dhe fonde të pavarura mund që të investojnë në Britaninë e Madhe, rrjedhimisht ky vend tërheq imigrantët nga BE-ja e më gjërë. Sipas Konferencës së OKB-së për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD), në vitin 2014, aksionet e IDH-ve brenda Britanisë së Madhe ishin afër 1.7 trilionë dollar, pra ky vend radhitej e dyta pas SHBA-së me 5.4 trilionë dollar, pastaj para Kinës (1.1 trilionë dollarë pa e përfshirë Hong Kongung) dhe Gjermanisë (744 bilionë dollarë).⁹⁶

Vota për të dalë nga BE-ja do të nxisë ngadalësimin e investimeve të huaja. Komiteti i Politikave Monetare shqyrtoi ndikimin e votës pro Brexit-it në IDH-të, duke marrë parasysh se sa është i rëndësishëm anëtarësimi në BE në tërheqjen e këtyre investimeve. Sipas komitetit, anëtarësimi tërheq investimet e huaja sepse kompanitë e ndryshme jashtë BE-së, nëpërmjet

⁹⁵ Dhingra, S; Ottaviano, G; Sampson, Th; Van Reenen, J. (2016). *The impact of Brexit on foreign investment in the UK*, CEP BREXIT ANALYSIS No. 3, fq: 2-3.

⁹⁶ Niblet, R. (2015). *Britain, Europe and the World: Rethinking the UK's Circles of Influence*, Chatham House, London, fq: 5-7.

Britanisë së Madhe, kanë qasje edhe në tregun e BE-së, pa u përballur me tarifa. Nga ana tjetër, edhe të dhënat e Thesarit tregojnë rezultate pozitive të tërheqjes së IDH-ve. Sipas këtyre të dhënave, ky rezultat pozitiv është 35% e IDH-ve nga brenda BE-së, por nuk ka ndonjë rezultat të rëndësishëm nga investime nga vendet që janë jashtë BE-së. Disa të dhëna thonë se tashmë ka investues që i kanë pezulluar programet e tyre investuese në Britaninë e Madhe si pasojë e Brexit-it. Për shembull, më 3 maj 2016, shefi europian i KKR-së, firmës së dytë më të madhe private të fondeve të përbashkëta, është cituar nga the Wall Street Journal, të ketë thënë se KKR-ja nuk do të investojë deri pas referendumit, dhe se nëse Brexit mbështetet, atëherë do t'i transferojnë disa aktivitete në Dublin, Paris, Madrid ose Luksemburg. Edhe një numër kompanishë të jashtme janë deklaruar për angazhimin e tyre afatgjatë në Britaninë e Madhe, pa marrë parasysh rezultatin e referendumit. Për shembull, Siemens ka deklaruar se vendimi për të mbetur në BE do ta bëjë më të lehtë që kompania në fjalë të investojë në Britaninë e Madhe. Edhe nga Toyota Motor Europe janë deklaruar se dalja e Britanisë së Madhe do të shkaktojë sfida shtesë afariste, dhe se qëndrimi në BE do të jetë rezultati më i mirë për veprintarinë e tyre afatgjate. Edhe nga Hitachi kanë pohuar se largimi nga BE-ja krijon paqartësi dhe paqëndrueshmëri në aspekt ekonomik, tregtar dhe prodhimtari, dhe largimi do të ndikonte në stabilitetin e nevojshëm për të vazhduar me rritjen afatgjate të investimeve. Më tutje, në një anketë me 667 kompani ndërkombëtare nga shtatë vende që veprojnë në Britaninë e Madhe, 78% e tyre kanë deklaruar se Brexit do të kishte ndikim negativ në afarizmin e tyre, 6% kanë deklaruar të kundërtën, ndërkaq 60% kanë deklaraur se ndikimi negativ do të jetë edhe në planet për investime në të ardhmen.⁹⁷

Kur flasim për investimet, janë tri gjëra që Britaninë e Madhe e bëjnë të tillë që të ketë ngecje në IDH-të:

- Së pari, Britania e Madhe vetëm nuk do të jetë një platformë tërheqëse eksporti për kompanitë shumëkombëshe sepse nuk bart shpenzime të konsiderueshme të mundshme tarifore dhe jo-tarifore kur eksporton në pjesën tjetër të BE-së.
- Së dyti, kompanitë shumëkombëshe kanë procedura të ndërlikuara furnizimi dhe disa shpenzime bashkërendimi ndërmjet selive qendrore dhe degëve locale. Kjo do të ishte më

⁹⁷ House of Commons Treasury Committee. (2016), *The economic and financial costs and benefits of the UK's EU membership*, First Report of Session 2016–17, 2016, fq: 54-55.

e vështirë nëse, për shembull, Britania e Madhe do të dilte nga BE-ja. Transferimi i stafit ndërmjet kompanive do t'ishte më i vështirë, me kontroll më të rreptë të imigracionit.

- Së treti, pasiguria e formës së bashkëpunimit të ardhshëm ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së do të mund të ndikojë në frenimin e IDH-ve. Kryeministri japonez, Shinzo Abe e sheh Britaninë e Madhe si më pak tërheqëse për investuesit japonezë në të ardhmen. Kjo mund të ndikojë që ekonomia britanike të ngec.⁹⁸

Rritja e Prodhimit Bruto të Brendshëm (PBB) është e ndikuar shumë nga investimet. Edhe investimet e huaja mund të ndikojnë drejtpërdrejtë në të hyrat kombëtare, duke ofruar fonde shtesë për afarizmin, kështu ndihmohet zgjerimi i veprimtarisë së tyre. IDH-të ndihmojnë që në vend të vijnë ide të reja afarizmi. Prandaj, dalja e Britanisë së Madhe nga BE-ja do të ndikojë në tërheqjen e investuesve të huaj. Që të mos ndodh kjo, po japim tri arsye të tjera:

- Lëvizja e lirë e kapitalit – njëra nga katër liritë kryesore të tregut të vetëm të BE-së – ua ka lehtësuar investuesve të shteteve anëtare të BE-së që të investojnë në Britaninë e Madhe.
- Të qenët brenda tregut të vetëm të BE-së e bën Britaninë e Madhe platformë tërheqëse eksporti për kompanitë shumëkombëshe. Në njërën anë mund ta shfrytëzojnë mjedisin tërheqës afarist britanik, e nga ana tjetër ta shijojnë tregtinë pa pengesa me pjesën tjetër të BE-së.
- Veprimi nga një shtet anëtar i BE-së është veçanërisht tërheqës për kompanitë shumëkombëshe që kanë zinxhir të ndërlikuar të furnizimit ose zyra në vendet shtetet tjera anëtare të BE-së. Tregu i vetëm i BE-së, ku stafi lëviz lirshëm ndërmjet shteteve, I ulë shpenzimet e bashkërendimit të këtyre kompanive.

Të dhënat ekzistuese nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe për Zhvillim (OBEZH – OECD) sugjerojnë se të qenët anëtar në BE ka ndikuar në rritjen e IDH-ve në Britaninë e Madhe, duke e zgjeruar qasjen në një treg më të gjërë.⁹⁹

⁹⁸ Dhingra, S; Ottaviano, G; Sampson, Th; Van Reenen, J. (2016). *The impact of Brexit on foreign investment in the UK*, CEP BREXIT ANALYSIS No. 3, fq: 13.

⁹⁹ Tetlow, G; Stojanovic, A. (2018). *Understanding the economic impact of Brexit*, Institute for Government, fq: 14-14.

3. Siguria

Marrëdhëniet Britani e Madhe – BE pas Brexit-it, e që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të sigurisë dhe të mbrojtjes nuk kanë tërhequr shumë vëmendje se sa ujdia e ardhshme tregtare. Të dy palët e kanë theksuar menjëherë nevojën për marrëdhënie të ngushta, ndonëse nuk është arritur ndonjë përparim në hollësitë e bashkëpunimit, si rezultat i çështjeve që ndërlidhen me ujdinë e daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja. Tashmë është pranuar se kjo dalje do të shqetësojë aspektet e bashkëpunimit për sigurinë dhe mbrojtjen europiane. Kjo situatë ndodh në një kohë kur marrëdhëniet transatlantike janë turbulluar si rezultat i paparashikueshmërisë së administratës Trump, pastaj sfida që vjen nga Rusia e Putinit dhe vështirësitë e europianëve që të ndërtojnë një përgjigje të përbashkët ndaj ndikimit ndërkombëtar të Kinës.¹⁰⁰ Mirëpo, që nga referendumi, 27 shtetet anëtare të BE-së janë aktivizuar, duke përpiluar një plan të ri zbatimi për sigurinë dhe mbrojtjen. Strategjia Globale e BE-së ofroi një hartë rrugore për të ardhmen e politikës së jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes së BE-së. Madje, Federica Mogherini, ish-përfaqësuesja e lartë e BE-së dhe zëvendëskryetare e politikës së jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes, e përqafoi me entuziazëm këtë strategji, duke e konsideruar si një mundësi të forcimit të ritmit drejt politikave të sigurisë dhe të mbrojtjes së BE-së.¹⁰¹

Edhe Britania e Madhe duhet të përshtatet në riorganizimin e rendit ndërkombëtar që besohet se nxitet pjesërisht nga globalizimi, fundi i Luftës së Ftohtë, ngritja e Kinës dhe e fuqive të tjera, si dhe trazirat e dhunshme në Lindjen e Mesme. Rusia e Putinit, përplasja SHBA-Kinë për pjesën Azi-Paqësor, Siria, Jemeni, Irani janë gjithashtu situata ku Britania e Madhe, si një vend i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB-së, mund të përfshihet. Tutje, si një anëtar i rëndësishëm i NATO-s, Britania e Madhe duhet të përballet me kriza të shumëta.¹⁰²

Analistët dhe studiuesit tashmë e kanë dokumentuar se Brexit-ti do të ndikojë si në Britaninë e Madhe, ashtu edhe në BE, në sferën e politikës së brendshme dhe të jashtme, në sferat e ekonomisë, tregtisë, imigracionit e sigurisë. Disa zyrtarë të mbrojtjes, përfshi Lord Bramall dhe Jock Stirrup, shfaqën shqetësime për sigurinë kombëtare, e cila, sipas tyre, mund të

¹⁰⁰ The UK in a Changing Europe. (2020). *Brexit: what next?*, fq: 27. <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2020/02/Brexit-what-next-report.pdf>

¹⁰¹ Po aty, fq: 27.

¹⁰² Niblett, R. (2015). *Britain, Europe and the World: Rethinking the UK's Circles of Influence*, Chatham House, London, fq: 9-10.

ndikohej negativisht nga dalja e Britanisë së Madhe nga BE-ja, sepse konsiderojnë se BE-ja është një nga shtyllat e sigurisë britanike. Ministri i Mbrojtjes, Michael Fallon argumentoi se dalja nga BE-ja do ta bëjë Britaninë e Madhe më të cenueshme nga sulmet e jashtme, në aspekt të ndarjes së të dhënave për për kriminelët dhe udhëtarët në luftën kundër terrorizmit.¹⁰³

Britania e Madhe, së bashku edhe me Francën, kanë qenë vendimtare për shumë tentime të BE-së për politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes. Dalja e britanikëve mund të minojë këto tentime të forcimit të pjesës europiane të NATO-s. Si pasojë, Britania e Madhe mund të mbetet shtyllë e vetme e Europës shumëshyllëshe. Rrjedhimisht, Europa mundet që nga shtylla e çështjeve botërore të mbetet një territor i ndarë ndërmjet SHBA-së dhe Azisë. Gjithashtu, Britania e Madhe nuk ka luajtur rol aq konstruktiv sepse frika e sovranitetit dhe rrezikimi i NATO-s kanë bërë që ky vend të jetë i përmbajtur. Duhet të mos harrojmë se marrëdhëniet e jashtme të BE-së, qofshin ushtarake apo të tjera, janë të ndryshme dhe të shtrira. Nëse BE-ja vepron në mënyrë koherente pa Britaninë e Madhe, atëherë duhet të zhvillohet si krah më i fuqishëm i NATO-s, ose si një mundësi tjetër.¹⁰⁴

Tashmë është vlerësuar se fundi i periudhës së tranzitore do të ketë ndërlikime për sigurinë dhe shkëmbimin e të dhënave. Pas kësaj periudhe, Britania e Madhe nuk do të ketë mundësinë që të shfrytëzojë instrumentet e BE-së për policinë dhe bashkëpunimin gjyqësor, përfshirë ndarjen e informative. Në lidhje me shkëmbimin e të dhënave, të njëjtat rregulla do të vlejnë si me shtetet që nuk janë pjesë e BE-së, pra Britania e Madhe nuk do të jetë e detyruar që të veprojë sipas rregullave të BE-së, por çështje të ndryshme varen nga ujdia që duhet të arrihet për parteritetin e të ardhmes.¹⁰⁵

¹⁰³ Ababakr, A; Njilo, G; Chima, A. (2019). *The Impact of Brexit on the Future of the European Union*, fq: 12. ([PDF](#)) [The Impact of Brexit on the Future of the European Union \(researchgate.net\)](#)

¹⁰⁴ Oliver, T. (2016). *What impact would a Brexit have on the EU?*, Dahrendorf Analysis, fq: 3.

¹⁰⁵ Government of Netherlands. (2020). *General overview of the Brexit transition period*, fq: 9. <https://www.government.nl/documents/publications/2020/08/20/graphic-overview-of-brexit-preparations-in-the-netherlands> (qasja e fundit: 7 dhjetor 2020)

4. Politika e jashtme

Politika e jashtme është çështja tjetër që do ta kafshojë Britaninë e Madhe pas Brexit-it. Vendimi për dalje do të ndikojë në ndryshim të diplomacisë britanike. Tashmë ky vend është ngatërruar në periudhën më sfiduese të diplomacisë së tij qysh nga Lufta e Dytë Botërore. Debati i mëtejshëm për politikën e jashtme të Britanisë së Madhe nuk ka ecur më tepër se shpikja e një slogani të ri ‘Britania Globale’. Sekretaria e Jashtme britanike nuk ka dhënë ndonjë sqarim se çfarë do të thotë kjo dhe për pasojë, nuk dihet se si do të riorganizohen marrëdhëniet e jashtme të Britanisë së Madhe, për pos që deri tani janë të ndërthurur me politikat e BE-së në sferën e jashtme dhe të sigurisë, kufijve, azilit, kontrollit ndërkufitar dhe politikave juridike, imigracionit, tregtisë, ndihmës, mjedisit, energjisë dhe zhvillimit. Britanikët janë duke u përballur me përpilimin e politikave të reja që do t’i zëvendësojnë ato që tani për tani i ndjek si shtet anëtar i BE-së.¹⁰⁶

Bashkëpunimi në politikën e jashtme, në sigurinë dhe mbrojtjen është një sferë e rëndësishme, dhe se gjetja e një rruge bashkëpunimi shkakton mjaft trysni ndaj të dyja palëve. Rëndësia më e madhe e politikës së sigurisë dhe të jashtme të BE-së bazohet në bashkërendimin e përhershëm ndërmjet shteteve anëtare. Kjo politikë vazhdon të zbatohet edhe në Britaninë e Madhe gjatë periudhës së tranzicionit, ndonëse i ka braktisur institucionet e BE-së. Ajo nuk merr pjesë më në bashkërendimin e BE-së në Bruksel e as në Kombet e Bashkuara ose në vendet e treta. Edhe kur bëhet fjalë për marrëveshjet me Rusinë, Sirinë, Turqinë, Kinën, Libinë, Iranin dhe Ballkanin Perëndimor, Britania e Madhe nuk është në tavolinën e bisedimeve dhe kjo është e dëmshme për të dyja palët. Mirëpo, sipas Deklaratës Politike, Brukseli dhe Londra suynojnë që të kenë një bashkëpunim afatgjatë dhe ambicioz, që përfshin struktura të formatit konsultativ, pastaj konsultime për sanksione, mundësi të pjesëmarrjes britanike në operacionet e BE-së, ndërtimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe në shkëmbimin e të dhënave nga shërbimet e zbulimit. Por, Londra tashmë ka vepruar në këtë drejtim dhe dëshiron që kjo të bëhet pa ndonjë bashkëpunim të institucionalizuar për politikë të jashtme dhe të sigurisë me BE-në. Në përputhje me rrethanat, qeveria britanike ka vendosur që bashkëpunimin ta zhvendos në aspekt dypalësh e shumëpalësh, sidomos me Parisin, Berlinin e Varshavën, pa lënë anash NATO-n. Ky veprim është sfidues edhe për Gjermaninë si vend i vetëm, sepse do të duhet që ta peshojnë interesin e

¹⁰⁶ The UK in a Changing Europe. (2016). *Brexit: six months on*, fq: 20. <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2016/12/Brexit-Six-months-on.pdf>

mbajtjes së Britanisë së Madhe të angazhuar në politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së, në rastet si Irani, duke synuar forcimin e BE-së si një actor në politikën e jashtme.¹⁰⁷

Britania e Madhe ka marrëdhënie “të posaçme” me Shtetet e Bashkuara e që në nivele të ndryshme janë themeli i politikës së jashtme britanike, ndonëse që nga vitet 1940 kanë patur edhe ulje-ngritje. Shpesh ky vend konsiderohet si zëri udhëheqës në formimin e politikës së jashtme të SHBA-së. Statusi i Britanisë së Madhe i të qenët aleati i ngushtë i SHBA-së ka ndikuar që të zgjerohet ndikimi i saj global. Nga ana tjetër, përkrahja britanike për SHBA-të e ka ndihmuar këtë të dytën që të ketë besueshmëri dhe peshë ndërkombëtare në nismat e saj. Partneriteti Britani e Madhe-SHBA i ka ndihmuar interes të përbashkët në organizatat si OKB e NATO, si dhe në institucionet tjera shumëpalëshe. Britania e Madhe vazhdon që ta sheh SHBA-në si partner të ngushtë dhe kërkon që ta forcojë ende më shumë pas Brexit-it. Zhvillimet pas referendumi në aspekt të rolit global dhe të ndikimit të Britanisë së Madhe mund të kenë pasojë, duke e perceptuar këtë vend si një partner të efektshëm apo të dobët të SHBA-së. Presidenti Trump tashmë e ka shprehur mendimin e tij pozitiv për Britaninë e Madhe dhe në qershor të vitit 2019 e realizoi vizitën e parë zyrtare. Madje, Trump e ka mbështetur shumë Brexit-in, duke i konsideruar liderët Boris Johnson e Nigel Farage si miq të tij personal, e duke e kritikuar kryeministren Theresa May për trajtimin e Brexit-it. Në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 2019 në Britani të Madhe, Donald Trump e mbështeti kryeministrin e tanishëm, Boris Johnson.¹⁰⁸ Edhe zyrtarë tjerë dhe anëtarë të Kongresit amerikanë e shohin Britaninë e Madhe si aleatin më të ngushtë dhe më të besueshëm. Kjo vjen si rezultat i shumë faktorëve të ndërthurur, përfshi mendimin e një historie të përbashkët, vlere, culture, marrëdhënie e gjërë dhe përfituese ekonomike, dhe bashkëpunimi të gjërë në politikën e jashtme dhe në çështjet e sigurisë.¹⁰⁹

Britania e Madhe duhet që të shmangë situatën ku administrata e SHBA-së do të jetë e detyruar që të bëjë një zgjidhje ndërmjet marrëdhënieve të thella dhe të posaçme me Britaninë e Madhe, dhe marrëdhënieve paksa më të brishta, megjithatë shumë më të gjëra dhe të rëndësishme me pjesën tjetër të BE-së. Shikuar nga perspektiva amerikane, BE-ja dhe Britania e

¹⁰⁷ Ondarza, N. (2020). *The Brexit Revolution New Political Conditions Change the Dynamics of the Next Phase of EU-UK Negotiations*, SWP Comment No. 13, fq: 6.

¹⁰⁸ Mix. E, D. (2020). *The United Kingdom: Background, Brexit, and Relations with the United States*, 2020, Congressional Research Service, fq: 11.

¹⁰⁹ Mix. E, D; Akhtar Ilias, Sh; Archick, K. (2020). *Brexit: Status and Outlook*, 2020, Congressional Research Service, fq: 22.

Madhe duhet që të jenë bashkë sepse kjo i bën më të qëndrueshme dhe më të rëndësishme marrëdhëniet transatlantike. Sigurisht se SHBA-të nuk dëshirojnë që të vihen në pozicionin e këshilluesit, i cili do të mundohej që të ndihmojë në mënjanimin e inateve të mundshme ndërmjet britanikëve dhe europianëve, duke u kujdesër që të mos shkaktojë ndonjë përkeqësim të marrëdhënieve të saj me aleatët tjerë europian.¹¹⁰

¹¹⁰ Möller, A; Oliver, T. (2014). *The United Kingdom and the European Union: What would a "Brexit" mean for the EU and other States around the World?*, DGAPanalyse, 2014, fq: 17.

5. Imigracioni

Debati european ishte “pushtuar” nga tema e ekonomisë dhe e sovranitetit, por sot dominohet nga imigracioni. Mbështetësi i Brexit-it, Nigel Farage e ka pranuar se ka bërë çmos që këtë temë ta ngritë më lartë se sovraniteti. Akuza se Britania e Madhe e ka humbur kontrollin e kufijve lidhet me zgjerimin e vitit 2004 të BE-së kur tetë ish-shtete komuniste u bënë anëtare të saj. Ky zgjerim komnsiderohet si momenti më krenar i BE-së, e që ishte mbështetur shumë nga qeveria e atëhershme britanike. Por, si për konservatorët, ashtu edhe për laburistët, zgjerimi e transformoi debatin për BE-në në Britaninë e Madhe, pasi deri në vitin 2004 askush nuk fliste për imigracionin në kontekst të BE-së. Lëvizja e lirë brenda BE-së u pa si diçka në interes të vendit, sepse ndërmjet një dhe dy milionë pensionistë britanikë u zhvendosën në jug të Spanjës dhe kjo u pa si diçka reciproke. Disa vite para zgjerimit të madh, 0.1% e qytetarëve të BE-së u zhvendosën në një shtet tjetër anëtar. Shumica menduan se kjo do të ndryshonte shumë pak pas vitit 2004. U parashikua se dhjetra-mijëra nga Europa qendrore e lindore do të imigronin, por gjithçka mori kahje tjetër kur u kuptua se thuajse 1.5 milionë qytetarë të Europës qendrore e lindore ia mësynë Britanisë së Madhe në shtatë vitet e ardhshme pas zgjerimit të vitit 2004. Nga ky numër, një milionë kanë qëndruar në Britani të Madhe. Sipas David Goodhart, kjo ishte “lëvizja më e madhe e kohës së paqes në historinë e Europës”. Disa studiues e akademikë kanë argumentuar se arsyeja më e rëndësishme e rënies së mbështetjes së laburistëve ndërmjet viteve 2005-2010, nga 35% në 29%, erdhi si rezultat i imigracionit nga shtetet tjera anëtare të BE-së. Ndërkaq suksesi i PPBM-së në zgjedhjet vendore dhe ato europiane në maj të vitit 2014 gjithashtu argumentohet me imigracionin dhe këtë temë e ngriti më lartë.¹¹¹ Lëvizja e lirë e njerëzve ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së është çështja më kritike nga ato ekonomike dhe politike që rrethojnë temën e Brexit-it. Garanca e qeverisë britanike se do ta kufizojë migrimin nga BE-ja, në fakt është arsyeja kryesore pas suksesit të referendumit. Megjithatë, Daniel Hannan, politikan konservator pro-daljes nga BE-ja dha shenja të pakta ndryshimi për kontrollin ndërkufitar dhe imigracionin, duke sugjeruar se fishata e daljes nga BE-ja nuk kishte të bëjë me uljen e imigracionit por me “lëvizjen e lirë të fuqisë punëtore”. Kjo është e ngjashme edhe me kushtin e BE-së që për të patur qasje në tregun e vetëm, duhet të ketë edhe lëvizje të lirë të

¹¹¹ Leonard, M. (2015). *The British problem and what it means for Europe*, London 2015, European Council on Foreign Relations/128, fq: 9.

<https://ecfr.eu/publication/the-british-problem-and-what-it-means-for-europe311252/>

njerëzve. Një politikan tjetër, Michael Gove, kandidat për lider të Partisë Konservatore, premtoi fundin e marrëveshjes së lëvizjes së lirë me BE-në dhe miratimin e sistemit të pikëve që tani për tani përdoret nga australianët.¹¹² Që nga vitet e hershme 1980, popullsia e Britanisë së Madhe është ritur në mënyrë të konsiderueshme. Para zgjerimit, imigracioni arriti në 4.7%, dhe në vitin 2013 u rrit në 7.7%. Rreth tre milionë migrantë nga shtetet anëtare të BE-së jetojnë në Britani të Madhe. Sipas të dhënave të vitit 2014, më në numër janë polakët, me afër 800 mijë, pastaj irlandezët me afër 400 mijë, duke u pasuar nga një numër migrantësh nga Gjermania, Rumania, Franca, Lituania e Italia. Nga ana tjetër, sipas të njëjtave të dhëna, rreth 1.1 milionë britanikë jetonin jashtë vendit të tyre. Nga këta, rreth 300 mijë në Spanjë, po aq në Irlandë, rreth 200 mijë në Francë dhe mbi 100 mijë në Gjermani. Pa dyshim se imigracioni luajti rolin e madh që shumë britanikë të votojnë për daljen e Britanisë së Madhe nga BE-ja, ndërkaq qytetarët britanikë në BE dhe ata të shteteve të BE-së në Britani të Madhe u bënë pjesë e rëndësishme e bisedimeve.¹¹³ Statistikat tremujore treguan se deri në qershor të vitit 2016, migrimi nga BE-ja mbeti afërsisht e sheshtë, por nuk kishte të dhëna se ishte ngadalësuar gjatë periudhës së përgatitjeve për referendum. Pra, qytetarët e shteteve tjera anëtare të BE-së që dëshironin të zhvendoseshin bë Britani të Madhe para se të ndodh Brexit nuk ishte ndalur. Disa të dhëna tregojnë se qytetarët e shteteve tjera të BE-së mund të kishin më pak dëshirë që të niseshin drejt Britanisë së Madhe, ose të mbeteshin aty, si rezultat i mendimit se kishte më pak klimë të mirëseardhjes. Të dhënat deri diku mbështetën mendimin se imigracioni nga BE-ja drejt Britanisë së Madhe mund të pakësohej, por ishte tepër herët të kishte garancë se një ndikim i këtillë do të ndodhte.¹¹⁴

Është e rëndësishme për ekonominë e Britanisë së Madhe që sistemi i ri i imigracionit t'i lejojë afarizmit qasjen te fuqia puntore e pakualifikuar sepse roli i tyre në ekonominë britanike është mjaft i rëndësishëm, e veçanërisht në industritë e punës intensive që gjithashtu mbështesin sektorët tjerë. Për shembull, mungesa e tyre në transport, shpërndarje dhe logjistikë do të kenë ndikim negative në shitje, industri përpunimi, ushqip dhe pije, kimikate, plastikë dhe shkencat e

¹¹² Haider Ali Zaidi, S; Xin-Yu, W; Ahmed, S; UR Rehman, S; Sajid, M; Hossein Foroozanfar, M; Ashraf Ali, M. (2017). *Brexit: A review of impact on future of United Kingdom outside the European Union*, IJMRM International Journal of Modern Research in Management, fq: 24.

¹¹³ Felbermayr, G; Fuest, C; Gröschl, J; Stöhlker, D. 2017. *Economic effects of Brexit on the European Economy*, Econpol Policy Report, fq: 5-6.

¹¹⁴ The UK in a Changing Europe. (2016). *Brexit: six months on*, fq: 22. <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2016/12/Brexit-Six-months-on.pdf>

jetës – në çdo industri që kërkon lëvizjen e mallrave nga një lokacion në tjetër. Mungesa e puntëroëve do të ndikonte edhe në projektet e ndërtimit të infrastrukturës që mbështet tërë ekonominë. Kjo do të ndikonte edhe në shpenzimet e strehimit dhe të pronave të patundshme, duke e rritur çmimin e shtëpive dhe të hapësirave afariste. Ka edhe çështje të tjera ndërsektoriale ku ka mungesë të punëtorëve britanikë, e që janë plotësuar nga punëtorë të pakualifikuar nga jashtë. Prandaj, është e rëndësishme që sistemi i ri britanik për imigrimin e punëtorëve të pakualifikuar t'i pranojë nevojat sektoriale.¹¹⁵

¹¹⁵ CBI. (2016). *MAKING A SUCCESS OF BREXIT, A WHOLE-ECONOMY VIEW OF THE UK-EU NEGOTIATIONS*, fq: 23.
<https://www.cbi.org.uk/media/1234/cbi-making-a-success-of-brexite.pdf>

6. Tregtia

Hapi i pare drejt përcaktimit të një kornize të bashkëpunimit në sferën e tregtisë ndërmbet Britanisë së Madhe dhe BE-së erdhi në mars të vitit 2018, por nga BE-ja. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se Britania e Madhe nuk ishte e interesuar, apo e angazhuar në debatin politik se çfarë marrëdhënie tregtare dhe ekonomike synon të vendosë me BE-në. Megjithatë, ekzistonte një përçarje e madhe te elita politike britanike për llojin e marrëdhënieve të ardhme me BE-në.¹¹⁶ Këto marrëdhënie duhet që të vendosen mbi bazën e rëndësisë së madhe që ka tregu i vetëm i BE-së në çdo sektor. Gjithashtu, këto marrëdhënie duhet të vendosen edhe mbi bazën e nivelit të deritanishëm të integritetit të ekonomisë britanike me atë të BE-së, si dhe rëndësia e ardhme si treg. Për afarizmin, këto tregues e bëjnë BE-në si treg të veçantë nga të tjerët, pasi për çdo sektor të rëndësishëm të ekonomisë britanike, BE-ja, tani për tani është më e rëndësishme se çdo treg tjetër ndërkombëtar. Kuptohet se ka edhe afaristë individualë, prodhimet dhe nënsektorët e të cilëve kanë më tepër bashkëpunim me një treg tjetër, si Norvegjia ose edhe SHBA-të. Megjithatë, të dhënat tregojnë se 44% e prodhimeve britanike eksportohen në BE dhe 53% e importeve në Britaninë e Madhe hyjnë nga BE-ja. Kjo do të thotë se shumë kompani e bazojnë furnizimin, kontratat, në BE, si dhe konsumatorët e tyre janë në BE. Për mëteper, marrëdhëniet Britani e Madhe-BE, pa ndonjë barrierë, janë tepër të rëndësishme në aspekt ekonomik.¹¹⁷

Si Britania e Madhe, ashtu edhe BE-ja janë deklaruar për të siguruar një marrëveshje të gjerë të tregtisë së lirë. Mirëpo, Britania e Madhe ka këmbëngulur në tregti të lirë të mallrave dhe shërbimeve, ndërkaj BE-ja është treguar më e ndrojtur. Ajo dëshiron tregti të lirë të mallrave, por nuk është shprehur aq e qartë në aspektin e shërbimeve. Këtë e ka bërë të qartë me mendimin se çfarëdo ujdje që do të arrihet, do të kërkojë angazhimin e barabartë të Britanisë së Madhe. Në parim, brenda një marrëveshje të tregtisë së lirë Britani e Madhe – BE, e para do të ketë autonomi rregullatorë, pra do të ketë mundësi që të përcaktojë politikat e saj të standardit ushqimor, mjedisit dhe ligjet e tregut të punës. Ndërkaq, BE-ja do të kërkojë që Britania e Madhe të përshtatet me politikat dhe rregullat e BE-së, nëse do të dëshironte qasje më të madhe në tregun e BE-së. Mosarritja e një ujdje të këtij niveli mund që të ndikojë në qasjen e BE-së, e cila

¹¹⁶ Mariani, P; Sacerdoti, G. (2019). *Brexit and trade issues*, European Journal of Legal Studies, Special Issue, fq: 192

¹¹⁷ CBI. (2016). *MAKING A SUCCESS OF BREXIT, A WHOLE-ECONOMY VIEW OF THE UK-EU NEGOTIATIONS*, fq: 12.
<https://www.cbi.org.uk/media/1234/cbi-making-a-success-of-brexit.pdf>

mund të mos ketë vullnet për një ofertë me tarifë zero ndaj mallrave britanike.¹¹⁸ Barrierat jotarifore ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së mundet që të jenë më të ulëta sesa ato me shtetet që nuk janë anëtarë të BE-së. Kjo ndodh sepse, qëndrimi i deritanishëm i Britanisë së Madhe në BE ka bërë që rregulloret të jenë të njëjta. Mirëpo, varësisht nga ujdia që mund të arrihet, mund që të shfaqet ndonjë barrierë. Konkretisht, mund të ketë shpenzime shtesë për eksportuesit, kur i plotësojnë dokumentet e nevojshme, nëpërmjet të cilave plotësohen kushtet sipas rregulloreve, por kjo do të ndodh nëse Britania e Madhe del jashtë unionit doganor të BE-së. Gjithashtu, BE-ja ofon më pak qasje të shërbimeve financiare dhe tregjet tjera për afarizmin jashtë tregut të vetëm. Se si një ndryshim i barrierave tregtare do të ndikojë në rezultatin e ekonomisë britanike do të varet nga rëndësia e atij shteti për tregtinë me Britaninë e Madhe. Për shembull, duke marrë parasysh se gjysma e tregtisë së Britanisë së Madhe bëhet me BE-në, atëherë çdo rritje e barrierave tregtare do të ketë ndikim më të madh negativ në rritjen e ekonomisë britanike sesa ndonjë ndikim pozitiv nga pakësimi i barrierave tregtare me Kinën. Megjithatë, ndikimi negativ i barrierave më të larta tregtare me BE-në ende mund të jetë i madh, duke marrë parasysh se 27 shtetet anëtare të BE-së ofrojnë partnerë tregtarë, kryesisht sepse janë zonë e gjerë ekonomike dhe janë afër njëri-tjetrit.¹¹⁹ Mbështetësit e Brexit-it e kanë shfrytëzuar bilancin pozitiv tregtar të BE-së me Britaninë e Madhe si kartë të tyre për bisedime. Mirëpo, ata e kanë injoruar faktin tjetër se eksporti i Britanisë së Madhe në BE është 44%, ndërkohë mesatarja e eksportit të 27 shteteve tjera anëtare drejt BE-së është 7%. Sipas Qendrës për Reformë Europiane, “gjysma e bilancit pozitiv tregtar të BE-së me Britaninë e Madhe, përmbushet vetëm nga dy shtete, Gjermania dhe Holanda, pasi shumica e shteteve anëtare nuk kanë bilanc pozitiv tregtar të konsiderueshëm me Britaninë e Madhe, madje disa kanë bilanc negativ tregtar. Më tutje, çfarëdo marrëveshje që të arrihet, duhet që të miratohet nga pjesa e mbetur e 27 shteteve, disa nga të cilat më tepër blejnë se sa që shesin në Britaninë e Madhe. Gjithashtu, BE-ja ka bilanc pozitiv tregtar në mallra, por bilanc negativ prej 10.3 bilionë funta në shërbime. Prandaj, është më pak e arsyeshme për BE-në që të arrijë një marrëveshje të lirë për qasje në shërbime sesa në mallra. Kjo do të ishte e keqe për ekonominë britanike që bazohet në shërbime. Në këtë

118 The UK in a Changing Europe. (2016). *Brexit: six months on*, fq: 5. <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2016/12/Brexit-Six-months-on.pdf>

119 Tetlow, G; Stojanovic, A. (2018). *Understanding the economic impact of Brexit*, Institute for Government, fq: 13-15.

drejtim, shumë traktare ndërkombëtare të tregtisë tashmë e rregullojnë dhe ndihmojnë në uljen e barrierave tregtare të mallrave, por shumë pak uljen e barrierave tregtare të shërbimeve. Qasja e BE-së të mallrat nuk do të ndikohet aq rëndë sa qasja britanike të shërbimit.¹²⁰ Këta mbështetës të Brexit-t kanë mendim thelbësisht të ndryshëm për atë se çfarë marrëdhënie të ardhme ekonomike duhet të ketë Britania e Madhe me BE-në. Disa prej tyre mendojnë se duhet të ruhen thuajse të gjitha përfitimet nga të qenët anëtar në tregun e vetëm, duke e pranuar shumicën e kufizimeve të politikës kombëtare. Ndërkaq, disa të tjerë e shohin BE-në si mbytës të Britanisë së Madhe dhe dëshirojnë që vendi të jetë i lirë dhe të përpilojë rregulloret e veta të ujdive tregtare.¹²¹ Pjesa më e madhe e debatit për marrëdhëniet tregtare të ardhme është e orientuar kah modelet e marrëveshjeve ekzistuese tregtare të BE-së me vendet e treta. Marrëveshjet me Norvegjinë, Zvicrën, Turqinë, Ukrainën, Kanadën dhe modeli i OBT-së, janë bërë pika kryesore e debatit publik. Mirëpo, duhet të kihet parasysh se këto modele paraqesin qasje dhe nivele të ndryshme të marrëdhënieve ose të integritimit dhe kanë një varg veçorishë të ndryshme. Në këtë drejtim, nga BE-ja vijnë argumentet e gjera se duhet të zgjidhet njëri nga modelet e lartpërmendur, por nga Britania e Madhe vijnë zërat që përkrahin një ujdë të porositur. Megjithatë, fakti se BE-ja tashmë i ka përmbyllur disa marrëveshje të ndryshme me vendet e treta, tregon se ka hapësirë për të gjetur një model kreativ dhe një zgjidhje të nivelit të lart të arritjes së një ujdë për marrëdhëniet e ardhme.¹²² Pas Brexit-it, duket se Britania e Madhe nuk do të jetë në gjendje që të arrijë ujdë as me vendet jashtë BE-së, me të cilat do të ulen shpenzimet tregtare dhe do të nxiten IDH-të. Edhe pse britanikët nuk do të kenë nevojë kompromisi me shtetet tjera anëtare të BE-së kur të negociojë, duhet ta ketë parasysh se është sa një e pesta e tregut të vetëm të BE-së. Kjo e bën që të jetë më e dobët në bisedime sesa BE-ja, dhe se nuk do të sigurojë një ujdë të menjëhershme me BE-në, ashtu siç është duke biseduar me Japoninë dhe SHBA-në.¹²³

120 European Movement International, *The consequences of a British exit from the European Union*, fq: 1.

https://europeanmovement.eu/wp-content/uploads/2016/05/EMI_16_PolicyPosition_Brexit_17_VIEW_FINAL.pdf

121 The UK in a Changing Europe. (2016). *Brexit: six months on*, fq: 25. <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2016/12/Brexit-Six-months-on.pdf>

122 Eeckhout, P. (2018). *Future trade relations between the EU and the UK: options after Brexit*, Policy Department, Directorate-General for External Policies, fq: 6.

123 Dhingra, S; Ottaviano, G; Sampson, Th; Van Reenen, J. (2016). *The impact of Brexit on foreign investment in the UK*, CEP BREXIT ANALYSIS No. 3, fq: 7.

Arritja e miratimit unanim të shteteve anëtare të BE-së për një ujdj gjithëpërfshirëse tregtare do të ishte mjaft sfiduese. Nga momenti i daljes, Britania e Madhe do të bëhet partneri më i madh i vetëm tregtar i mallrave. Kjo do të ndodhte duke filluar nga pozicioni i integritetit të ngushtë, duke marrë parasysh se një pjesë e këtij integriteti do të humbet në disa sfera, diçka që trajtohet në mënyrë të ndryshme nga bisedimet tregtare konvencionale to cilat fillojnë nga e kundërta, pra nga humbja e integritetit drejt forcimit të tij. Në kundërshtim të kësaj është fakti se Brexit-i për BE-në mund të paraqesë një krizë, ndërkaq vullneti i mirë i shteteve anëtare të saj nuk mund t mbështetet në këtë. Prandaj, është e paqartë se çfarë ujdje tregtare do t arrijë Britania e Madhe me BE-në që të ketë qasje në afatgjatë në tregun e saj. Kuptohet se janë të pasinqerta pretendimet e atyre që e mbështetën Brexit-in që gjërat janë shumë të thjeshta, pra që Britania e Madhe do të dalë nga BE-ja, do ta heqë lëvizjen e lirë dhe do të vazhdojë që të ketë të njëjtat të drejta tregtare me shtetet anëtare të BE-së, ashtu siç i ka tani. Kjo nuk është e vërtetë sepse Britania e Madhe do të ketë qasje në tregun e vetëm të BE-së, por jo qasje të plotë. Çështja që ngritet nuk ka të bëjë me atë se a do të ketë qasje Britania e Madhe në tregun e vetëm të BE-së, por çfarë qasje do të ketë dhe sa e ndryshme do të jetë nga ajo që e gëzon tani. Kjo është një çështje e vështirë për t'i dhënë përgjigjen e saktë, ndërkaq mbështetësit e Brexit-it nuk kanë thënë asgjë për të.¹²⁴

Poqese nuk do të arrihet një marrëveshje, siç e kemi përmendur edhe më lartë, rregullat e OBT-së do të vlejnjë për Britaninë e Madhe, si një anëtar krejtësisht i pavarur i organizatës. Pra, rregullat dihen, Britania e Madhe do të bëjë tregti me BE-në ashtu siç do të bëjë me çdo shtet tjetër në botë, deri sa të arrihet një lloj i marrëveshjes së tregtisë së lirë. Kuptohet se për aq sa Britania e Madhe ishte pjesë e BE-së, rregullat e OBT-së nuk kanë vlejtur, pasi që shteti ishullor ka qenë pjesë e Tregut të Vetëm të BE-së dhe të Bashkimit Doganor që ka vepruar sipas ligjeve të BE-së. Rrjedhimisht, mallrat britanike do të përballen me tarifa doganore kur të eksportohen në BE, si dhe mallrat e BE do të përballen me tarifa doganore kur të eksportohen në Britani të Madhe. Në mungesë të një marrëveshje të posaçme dypalëshe, rregullat e OBT-së do të zbatohen në mënyrë reciproke, ndërmjet BE-së dhe Britanisë së Madhe.¹²⁵

¹²⁴ House of Commons Treasury Committee. (2016), *The economic and financial costs and benefits of the UK's EU membership*, First Report of Session 2016–17, 2016, fq: 39.

¹²⁵ Mariani, P; Sacerdoti, G. (2019). *Brexit and trade issues*, European Journal of Legal Studies, Special Issue, fq: 210.

Nga 1 janari 2021, pa marrë parasysh përfundimin e bisedimeve që janë duke u zhvilluar, Britania e Madhe nuk do të jetë më pjesë e Tregut të Vetëm dhe të Bashkimi Doganor të BE-së. Kjo do të thotë se çdo afarizëm që do të lëviz mallrat nga Britania e Madhe jashtë vendit, brenda saj, apo edhe nëpër të, do të përballlet me aspekte doganore dhe rregullore të tjera. Prandaj, për afarizmin britanik është i rëndësishëm marrja e masave përgaditore për t'i kuptuar ndryshimet që do të pasojnë Brexit-in, ku në zbatim do të jenë rregulla dhe procese të reja veprimi. Dështimi për t'u përgatitur me atë që po vjen, do të ndikojë pengesa tregtie, pra në vonesa të lëvizjes së mallrave nga Britania e Madhe, në dhe nëpër të. Duhet të theksohet se këto ndryshime nuk do të zbatohen në tregtinë e marrave ndërmjet Irlandës dhe Irlandës së Veriut, ku në shprehje vjen Protokollu që do të zbatohet nga fundi i periudhës tranzitore, pa marrë parasysh se si do të jetë përfundimi i bisedimeve ndërmjet BE-së dhe Britanisë së Madhe. Protokoll parasheh zbatimin e rregullave të Bashkimit Doganor të BE-së, nëse nuk ndodh ndryshe, pra importet dhe eksportet britanike do të bëhen vetëm me Irlandën e Veriut.¹²⁶

Së përfundim, marrëdhëniet e ardhme tregtare ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së, do të varen nga rezultati i bisedimeve ndërmjet të dyja palëve, ndërkaq nuk do të ndryshojë asgjë deri më 31 dhjetor 2020 kur edhe përfundon periudha tranzitore. Pas 1 janarit 2021, mbeten dy skenarë për realizimin e tregtisë ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së:

- Marrëveshje e Tregtisë së Lirë: Palët janë duke bërë çmos që të arrijnë këtë ujdi deri në fund të periudhës tranzitore. Hollësitë e kësaj marrëveshje do të bëhen të ditur vetëm pas arritjes së saj, por besohet se bëhet fjalë për heqje të kuotave dhe tarifave për pjesën më të madhe të mallrave ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së. Nuk mendohet se do të mbetet gjithçka e lirë, prandaj disa çështje dokumentesh dhe formalitetesh do të zbatohen.
- Kushtet e OBT-së: Nëse palët nuk arrijnë marrëveshje, atëherë tregtia ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së, siç e kemi cekur edhe më lartë, pas 1 janarit 2021 do të zhvillohet sipas kushteve të OBT-së. Çdo lëvizje malli do të përballlet me çështje doganore dhe inspektuese dhe do të zbatohen tarifet.¹²⁷

¹²⁶ Government of Ireland. (2020). *Preparing for the end of the transition period, Brexit Readiness Action Plan*, fq: 17.

¹²⁷ Fedex Express, *Brexit: your 2021 checklist, How to prepare your business for the end of the transition period*, fq: 3. https://www.fedex.com/content/dam/fedex/eu-europe/brexit/checklist/FedEx_Brexit_Checklist_2021_EN_GB.pdf

7. Shërbimet financiare

Britania e Madhe realizon një numër të madh të shërbimeve financiare me pjesën tjetër të BE-së. Ky sektor është një ofrues i madh dhe mjaft i vlerësuar i tregut të punës në tërë Britaninë e Madhe, e posaçërisht Londra konsiderohet si një nga rajonet me mundësi të madhe financiare në botë, njëkohësisht vlerësohet si qendër financiare e Europës, duke përfshirë më tepër se 50% të Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) në sektorin e financave dhe të sigurimeve në Britaninë e Madhe. Ky sektor kërcënohet nga një humbje e madhe e të drejtave të veprimit të firmave me seli në Britaninë e Madhe, por që ofrojnë shërbime financiare në BE. Vetëm në vitin 2015, Britania e Madhe eksportoi mbi 26 bilionë funta shërbime financiare, sigurimi dhe pensioni në BE. Andaj, çdo dështim në arritjen e qasjes së plotë në tregun e BE-së pas Brexit-it do të paraqiste dështim dhe rritje të shpenzimeve tregtare nga të cilat, kuptohet se humbësi më i madh do të jetë Britania e Madhe, duke pësuar rënie në këtë sektor. Kjo pasqyrohet në rritjen e çmimeve të importit dhe të eksportit në supozimet makro modulare, pasi Britania e Madhe do të duhet që të vazhdojë t'u përshtatet rregullave të BE-së, nëse do të dëshirojë që të vazhdojnë transaksionet me BE-në. Një goditje tjetër për këtë sektor mund të jetë politika e shtrënguar e imigracionit që Britania e Madhe mund ta zbatojë pas daljes nga BE-ja. Kërkesa për vizë dhe leje pune në Britani të Madhe do të jetë pengesa që do të pamundësojë qasjen në tregun e BE-së të punëtorëve me aftësi të larta. Londra do të jetë vendi që do ta ndjejë këtë pengesë, ku rreth 35% e të punësuarve në sektorin e financave dhe të sigurimeve, dhe 12% e të punësuarve të sektorit kanë lindur në hapësirën ekonomike europiane. Kjo tashmë është pasqyruar në rëniein e pritur në supozimet makro modulare. Humbja e qasjes së plotë të Britanisë së Madhe në tregun e BE-së dhe në forcën e aftë të punës, do të ndikojë në humbjen e përparësive konkurruese si një qendër financiare. Kjo mund të frenojë investime të rëndësishme dhe të njëjtat të ridrejtohen në qendrat financiare europiane. Një zhvillim i këtillë është pasqyruar si rënie në investime në supozimet makro modulare, ku, varësisht skenarëve, vetëm sektori i financave dhe i sigurimeve mendohet se do të pësojë mbi pesë milionë euro rënie deri në vitin 2030.¹²⁸

Statistikat e Zyrës për Statistika Kombëtare vlerësojnë se sektori i shërbimeve financiare ndikon në 6.5% të prodhimit ekonomik të Britanisë së Madhe, duke ofruar mbi një milionë

¹²⁸ Greater London Authority, (2018). *Preparing for Brexit*, Cambridge Econometric Final Report, fq: 26-27.
https://www.london.gov.uk/sites/default/files/preparing_for_brexit_final_report.pdf

punësime, nga të cilat një e treta janë në Londër, 11% në juglindje, dhe pjesa e mbetur prej 53% në pjesën tjetër të Britanisë së Madhe. Ky shtet ka bilanc pozitiv tregtar në shërbimet financiare, ku një e treta e eksporteve të tyre shkojnë në BE. Ky sektor është përfshirë gjerësisht dhe ka marrë vëmendje të madhe në debatin e ndikimit të Brexit-it sepse BE-ja është një treg i rëndësishëm i kompanive të shërbimeve financiare me seli në Britaninë e Madhe dhe shërbimet e tyre mund të rriten nëse nuk ka përmirësim sipas kushteve të OBT-së për qasje në tregun e vetëm. Kompanitë që nuk janë brenda BE-së e që do të dëshironin të ofronin shërbime financiare në BE do të duhet që të themelojnë zyra përfaqësimi, duke ia shtuar kështu edhe pëlqimin nga BE-ja që rregullat në vendet e tyre janë të ngjashme me ato të BE-së. Mirëpo, afaritmi i BE-së mbështetet në mundësinë e blerjes së shërbimeve financiare në Britaninë e Madhe. Londra është qendër udhëheqëse botërore e financave, ndërkaj afarizmi i BE-së nuk ka ndonjë burim tjetër. Rreziku më i madh i sektorit financiar del nga vlerësimi i humbjes tregtare nga pasaporta, e që vështirë se mund të kompensohet nga ndonjë marrëveshje tjetër tregtare rezervë. Sipas Oliver Wyman, nëse Britania e Madhe do të bënte tregti me BE-në nën kushtet e OBT-së, atëherë rreth 18 deri 20 bilionë funta në të ardhura dhe deri 35 mijë vende pune do të vihen në rrezik, krahas tre deri pesë bilionë funta në të ardhura nga taksat për një vit. Edhe studime tjera gjejnë të dhëna të ngjashme. Prandaj ndikimi eventual dhe barrierat shtesë që mund t'u vihen shërbimeve financiare britanike me BE-në do të varet nga ajo se si do të jetë marrëveshja përfundimtare.¹²⁹

Edhe pse rritja në shërbimet financiare është dobësuar si rezultat i referendumit, sektori vazhdon të jetë një përbërës i rëndësishëm i ekonomisë britanike, duke kontribuar me 6.9% të PBB-s në vitin 2019. Pas referendumit, kuptohet se përgatitjet janë bërë në aspekt të mundësisë së një Brexit-i pa marrëveshje. Këto përgatitje ishin të patjetërsueshme sepse madhësia dhe forma e sektorit financiar të tanishëm është përcaktuar nga marrëdhëniet e Britanisë së Madhe me BE-në. Liberalizimi i tregtisë ndërkufitare të shërbimeve financiare e ofroi pasaportën për rregullime ndërmjet shteteve anëtare të BE-së. Si rezultat i kësaj, 67% e shërbimeve financiare të Britanisë së Madhe u eksportuan në BE nga selitë e kompanive në Britani të Madhe. Kërkesa për një model të pranimit të rregullave të ndryshme nga të dyja palët nuk u pranua nga BE-ja. Rregullat e pasaportës së tanishme vlejnë deri në fund të vitit 2020. Më tutje, marrëdhëniet

¹²⁹ Tetlow, G; Stojanovic, A. (2018). *Understanding the economic impact of Brexit*, Institute for Government, fq: 51-52.

ndërmjet të dy palëve sa u përket shërbimeve financiare do të bazohen në rregulla të barasvlershme. Kjo do të thotë se BE-ja do të lejojë shërbime të tilla vetëm nëse vendi i origjinës ka rregulla të barasvlershme me ato të BE-së. Mirëpo, një pjesë e sektorit të shërbimeve financiare janë më pak të ekspozuara ndaj transkacioneve ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së. Ata shpresojnë që të përfitojnë nga kjo situatë dhe tashmë zyra të reja janë hapur në Londër, që pas referendumit. Lëvizjet e këtilla tregojnë se si firmat financiare mbrohen gjatë periudhës së tranzicionit. Mirëpo, në pah del çështja se si ky sektor do të kontribuojë në përqendrimin e ri në zhvillimin ekonomik rajonal të Britanisë së Madhe pas Brexit-it. Çdo tkurrje në aktivitetin e shërbimeve financiare do të rezultojë në të ardhura më të ulëta nga taksat, në kufizimin e fondeve vendore të mundshme për të mbështetur investimet kudo në Britaninë e Madhe.¹³⁰

Sa u përket shërbimeve financiare, qeveria britanike e ka përpiluar një plan të quajtur si Letra e Bardhë, i cili pazohet në braktisjen e sistemit të pasaportës, që e kemi përmendur më lartë. Kjo mund të ndodhë në bazë të parimit të 'njohjes reciproke', duke mbuluar shumë sfera të shërbimeve financiare si investimet, bankat, sigurimet, ndërmjetësimet në sigurime, pagesat dhe paratë elektronike. Britania e Madhe propozon që çdo gjë të bëhet nëpërmjet një ujdie të rregulluese ekonomike, që është e ngjashme me aspektet e BE-së për vendet e treta, që ofron qasje të kufizuar për disa partnerë nga vendet e treta në disa sfera të shërbimeve financiare të tregut të BE-së. Letra e Bardhë propozon një numër procesesh të përpiluara për të nxitur konvergjinë dhe për të menaxhuar procesin, në rast se ligjet janë të ndryshme dhe i përfshijnë të dy palët. Nga perspektiva e legjislativit të BE-së, që të arrihen ujdë të reja rregulluese ekonomike, të cilat propozohen nga Britania e Madhe, atëherë do të duhet që të rishkruhen një numër direktivash. Si e tillë, ujdia e propozuar pas Brexit-it për shërbimet financiare duket e paqartë, pasi konsiderohet se është edhe e parealizueshme, dhe se nuk e merr parasysh faktin e integritetit të tregut të vetëm të BE-së, pjesë e së cilës janë katër liritë. Çdo zgjedhje e tyre veçmas konsiderohet si minues për integritetin dhe funksionimin e duhur të tregut të vetëm.¹³¹

Rreziku ndaj stabilitetit financiar, shërbimeve financiare dhe konsumatorëve të këtyre shërbimeve konsiderohet se është i ulët, edhe pse tashmë kanë filluar parapërgatitjet. Kuptohet se

¹³⁰ The UK in a Changing Europe, 2020. *Brexit: what next?*, fq: 19-20. <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2020/02/Brexit-what-next-report.pdf>

¹³¹ Mariani, P; Sacerdoti, G. (2019). *Brexit and trade issues*, European Journal of Legal Studies, Special Issue, fq: 198.

shqetësimet tregtare deri diku do të jenë të pranishme dhe të pashmangshme, por si i tërë, sistemi financiar pritet të jetë i qëndrueshëm. Metoda e pasaportës e shërbimeve tregtare ndërmjet BE-së dhe Britanisë së Madhe nuk do të jetë më e zbatueshme pas përfundimit të periudhës tranzitore në disa sfera. Si pasojë, BE-ja mund që të zbatojë një regjim rregullues ose mikëqyrës sikur ndaj një shteti që nuk është pjesë e BE-së, duke e konsideruar si ekuivalent me regjimin e BE-së. Disa aspekte tashmë janë pranuar si të përkohshme për shkaqe të stabilitetit financiar në disa sfera. Ndërkaq, tashmë Britania e Madhe e ka zbatuar Regjimin e Lejes së Përkohshme, duke i lejuar firmat e Zonës Ekonomike Europiane që të veprojnë për një periudhë të kufizuar prej tre vjetësh pas përfundimit të regjimit të pasaportës, njëkohësisht duke kërkuar autorizim nga rregullatorët britanikë. Prandaj, për shkak të shkëmbimit të madh të të dhënave ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së, sektori i shërbimeve financiare do të jetë posaçërisht i ndikuar nga bisedimet ndërmjet palëve.¹³²

¹³² Greater London Authority, (2018). *Preparing for Brexit*, Cambridge Econometric Final Report, fq: 44.
https://www.london.gov.uk/sites/default/files/preparing_for_brexit_final_report.pdf

8. Buxheti i BE-së dhe financat publike të Britanisë së Madhe

Bashkimi European do të duhet që të vendosë se si do ta rregullojë buxhetin e saj pas Brexit-it. Në diskutimin e deritanishëm u qartësua se Britania e Madhe është një kontribues i rëndësishëm i buxhetit të BE-së, prandaj BE-ja e 27 anëtarëve do të duhet të ndërmerr masa drejt shkurtimit të shpenzimeve, rritjes së kontributeve ose të bëjë ndërthurjen e të dyjave. Studimet e shumëta kanë theksuar se BE-ja duhet t'i shkurtojë shpenzimet në sasinë që do të shkonin në Britani të Madhe dhe do të duhet ta shpërndajë zbrastirën e Brexit-tit, pra kontributin vjetor të Britanisë së Madhe të 27 shtete anëtare të mbetura. Kjo është njëra mënyrë, ndërkaj një mënyrë tjetër është që kontributet e shteteve të mbetura të jenë të njëjta në buxhetin e BE-së, edhe pse një kontribues i madh e ndërpret kontributin e tij.¹³³ Një çështje tjetër e Brexit është edhe aspekti i financave publike të Britanisë së Madhe. Mbështetësit e daljes nga BE-ja argumentuan dhe premtuan se Brexit-i do të rikthejë rreth 350 milionë funta që, sipas tyre, dërgoheshin javë për javë në Bruksel, por të dhënat e sakta dëshmonin se shumica e kontributit të Britanisë së Madhe në buxhetin e BE-së ishte sa gjysma e shifrës së lartpërmendur. Më tutje, ndikimi i Brexit-it te financat publike të Britanisë së Madhe, kur kontributi në buxhetin e BE-së të marrë fund, duhet të konsiderohet edhe në aspekt të ndikimit në të ardhurat nga taksat dhe shpenzimet publike. Këtu nuk duhet lënë anash edhe detyrimi i britanikëve që të kontribuojnë në buxhetin e BE-së për periudhën shtatëvjeçare 2014-2020.¹³⁴

¹³³ Felbermayr, G; Fuest, C; Gröschl, J; Stöhlker, D. (2017). *Economic effects of Brexit on the European Economy*, Econpol Policy Report, fq: 20-21.

¹³⁴ The UK in a Changing Europe. (2016). *Brexit: six months on*, fq: 24-25. <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2016/12/Brexit-Six-months-on.pdf>

9. Pasojat e Brexit në BE

Me daljen e Britanisë së Madhe nga BE-ja, dalin në pah mundësitë e ndryshimit të baraspeshës së fuqisë dhe të lidërshimit brenda BE-së. Një pasojë e Brexit mund të jetë forcimi i boshtit franko-gjerman që shpesh ka qenë baraspeshues brenda BE-së. Dalja e Britanisë së Madhe çoi në disa sfida të rëndësishme për BE-në, rreth mënyrës se si të menaxhohet Brexit-i, bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe shteteve britanike që janë kundër daljes, marrëdhënieve të BE-së me Britaninë e Madhe pas daljes dhe rreziku për BE-në Le t'i analizojmë më mirë disa nga sfidat me të cilat përballlet BE-ja.. E para, dalja e Britanisë së madhe paraqet një precedent që në të ardhmen mund të ndiqet nga ndonjë shtet tjetër anëtar i BE-së. Çdo dalje tjetër do ta dëmtojë BE-në, e mbase mund të çojë në rëniein e saj. Daljen e Britanisë së madhe mund ta shfrytlzojnë populistët të cilët mund të ndikojnë që të nxitet një domino efekt në shtetet tjera të BE-së. Marine Le Pen nga Fronti Nacional në Francë pati deklaruar se “ishte një fitore për liri” dhe se ishte e nevojshme që “të mbahet një referendum në Francë dhe në Bashkimin Europian”. Reagime të ngjashme kishte edhe no Holandë, Itali, ku politikanë si Wilders e Salvini u deklaruan se “është radha jonë”. E dyta, është e qartë se Europa do të mbetet më e vogël pa Britaninë e Madhe sepse ky vend zë 12.5% të popullsisë së BE-së, 14.8% të ekonomisë dhe 19.4% të eksportit. E treta, politikanë dhe diplomatë britanikë kanë luajtur rol të rëndësishëm në disa projekte europiane, siç është Euro-ja dhe zgjerimi i rrjetit europian të mbrojtjes. E katërta, rreziku ndaj Europës është i menjëhershëm sepse ka ndikim te shtetet fqine të Britanisë së Madhe. Këtu bëhet fjalë për aspekte negative si rezultat i kontrolleve kufitare. Që ta rumbullakësojmë, BE-ja do të humbë një fuqi të madhe, një kulturë vlerë politike e diplomatike, fuqi ushtarake, financiare dhe të politikës së jashtme.¹³⁵ Është e qartë se Brexit-i nuk do të jetë çështja më e rëndësishme që do ta përcaktojë të ardhmen e BE-së, megjithatë, sipas fjalëve të Michel Barnier, Britania e Madhe do të jetë “partneri më i ngushtë dhe më strategjik”. Por, çështja kryesore që BE-ja duhet të ndërmarrë është trysnia ndaj ideve të ngjashme në shtetet tjera anëtare të saj. Si çështje tjetër faqet edhe ndarja e barrës së përgjegjësi në çështje të ndryshme politike sepse BE-ja e ka humbur një shtet anëtarë mjaft aktiv, duke qenë shteti i tretë kontribues në ndihmat ndërkombëtare, duke ia shtuar kështu statusin e anëtarit të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kapacitetet mbrojtëse të Britanisë së Madhe, janë tepër të rëndësishme dhe

¹³⁵ Ababakr, A; Njilo, G; Chima, A. (2019). *The Impact of Brexit on the Future of the European Union*, fq: 15-17. [\(PDF\) The Impact of Brexit on the Future of the European Union \(researchgate.net\)](#)

dalja e saj paraqet një rënie të aftësive kolektive të BE-së për mbrojtje. Shtetet si Polonia dhe vendet Baltike kanë shprehur shqetësimin e tyre se tendosjet e BE-së me Britaninë e Madhe mund të çojnë në mosangazhimin e gjërë të Britanisë së Madhe në rajon, edhe pse deklarata politike për marrëdhëniet e ardhme janë të hapura në aspekt të pjesëmarrjes së Britanisë së Madhe në politikën e jashtme dhe të mbrojtjes së BE-së. Të dyja palët e pranojnë se janë të interesuara që të bashkëveprojnë në këtë drejtim.¹³⁶

¹³⁶ The UK in a Changing Europe, 2020. *Brexit: what next?*, fq: 53-54. <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2020/02/Brexit-what-next-report.pdf>

10. Periudha tranzitore

Më 31 janar të vitit 2020 mori fund anëtarësimi i Britanisë së Madhe në Bashkimin Europian (BE), pas ratifikimit të Marrëveshjes së Daljes ndërmjet të dy palëve. Sipas kësaj marrëveshje, deri në fund të vitit 2020 vazhdoi periudha tranzitore, gjatë së cilës ligjet e BE-s vazhduan të zbatohen në Britaninë e Madhe. Kjo periudhë zgjati deri në ora 11 të pasditës të datës 31 dhjetor 2020. Dalja nga BE-ja kërkoi ndryshime në legjislacionin e Britanisë së Madhe që shteti të mbetet funksional. Palët janë pajtuar që Akti i vitit 2018 i BE-së të ndihmojë në transferimin e zbatueshmërisë së ligjit të BE-së (shembull rregulloret) në ligj të Britanisë së Madhe. Kështu, ruhen ligjet e vendit të cilat ndërlidhen me anëtarësimin në BE, e që janë shfrytëzuar për të zbatuar direktivat e BE-së. Akti u dha ministrave të Britanisë së Madhe kompetenca që të bëjnë ndryshime në ligjin e mbetur të BE-së, që të vazhdohet me veprimin pas daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja. Për shembull, ndryshime mund të kërkohen ndaj dispozitave të ligjit të BE-së që nuk gjejnë zbatim praktik pas daljes së britanikëve. Akti i konsideron këto dispozita të mangëta.¹³⁷

Gjatë kësaj faze tranzitore janë negociuar kushtet e marrëdhënieve të ardhme tregtare ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së, duke synuar një marrëveshje standarde të tregtis së lirë, sipas atyre ekzistuese. Nga ana tjetër, Britania e Madhe tashmë ka kryer bisedime edhe me shtete tjera për zona të lira ekonomike. Ndryshimet që do të zbatohen pas përfundimit të periudhës tranzitore do të kenë ndikim të gjërë, por gjithçka varet nga forma e marrëveshjes përfundimtare, për të cilën shumëçka dihet. Prandaj, për afaristët, gjetja e ndryshimeve që duhet t'i bëjnë, do të jetë kyç për veprimtarinë e tyre të ardhme në një mjedis tregtar, ndërkaq ndërmarrja e hapave konkrete është mjaft e rëndësishme.¹³⁸

Fundi i periudhës tranzitore do të sinjalojë pikën fillestare të procesit të Brexit-it, ku gjërat ndryshojnë në bazë. Periudha tranzitore ishte gjerësisht një ujdë për ruajtjen e status quo-së. Pasë 1 janarit të vitit 2021, ndryshimi do të jetë mjaft i rëndësishëm, pasi pas marrëveshjes përfundimtare, do të kthehen kontrollet kufitare, sistemi i ri i imigracionit që do ta zëvendësojë

¹³⁷ Bank of England. (2020). *UK withdrawal from the EU: Changes before the end of the transition period*, Bank of England Consultation Paper | PRA Consultation Paper CP13/20, fq: 1.

¹³⁸ Deloitte. (2020). *Brexit: The transition period and beyond, Define your future*, fq: 1.

<https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/uk/Documents/international-markets/deloitte-uk-2020-brexit-impact-assessment-framework.pdf>

lëvizjen e lirë, do të zbatohen ndryshimet në peshkatari dhe agronomi. Edhe trupat e rinj publik dhe rregullatorët do të marrin rolin dhe përgjegjësitë që u takojnë. Për herë të parë, shikuar nga aspekti administrativ, do të shihet realiteti i ri i Brexit-it, prandaj qeveria, afarizmi dhe njerëzit duhet të jenë gati për këtë realitet të ri. Pas përfundimit të periudhës tranzitore do të ofrohet mundësia që të vlerësohet se si e përgatiti vendin për Brexit-in. Nëse do të shfaqen çështje dhe sfida, atëherë këto do të jenë të dukshme, pasi ndryshimet e mëdha në sistemin e qeverisjes marrin kohë. Të dhënat e sakta të proceseve të sistemit të ri të qeverisjes pas Brexit-it mund të mos jenë të disponueshme deri në arritjen e ujdisë për marrëdhëniet e ardhme ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së.¹³⁹

Gjatë periudhës tranzitore Britania e Madhe dhe BE-ja i kishin mundësitë e negocimit të kushteve për marrëdhëniet e ardhme në aspekt të tregtisë dhe të sferave të tjera, ku ligji i BE-së luan rolin rregullues. Në fund të kësaj periudhe, shumë gjëra mund të rregullohen, por shumë gjëra mund të mos rregullohen. Në këtë drejtim, BE-ja me kohë e ka bërë të qartë se çfarëdo marrëveshje me Britaninë e Madhe, do të varet nga kjo e fundit se sa do të dëshironte që të jetë e lidhur me normat rregulluese të caktuara të BE-së. Mirëpo, qeveria e Britanisë së Madhe e ka theksuar mundësinë e shmangies nga rregullat e BE-së, përpos situatës me Irlandën e Veriut, që sipas Marrëveshjes së Daljes, situata në këtë pjesë do të mbetet e ngjashme deri në vitin 2026. Deri në fund të periudhës tranzitore, një marrëveshje pritet të arrihet, por edhe të mos arrihet. Në disa sfera, mund të kalojë një kohë e gjatë deri sa palët të arrijnë një ujdj sesa të mbështetin marrëdhëniet e tyre në instrumente shumëpalëshe siç janë rregullat e OBT-së.¹⁴⁰

Gjatë periudhës tranzitore, marrëdhëniet e Britanisë së Madhe me BE-në nuk u rregulluan nga traktatet e BE-së, por nga kushtet e Marrëveshjes së Daljes, qëllimi i së cilës ishte që t'u jepet hapësirë palëve që të negociojnë kushtet e marrëdhënieve të reja ndërmjet tyre. Pas kësaj periudhe, gjërat do të shkojnë ashtu siç do të pajtohen palët e përfshira në bisedime.¹⁴¹

Ndërthurja e afateve dhe i shkëmbimeve të pakëndshme ndërmjet të dyja palët do të thotë se mbase një marrëveshje mund të mos arrihej. Britania e Madhe mundej që të del nga BE-ja pa

¹³⁹ Owen, J; Jack, Th, M; Wright, G; Sargeant, J; Stojanovic, A; Etherington, H. (2020). *Getting Brexit done What happens now?*, Institute for Government Insight, fq: 20.

¹⁴⁰ Dentons. (2020). *After Brexit: Navigating a new world*, fq: 2. https://www.dentons.com/-/media/pdfs/collateral/brexit-after_brexit.pdf?la=en

¹⁴¹ Salesforce. (2020). *Brexit Considerations around Salesforce's Data Flows*, fq: 2. https://www.salesforce.com/content/dam/web/en_us/www/documents/legal/misc/brexit-faqs.pdf

një marrëveshje, por kësaj radhe nuk do të ishte njëjtë si në vitin 2019, kur kishim dy shtyrje. Kjo do të thotë se në rast se nuk ka marrëveshje, atëherë Marrëveshja e Daljes do të mbetet ende në fuqi dhe të dy palët do të ishin të lidhur në përkushtimin për të drejtat e qytetarëve, pastaj do të zbatoheshin dispozitat e kufirit me Irlandën, për të shmangur kufirin, ndërkaf për aspektet tjera, çdo përfundim pa një ujdë nuk do të ishte diçka ndryshe nga faza e parë e bisedimeve të Brexit-it. Afarizmi do të përballej me pasojat e njëjta në tregtinë e mallrave, shërbimeve, shkëmbimit të të dhënave dhe bashkëpunimit për siguri. Përfundimi i bisedimeve pa marrëveshje ishte mëse e mundshme gjatë periudhës tranzitore sesa në fillim. Amcicia e Britanisë së Madhe, e theksuar në Deklaratën Politike, do të thotë se në shumë sfera dhe industri, dështimi i arritjes së një ujdë do të ishte e ngjashme me humbjen e marrëdhënieve të parashikuara. Koncesionet politike që kërkohen mund që të ndikonin që palët të vendosin se nuk ia vlen marginalizimi i ekonomisë, prandaj rreziku për një përfundim bisedimesh pa marrëveshje u bë tejet i lart.¹⁴²

Përfundimi i periudhës tranzitore do të ndiqet nga një grejs periudhë prej gjashtë muajsh, deri në 30 qershor 2021. Të gjithë ata që kanë mundësi do të kërkojnë një status të ri pas Brexit-it. Pjesa e të drejtave të qytetarëve vendos kornizat e vazhdimet të qëndrimit legal të banorëve të shteteve të BE-së në Britaninë e Madhe dhe të Britanisë së Madhe në BE. Qeveritë, munden që në mënyrë unilaterale t'u kërkojnë banorëve të BE-së dhe të Britanisë së Madhe që jetojnë në territoret e tyre, që të aplikojnë për një status të ri qëndrimi dhe dështimi për të arritur këtë, kuptohet se do të rezultojë në humbjen e statusit ligjor të imigrantit. Qeveritë janë në garë kundër kohës për të finalizuar planet e tyre, që pas periudhës tranzitore të zbatojnë marrëveshjen e daljes në nivel kombëtar. Ata duhet që të përpilojnë dhe miratojnë legjislacionin dhe udhëzimet, t'i trajtojnë zyrtarët, duke nisur kështu një faqe të re – Britania e Madhe jashtë BE-së dhe BE-ja pa Britaninë e Madhe.¹⁴³

¹⁴² Owen, J; Jack, Th, M; Wright, G; Sargeant, J; Stojanovic, A; Etherington, H. (2020). *Getting Brexit done What happens now?*, Institute for Government Insight, fq: 14

¹⁴³ Ahad, A; Andriescu, M. (2020). *Brexit on the Backburner Citizens' rights and the implementation of the withdrawal agreement in a pandemic*, Migration Policy Institute Europe, fq: 1.

KAPITULLI V

Përmbyllja e bisedimeve

Siç e kemi diskutuar deri më tani, Britania e Madhe zyrtarisht doli nga Bashkimi European (BE) më 31 janar të vitit 2020, duke i dhënë kështu anëtarësimin të saj 47 vjeçar. Kjo erdhi si rezultat e referendumit të vitit 2016 kur britanikët i than PO daljes nga BE-ja. Pas kësaj dite, u zhvilluan 40 muaj bisedime, ku kishte edhe tre vazhdime të tyre, dhe në tetor të vitit 2019, Britania e Madhe dhe BE-ja arritën:

- Marrëveshjen e rishikuar për dalje – që përfshin kushtet e një Brexit-i të rregullt. Marrëveshja përfshin Protokollet për Irlandën dhe Irlandën e Veriut dhe bazat sovrane britanike në Qipro dhe Gjibraltar.

- Deklarata e rishikuar politike – që siguron kornizën e marrëdhënieve të ardhshme ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së.¹⁴⁴

Tash e tutje, terminologjia e BE-së e njeh Britaninë e Madhe si “vend i tretë”, pasi ajo nuk merr pjesë më në institucionet e BE-së, nuk ka deputetë në Parlamentin European (PE), nuk ka komisionerë, e as Ministra që ndjekin takimet e Këshillit, por ishte subjekt i ligjeve të BE-së deri më 31 dhjetor 2020, kur përfundoi periudha tranzitore. Palët e shfryrëzuan periudhën për bisedime rreth të marrëdhënieve të ardhme që përfshijnë edhe një marrëveshje tregtare. Vazhdimi i kësaj periudhe ishte i pamundur ngaqë Britania e Madhe i vendosi ndalesë vetes që të kërkojë një gjë të tillë. Nga ana tjetër, edhe pandemia Covid-19 i sfidoi fuqishëm këto bisedime.¹⁴⁵

Bisedimet filluan në mars të vitit 2020, ndërkaq ekipet u udhëhoqën nga Michel Barnier, për BE-në, dhe David Frost, për Britaninë e Madhe. Në bisedime morën pjesë edhe përfaqësues të tjerë nga Këshilli, Komisioni dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm European, si dhe zyrtarë britanikë nga departamene të rëndësishme qeveritare dhe nga institucionet publike britanike. Në lidhje me bisedimet, një deklaratë qeveritare britanike bënte të ditur se britanikët mund t'i

¹⁴⁴ Lawlor, D; Halligan, A. (2020). *Brexit negotiations – progress to date and next steps*, Oireachtas Library & Research Service | L&RS Note, fq: 1.

¹⁴⁵ Po aty, fq: 1.

braktisnin bisedimet, nëse nuk do të ishte arritur ndonjë përparim i dukshëm, deri në qershor. Madje, qeveria shpresonte se bisedimet do të jenë të shpejta dhe se do të dilte një pah një ujdi deri në shtator të vitit 2020. Nëse do të ndodhte braktisja e bisedimeve nga britanikët, atëherë ata do të përqendroheshin në përgatitjet e brendshme rreth përfundimit të periudhës tranzitore. Palët u zotuan të bisedojnë për tregtinë e mallrave, shërbimeve dhe investimeve, fusha të nivelizuara për konkurrencë të ndershme, transport, energji, bashkëpunim civil nuklear, peshkatori, lëvizshmëri dhe bashkërendim sigurie sociale, zbatim ligji dhe bashkërendim juridik në çështje kriminale, bashkërendim tematik, pjesëmarrje në programet e BE-së, përgatitje horizontale dhe qeverisje.¹⁴⁶

Qeveria e Britanisë së Madhe kishte kumtuar një deklaratë formale ku shprehte qasjen e saj ndaj bisedimeve. Sipas kësaj deklarate, vegimi britanik për marrëdhëniet e ardhme me BE-në tashmë ishin përcaktuar në manifestin e qeverisë, në zgjedhjet e fituara të dhjetorit të vitit 2019. Ky vegim bazohet në marrëdhënie të bashkëpunimit miqësor, respektin e ndërsjellë të sovranitetit dhe të autonomisë mbi të drejtën e administrimit të burimeve të veta, dhe se nuk do të negociohet ndonjë rregullim ku Britania e Madhe nuk i ka në kontroll të saj ligjet dhe jetën politike. Nga kjo deklaratë u kuptua se Britania e Madhe kishte qëndrim të kundërt me BE-në rreth, e cila mendonte se të gjithë elementet e marrëdhënieve të ardhme duhet që të negociohen brenda një traktati. Britanikët theksuan se ka disa sfera, si politika e jashtme dhe ajo e imigracionit duhet të përcaktohen nga vetë Britania e Madhe, pa ndonjë marrëdhënie të institucionalizuar.¹⁴⁷

Krahas Marrëveshjes së daljes, Britania e Madhe dhe BE-ja përgatitën edhe Deklaratën Politike, nëpërmjet së cilës e përcaktuan kornizën e marrëdhënieve të ardhme dhe bazën e bisedimeve për një marrëveshje të tregtisë së lirë, arritja e së cilës u konsiderua si rezultati më ambicioz. Mirëpo, duke i analizuar skenarët e ndryshëm që ishin të mundshëm pas referendumit të suksesshëm, si dhe duke u bazuar në zhvillimet e njëpasnjëshme pas këtij referendumi, tashmë u bë e qartë se Britania e Madhe u nis drejt një Brexit-i të vështirë. Dy ishin rezultatet e mundshme të bisedimeve tregtare, një marrëveshje e tregtisë së lirë ose një dalje e britanikëve pa një marrëveshje përfundimtare. Dhe siç është cekur edhe në kapitullin paraprak, nëse nuk ka

¹⁴⁶ *Brexit Brief* Issue 82. (2020). The Institute of International and European Affairs, fq: 1-2.

https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/03/BrexitBrief_82.pdf

¹⁴⁷ Po aty, fq: 1-2.

marrëveshje, atëherë në fuqi do të hyjnë rregullat bazë të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), që në fakt paraqetë një Brexit të vështirë. Por, edhe pse palët deklaruan se janë për të arritur një marrëveshje të tregtisë së lirë, arritja e saj dukej tepër larg, sepse bisedimet ishin tepër të vështira.¹⁴⁸

Bisedimet ishin të tilla sa që, në një moment, pati edhe përplasje deklarimesh ndërmjet palëve. Në një situatë të caktuar, u raportua se kryenegociatori britanik David Frost e kishte tërhequr ftesën e tij drejtuar kryenegociatorit të BE-së, Michel Barnier, për ta vizituar Londrën. Edhe kryeministri Boris Johnson reagoi ndaj takimit të Këshillit European të tetorit 2020. Sipas tij, BE-ja kishte miratuar një pozicionim të pakompromis. Madje, Johnson theksoi se BE-ja “dëshiron lirinë legjislativë, peshkatarinë tonë, në një mënyrë të papranueshme për një shtet të pavarur”. Sipas tij, Britania e Madhe duhej të përgatitet për një zgjidhje pa marrëveshje. Edhe një zëdhënës i Johnson-it kishte deklaruar se bisedimet kanë marrë fund. Por, Johnson la të kuptohej se nuk mori fund gjithçka, duke bërë të ditur se Britania e Madhe ishte e gatshme për të dëgjuar nëse BE-ja do të bënte “disa ndryshime thelbësore në qasje”.¹⁴⁹ Nga ana tjetër, edhe Michael Barner ishte në pozitë të vështirë, pasi përballëj me sfidën e baraspeshimit të një kompromisi të pranueshëm që do të kënaqte këmbënguljen e shteteve të BE-së që Britanisë së Madhe të mos i jepet përparësia konkurrese. Pengesë shkaktonte edhe projektligji britanik për tregun e brendshëm që sipas BE-së ishte në kundërshtim me dispozitat e Marrëveshjes së daljes. Në lidhje me këto zhvillime, gazeta Telegraph komentoi se “u përshtatet të gjithëve që negociatorët të bisedojnë më tutje, ndërkajq liderët të kënaqen me pak teatër politik”. Nga ana tjetër, Irish Times argumentonte se “përtej retorikës dhe shfaqjeve vepruese në Downing Street, palët janë më afër se kurrë dhe se një marrëveshje mbetet rezultati më i mundshëm”.¹⁵⁰

Bisedimet përfundimtare vazhduan në tetor dhe nëntor të vitit 2020, herë në Londër e herë në Bruksel, të mbërthyer nga heshtja, pra informimi tepër i pakët. Kjo tregonte se palët tashmë kishin kaluar në fazën e projektimit të teksteve legale. Në lidhje me këtë fazë, kryetarja e Komisionit, Ursula von der Leyen pati deklaruar se “jemi duke përparuar, por ekzistojnë dy çështje kritike: barazia konkurrese dhe peshkataria, aty ku ne dëshirojmë të shohim më tepër

¹⁴⁸ Barochez, H. (2020). *Brexit: Time is running out to reach to reach an agreement*, Eco Flash 20-19, fq: 3.

<https://economic-research.bnpparibas.com/Views/DisplayPublication.aspx?type=document&IdPdf=39439>

¹⁴⁹ *Brexit Brief* Issue 96. (2020). The Institute of International and European Affairs, fq: 1-2.

https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/10/BrexitBrief_96.pdf

¹⁵⁰ Po aty, fq: 1-2

përparim. Ne jemi në kontakt, për çdo orë, sepse tani bisedimet janë shpeshtuar (...) ka edhe 11 fusha ose çështje që duhet negociuar”. Një buletin në rrjetin Bloomberg thoshte se kishte gjasa që në nëntor të arrihej marrëveshja, megjithatë kjo gjë nuk ndodhi, sepse zërat nga BE-ja insistonin se “asgjë nuk është arritur deri sa nuk ka ujdi për gjithçka”, ndërkaq kalendari për të arritur në një ujdi përfundimtare përcaktohet nga nevoja e ratifikimit të saj nga Parlamenti Europian.¹⁵¹ Edhe BBC kishte raportuar se një ujdi mund që të mos arrihet deri në fillim të dhjetorit, ndonëse përparim thelbësor isht arritur në korniza të gjeta të temave të bisedimeve, por çështja e barazisë konkurruese, kuotat e peshkimit dhe mekanizmat ligjore për zgjidhje të kontestueshme vazhdonin që të jenë pengesa e arritjes së një marrëveshjeje. Ndërkaq, Reuters argumentoi se negociatorëve të Britanisë së Madhe dhe të BE-së do t’u ikë afati i fundit i arritjes së një marrëveshje tregtare pas Brexit-it. Këtë argumentim e forcoi edhe Kryeministri i Irlandës, Micheal Martin, i cili deklaroi për BBC-në se dështimi për të arritur një marrëveshje tregtare do të jetë “tepër tepër dëmtues gjithkrah”. Ministri i Punëve të Jashtme i Irlandës, Simon Coveney argumentoi se duhet të qetësohet gjuha shprehëse e BE-së dhe e Britanisë së Madhe, duke paralajmëruar se një marrëveshje e arritur nuk do të ratifikohet nga BE-ja, nëse britanikët janë të vendosur që të vazhdojnë me Projektligjin e tregut të brendshëm.¹⁵²

Bisedimet vazhduan gjatë nëntorit. Michel Barnier dhe David Frost raportuan se në dy javë bisedime ishte arritur përparim, por që dallimet ende nuk ishin tejkaluar. Media RTE citoi një zyrtar të BE-së të ketë thënë se “puna ka qenë mjaft e hollësishme, e saktë dhe teknike. Ajo përfshin kontrollimin dhe pastrimin e tekstit, ngadalë, një proces torturues. Është arritur përparim i madh dhe janë hequr shumë pengesa. Por, ka patur shumë pak lëvizje në çështjet kryesore”. Kryeministri Johnson deklaroi se “shpresoj shumë se do t’ia arrijmë, por është e qartë se kjo varet nga miqtë dhe partnerët tanë matanë kanalit. Mendoj se një ujdi duhet arritur. Nëse jo, kuptohet se vendi është i përgatitur mirë. Siç e kam thënë më herët, ne mund t’ia bëjmë shumë mirë sipas rregullave australiane, nëse kjo është ajo ku duhet të ecim”.¹⁵³

Bisedimet vazhduan edhe me takime sy më sy ndërmjet kryenegociatorëve Barnier dhe Frost. Pandemia Covid e vështirësoi procesin dhe bisedimet vazhduan nëpërmjet video

¹⁵¹ *Brexit Brief* Issue 97. (2020). The Institute of International and European Affairs, fq: 1-2.

https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/11/BrexitBrief_97.pdf

¹⁵² *Brexit Brief* Issue 98. (2020). The Institute of International and European Affairs, fq: 1-2.

https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/11/BrexitBrief_98.pdf

¹⁵³ Po aty, faqe 1-2

platforms, sepse Barnier mbeti në izolim, ndërkaq koha e përfundimit të periudhës tranzitore po afronte. Këshilli European dhe Parlamenti European caktuan një takim në fillim të dhjetorit, por nuk projekt marrëveshje nuk u arrit. Rrjedhimisht bisedimet vazhduan intensivisht gjatë dhjetorit. Paralelisht u zhvilluan edhe debate për zgjidhje kreative nëse nuk arrihet marrëveshje para 31 dhjetorit 2020. Mirëpo, duke pritur një marrëveshje kreative në kohë të duhur, për ta ratifikuar, mundet që të na shpie në situatën “pa marrëveshje”. Kryenegociatori David Frost theksoi se çfarëdo marrëveshje që do të arrihet duhet që patjetër “të respektojë sovranitetin e Britanisë së Madhe”, përfshi ujërat e peshkimit dhe filialat e afarizmit, dhe se marrëveshje tjetër në baza tjera është e pamundur. Nga ana tjetër, Ursula von der Leyen ka deklaruar se “nuk jemi gati që ta vëmë në pikëpyetje tregun e vetëm, mbrojtësin kryesor të përparimit dhe mirëqenies europiane”.¹⁵⁴

Ndonëse ka takime bisedime të shpeshta, megjithatë marrëveshja duke se është ende më larg, ndonëse Johnson dhe von der Leyen deklaruan se bisedimet do të vazhdojnë edhe më tej. Tashmë u bënë thujt një vit që kur kanë filluar bisedimet dhe shumë afate janë shkelur, por bisedimet vazhduan ditë e natë. Megjithatë, kryeministri Johnson deklaronte se “ujdia duhet të arrihet”, por paralamëronte se Britania e Madhe dhe BE-ja “mbeten shumë lart njëra-tjetrës” në çështjet kyç. Sipas tij, Britania e Madhe nuk mundet që të mbyllet brenda orbitave rregulluese të BE-së, duke shtuar se vendi i tij duhet që ta ketë kontrollin e peshaktarisë, sepse për këtë gjë kishin votuar qytetarët e saj, qysh para katër vjetësh. Ai madje theksoi se, nëse nuk arrihet marrëveshja, atëherë “bëhuni gati, me vetëbesim, nga 1 janari – tregti sipas dispozitave të OBT-së, nëse duhet patjetër”.¹⁵⁵

Që nga marsi, kur filluan bisedimet, e deri në fund të dhjetorit, ekipet negociatore arritën në raundin e nëntë, por ende pa marrëveshje përfundimtare. Kryenegociatorit Barnier e Frost deklaruan se është arritur përparim, por mbeten edhe pak çikërima pa u përmbyllur. David Frost i bëri thirrje BE-së që të tregojë “realizëm dhe fleksibilitet më të madh”, duke u shprehur se kishte mbetur shumë pak kohë për t’u arritur marrëveshja përfundimtare. Pikat e lartpërmendura, si barazia konkurrese e peshkataria vazhduan të jenë ngërçi që nuk i jepte fund procesit negociues

¹⁵⁴ *Brexit Brief* Issue 99. (2020). The Institute of International and European Affairs, fq: 1-2.
https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/12/BrexitBrief_99.pdf

¹⁵⁵ *Brexit Brief* Issue 100. (2020). The Institute of International and European Affairs, fq: 1-2.
https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/12/BrexitBrief_100.pdf

për arritjen e marrëveshjes përfundimare ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së. Qasja e të dy palëve në ujërat e peshkimit ishte çështja që nuk mund të kapërdihej lehtë nga të dyja palët. Britania e Madhe insistonte me çdo kusht që ta ketë sovranitetin e saj të plotë në ujërat e saj të peshkimit, duke mos u dhënë qasje anijeve të peshkimit të BE-së.¹⁵⁶

Një zhvillim pozitiv sikur e shtoi shpresën e arritjes së një marrëveshje përfundimtare. Palët njoftuan se është arritur një pajtim në lidhje me kufirin e Irlandës së Veriut. Gazeta *the Guardian* raportoi se qeveria britanike kishte hequr dorë nga ideja e shkeljes së të drejtës ndërkombëtare në lidhje me Brexit-in. Si BE-ja, ashtu edhe Britania e Madhe bënë lëshime në aspekt të kontrollit të mallrave, kafshëve, produktet e prejardhura, furnizimet mjekësore, deklaratimet e eksportit, dhe produktet tjera për marketet. Por, burime diplomatike të BE-së kishin deklaruar për gazetën se kjo ujdi nuk e ndryshonte rrjedhën e bisedimeve, dhe se bisedimet vazhdonin të mos përfundonin me një marrëveshje tregtare.¹⁵⁷ Kjo çështje, e cila njihet si Protokoll i Irlandës së Veriut, ia mundëson këtij shteti që të mbetet brenda tregut të vetëm të BE-së për mallra, edhe pse pjesa tjetër e Britanisë së Madhe doli përfundimisht nga BE-ja më 31 dhjetor 2020. Palët biseduan për mënyrën e zbatimit të tij, dhe si pika kyç ishin skemat e besueshme që nënkuptonin se shumica e mallrave që nga Britania e Madhe do të hyjnë në Irlandën e Veriut, nuk do të rrezikohen nga vendosja e tarifave. Pjesë e marrëveshjes ishte edhe roli i zyrtarëve të BE-së në Irlandën e Veriut, gjatë mbikëqyrjes së aspekteve të protokollit.

The protocol will keep Northern Ireland in the EU single market for goods even as the rest of the UK leaves it at the end of this month. The two sides had been negotiating on how the protocol should be implemented. Among the key features of the agreement are a trusted trader scheme which will mean the vast majority of goods being shipped from GB to NI will not be at risk of having tariffs imposed. There was also agreement on the role of EU officials in Northern Ireland to oversee aspects of the protocol.¹⁵⁸ Bisedimet për këtë protokoll ishin të vështira, ndërkajq pati edhe reagime të ndryshme. Arlene Foster, ministrja e parë e Irlandës së Veriut

¹⁵⁶ Barochez, H. (2020). *Brexit: Time is running out to reach to reach an agreement*, Eco Flash 20-19, fq: 3-4. <https://economic-research.bnpparibas.com/Views/DisplayPublication.aspx?type=document&IdPdf=39439>

¹⁵⁷ O'Carroll, L. (2020). *UK drops plans to break international law as Northern Ireland deal is reached*, 8 dhjetor 2020. <https://www.theguardian.com/politics/2020/dec/08/brexit-uk-drops-plans-to-break-international-law-as-northern-ireland-deal-is-reached> (qasja e fundit: 22 dhjetor 2020)

¹⁵⁸ Campbell, J. (2020). *Brexit: UK and EU announce agreement on new Irish Sea border*, 17 dhjetor 2020. <https://www.bbc.com/news/uk-northern-ireland-55354451> (qasja e fundit: 31.12.2020)

deklaroi se për ata ishte e rëndësishme që të gjitha çështjet përfunduan në aspekt të qasjes së pakufizuar nga Irlanda e Veriut në Britaninë e Madhe, por se edhe tregtia ndërmjet të dy vendeve mund të zhvillohet lirshëm. Por, lideri unionist, Steve Aiken paralajmëroi se protokolli mund të shkaktonte kontroll të valixheve të pasagjerëve që ktheheshin nga Britania e Madhe në Irlandën e Veriut, si dhe kontroll të blerjeve online, duke shtuar se mund të kishte edhe rritje të çmimeve të mallrave të transportuara nga Britania e Madhe, ndërkaq ministri i Punëve të Jashtme, Simon Coveney deklaroi se marrëveshja ishte një lajm pozitiv. Sipas tij, ky ishte një zhvillim pozitiv që erdhi si rezultat i angazhimit pozitiv dhe frytdhënës nga të dyja ekipet negociatore, duke shtuar se arritja do të ishte një shtytje drejt kontekstit më të gjërë të bisedimeve për marrëdhëniet e ardhme.¹⁵⁹

Arritja e ujdisë për Irlandën e Veriut, ndonëse u pa si hap pozitiv drejt marrëveshjes përfundimtare, në fakt sikur edhe më shumë i shtoi dyshimet se nuk do të ketë një marrëveshje përfundimtare. Ky mendim sundonte kudo, pasi të dyja palët vazhdimisht paralajmëronin për një pamundësi të arritjes së marrëveshjes. Burime qeveritare britanike deklarorin se kushtet e ofurara nga BE-ja vazhdonin që të ishin “të papranueshme” për britanikët. Por, kryeministri Boris Johnson dhe presidentja Ursula von der Leyen, zhvilluan një bisedë me njëri-tjetrin dhe vendosën që bisedimet të mos ndalen.¹⁶⁰ Në deklaratën e tyre të përbashkët ata theksuan se “ishte e përgjegjshme që në këtë situatë të bëhet çmos për të arritur diçka”. Johnson dhe Leyen diskutuan “tema të rëndësishme të pazgjidhura”. Ata dhanë urdhër që ekipet negociatore të vazhdojnë me bisedimet në Bruksel “që të shohim nëse një marrëveshje mund të arrihet në këtë fazë zë vonshme”, duke mos përcaktuar ndonjë datë të përmbylljes së tyre, edhe pse dihej se data e fundit ishte 31 dhjetori 2020, duke mos harruar se duhej të lihet hapësirë kohore për Britaninë e Madhe dhe Parlamentin Europian për të votuar çfarëdo ujdie që do t’u vihej në tavolinë para kësaj date.¹⁶¹

¹⁵⁹ Simpson, C. (2020). *Last-minute Brexit deal reached on Northern Ireland border checks*, 9 dhjetor 2020, <https://www.irishnews.com/news/northernirelandnews/2020/12/09/news/last-minute-brexit-deal-reached-on-northern-ireland-border-checks-2154979/> (qasja e fundit: 31.12.2020)

¹⁶⁰ *Brexit: EU offer 'unacceptable' as trade talks continue*, 13 dhjetor 2020, <https://www.bbc.com/news/uk-politics-55290109> (qasja e fundit: 31.12.2020)

¹⁶¹ *Brexit trade talks: UK and EU to 'go the extra mile' in effort to agree deal*, 13 dhjetor 2020, <https://www.bbc.com/news/uk-politics-55292890> (qasja e fundit: 31.12.2020)

Vendosmëria për të arritur një marrëveshje, e shoqëruar edhe nga pasigura për të ndodhur e kundërta, sikur filloi të jep rezultate. Kryeministri Boris Johnson bëri disa lëshime, duke e ngushtuar ende më shumë hapësirën drejt arritjes së marrëveshjes. Kështu kishte raportuar në Bruksel kryenegociatori i BE-së, Micael Barnier. Sipas tij, Johnson kishte pranuar që të ketë konkurrencë të ndershme për afaristët britanikë dhe të BE-së, pasi standardet që ndryshojnë me kalim kohës, kishin zhbllokuar bisedimet. Më tutje, Barnier kishte theksuar se qeveria britanike kishte pranuar një mekanizëm të masave unilaterale, siç janë tarifatat ku kishte “divergjenca sistematike të cilat shtrembërojnë tregtinë dhe investimet”, një mekanizëm që duhej të jetë i besueshëm dhe efektiv. Edhe von der Leyen deklaroi se ka lëvizje pozitive dhe se çështja ishte shumë pranë përmbylljes. Sinjalet pozitive vinin edhe nga Britania e Madhe, nga ku zërat thoshin se do të vazhdohej me punë, dhe shpresohet për të arritur marrëveshjen e tregtisë së lirë. Por, Barnier paralajmëroi se te çështja e peshkatarisë, vazhdonte të kishte një ngërç që nuk i linte gjërat të përmbyllen, duke shpresuar se edhe kjo do të tejkalohet. Sipas tij, “konkurrenca e ndershme dhe zgjidhja e qëndrueshme për peshkatarët tanë dhe grupe, janë çelësi i arritjes së ujdisë”.¹⁶²

Ndonëse u hodhën disa hapa drejtë marrëveshjes përfundimtare, paralajmërimet për një skenar pa marrëveshje vazhdonin të ishin të pranishme. Kryeministri Johnson zhvilloi edhe një bisedë tjetër me kreun e Komisionit Europian, Ursula von der Leyen, pas së cilës paralajmëroi se ishte “shumë e mundshme” që të mos ketë marrëveshje, dhe se kjo do të ndodhte nëse BE-ja nuk do të bënte ndonjë lëshim “thelbësor”. Nga ana tjetër, von der Leyen theksoi se çështja vazhdonte të ngecte te peshkatarai, duke shtuar se përparim në bisedime kishte, dhe se duhej bërë çmos në dy javët e mbetura, para se Britania e Madhe të vazhdonte pa rregullat tregtare të BE-së.¹⁶³ Pak më vonë, kryenegociatori i BE-së, Michael Barnier deklaroi se “kishin mbetur edhe pak orë” që palët të arrinin marrëveshjen përfundimtare tregtare pas Brexit-it. Duke folur në Parlamentin Europian, Barnier kishte folur për çastin e së vërtetës për të dyja palët, duke

¹⁶² Boffey, D; Henley, J. (2020). *Brexit trade deal possible within days after Johnson concession, says EU*, 14 dhjetor 2020, <https://www.theguardian.com/politics/2020/dec/14/brexit-trade-deal-possible-within-days-after-johnson-concession-says-eu?fbclid=IwAR09QuDm1Nr5Wb0rykddyZ7NG791iIR0DCkJa2SjnK-fY0txtYaSsIBFXIE> (qasja e fundit: 31.12.2020)

¹⁶³ *Brexit: Trade talks in 'a serious situation' says Boris Johnson*, (17 dhjetor 2020), <https://www.bbc.com/news/uk-politics-55347723?fbclid=IwAR09QuDm1Nr5Wb0rykddyZ7NG791iIR0DCkJa2SjnK-fY0txtYaSsIBFXIE> (qasja e fundit: 31.12.2020)

theksuar se ende kishte mundësi për marrëveshje dhe se kjo ishte shumë afër. Sipas tij, britanikët ishin të intersuar që bisedimet të vazhdonin, duke shtuar se, edhe pse kishte mjaft vështirësi, megjithatë ekzistonte mundësia që të arrihej atje ku palët ishin duke biseduar. Por, peshkataria vazhdonte të ishte pengesa e arritjes së marrëveshjes. Për këtë qëllim, Barnier i kishte takuar ministrat e BE-së me të cilët kishte debatuar për këtë çështje. Ndërkaq edhe trysnia britanike ndaj Boris Johnson shtoej. Atij i kërkohet që “ta arrinte këtë marrëveshje”.¹⁶⁴

Në prag të kërshtëndellave, pas shumë fazash të bisedimeve dypalëshe Britani e Madhe-BE, më në fund u arrit ujdia historike e marrëdhënieve të ardhme tregtare dhe të sigurisë ndërmjet të dy palëve, duke shkaktuar reagime fitimtare, si në Londër, ashtu edhe në Bruksel. Pas 31 dhjetorit, Britania e Madhe largohet nga tregu i vetëm dhe doganat e BE-së, duke e patur mundësinë e tregtisë së lirë të mallrave, përfshi bashkëpunimin e ngushtë policor dhe juridik. Lajmi u bë i ditur nga kryeministri Boris Johnson dhe presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen. Marrëveshja prej afër 2000 faqesh përmban dispozita për temat nga bashkëpunimi atomik civil dhe ndërlidhja energjetike të peshkataria dhe aviacioni. Nga qeveria britanike erdhën deklaratimet se “Marrëveshja u arrit. Gjithçka që iu premtua publikut britanik gjatë referendumit të vitit 2016 dhe zgjedhjeve të përgjithshme të vitit të kaluar vjen me këtë marrëveshje. Paratë tona i kemi rikthyer nën kontroll, kufijt, ligjet, tregtinë dhe ujërat e peshkimit. Marrëveshja është një lajm i mrekullueshëm për familjet dhe afaristët në të gjithë Britaninë e Madhe. Kemi nënshkruar një marrëveshje të tregtisë së lirë me tarifa dhe kuota zero, diçka e arritur ndonjëherë”. Ndërkaq, në komentine saj para medie, Ursula von der Leyen, ajo e citoi dramaturgun Shakespeare, grupin the Beatles dhe shkrimtarin TS Eliot. “Ishte një rrugë e gjatë e gjarpëruese, por ne e arritëm një ujdë të mirë për ta prezantuar. Është e ndershme, e balancuar dhe është gjëja e duhur dhe e përgjegjshme që duhet ta bëjnë të dy palët”, deklaroi von der Leyen. Ajo shtoi se “në fund të bisedimeve të suksesshme, kuptohet se jam e lumtur. Por, sot ndiej kënaqësi, dhe, thënë sinqerisht, lehtësim. E di se kjo është një ditë e vështirë për disa dhe për miqtë tanë në Britaninë e Madhe. Dëshiroj të them se ndarja aq vuajtje e këndshme, por duke i përdorur vargjet e TS Eliot, atë që e konsiderojmë fillimi, shpesh është fundi. Dhe, për të arritur fundin, shpesh ia nisim nga e para. Prandaj, për të gjithë europianët, besoj se është koha që ta

¹⁶⁴ *Just a few hours' left to agree Brexit trade deal, says Michel Barnier*, (18 dhjetor 2020), <https://www.bbc.com/news/uk-politics-55358963> (qasja e fundit: 31.12.2020)

lëmë pas Brexit-in”. Leyen rikonfirmoi se ujdia garanton tarifa dhe kuota zero për tregtinë në mallra, që në vitin 2019 ishin afër 700 bilionë funta, duke shtuar se do të ketë shpenzime të mëdhaja për afaristët pasi eksportuesit do të përballen me kontroll kufitar nga 1 janari dhe lëvizja e lirë për shumicën e qytetarëve të Britanisë së Madhe në BE do të marrë fund.¹⁶⁵

Marrëveshja e tregtisë dhe e sigurisë pas Brexit-it e siguroi mbështetjen unanime të shteteve anëtare të BE-së, duke ua çelur rrugën e zbatimit rregullimeve të reja nga 1 janari 2021. 27 ambasadorët e shteteve anëtare të BE-së u mbledhën në Bruksel dhe e mbështetën marrëveshjen që të zbatohet provizionisht. Parlamenti Europian do të votojë me vonesë për këtë marrëveshje. Ata shpresojnë që votimi të ndodhë në shkurt ose mars, kur parlamentarët të kthehen në Strasburg, për ta ratifikuar formalisht. Edhe presidenti i Këshillit Europian, Charles Michel deklaroi se shpreson që marrëveshja e tregtisë dhe e sigurisë do të jetë platformë bashkëpunimi. Ndërkaq, Boris Johnson deklaroi se “marrëveshja do të ishte pikënisje e marrëdhënieve tona, ndërmjet sovranëve të barabartë”, duke shtuar se pret një ratifikim formal dhe bashkëpunim për ndryshimet klimatike. Kryenegociatori i BE-së, Michael Barnier deklaroi për gazetën franceze “*le Figaro*” se “kjo marrëveshje duhet patjetër të jetë bazë e bashkëpunimit të mençur dhe të qëndrueshëm ndërmjet Europës dhe Britanisë së Madhe”, duke parashtruar pyetjen se “a mund të jemi të lumtur për një ndarje?”. Sipas tij, marrëveshja thuhet se ishte rezervuar në disa raste.¹⁶⁶

Arritja e marrëveshjes përfundimtare i hapi rrugë ratifikimit të saj edhe nga ligjvënësit britanikë të cilët votuan “për” marrëveshjen, duke synuar çeljen e një kapitulli të ri të marrëdhënieve me BE-në pas 31 dhjetorit 2021, pas katër vite bisedimesh. Në lidhje me këtë, kryeministri Boris Johnson deklaroi se “Bexit-i nuk është fundi, por fillimi. Përgjegjësia qëndron mbi të gjithë ne për të bërë përdorimin më të mirë të pushtetit që e rimarrim, të mjeteve që i rikthejmë në duart tona.” Dhoma e Ulët e Parlamentit votoi 521 ndaj 73 “për” marrëveshjen. Edhe mbretëresha Elizabetë e dha pëlqimin përfundimtar që ia dha mundësinë qeverisë të zbatojë dhe ratifikojë këtë marrëveshje. Por, marrëveshja nuk ka mbetur pa u kritikuar. Partia Laburiste

¹⁶⁵ Boffey, D; O’Carroll, L. (2020). *UK and EU agree Brexit trade deal*, (24 dhjetor 2020), <https://www.theguardian.com/politics/2020/dec/24/uk-eu-agree-brexit-trade-deal-agreement> (qasja e fundit: 31.12.2020)

¹⁶⁶ Boffey, D. (2020). *EU states unanimously back Brexit trade and security deal*, (28 dhjetor 2020) <https://www.theguardian.com/politics/2020/dec/28/eu-member-states-unanimously-back-brexit-trade-security-deal?fbclid=IwAR0vkLRwA1Ka4mcmHSDhUwO6r5mUJOyzKkzMBb3qCAKXGuluUyXg7ZZbkU> (qasja e fundit: 31.12.2020)

opozitare deklaroi se marrëveshja nuk e mbron tregtinë me shërbime, e as tërbimin e peshkatarëve, dhe se kryeministri Johnson i ka tradhtuar interesat e tyre, duke shtuar se statusi i Irlandës së Veriut mbetet e paqartë. Megjithatë, kryeministri Johnson arriti që ta sigurojë mbështetjen e atyre që ishin për Brexit-in. Madje, ligjvënësi Bill Cash deklaroi se Johnson-i i dha fund nënshtrimit katërdekadësh të demokracisë ndaj Brukselit, duke shtuar se shpresonte që çështja e marrëdhënieve politike me europën duhet të marrë fund, që Britania e Madhe të bëhet shoku dhe aleati më i mirë i BE-së.¹⁶⁷

Marrëveshja e arritur tashmë quhet “Marrëveshja e tregtisë dhe e bashkëpunimit BE-Britani e Madhe”. Më 30 dhjetor të vitit 2020, presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen dhe presidenti i Këshillit European, Charles Michel e nënshkruan këtë marrëveshje në emër të BE-së, ndërkaq Boris Johnson e nënshkroi në emër të Britanisë së Madhe.¹⁶⁸

¹⁶⁷ James, W; Baczyńska, G. (2020). *UK parliament approves Brexit trade deal with EU as both sides look to future*, (30 dhjetor 2020), https://www.reuters.com/article/uk-britain-eu-idUSKBN2940UZ?fbclid=IwAR1PO3bPkSU6Ya4tbo4IltFyK4G_iCaoqTzlboWB1cjys1QNnqxy738Nto (qasja e fundit: 31.12.2020)

¹⁶⁸ *Brexit trade deal: History is made as EU chiefs and UK PM sign agreement on future relationship*, (30 dhjetor 2020) https://www.euronews.com/2020/12/29/eu-and-uk-leaders-to-sign-post-brexit-trade-deal-on-wednesday-morning?fbclid=IwAR3Tm3TrzOUOxEZtjlQnXI7_hBdY7G3qzAOjUG0HG0Kxi7SeUC_U2BTXZCk (qasja e fundit: 31 dhjetor 2020)

Konkluzionet

1. Nuk e priste askush që pas shumë vitesh në BE, Britania e Madhe ta sfidojë për së dyti herë qëndrimin e saj në këtë bashkim forcash ekonomike e politike europiane kaq të suksesshëm, me ndryshimin e vetëm – referendumi kësaj radhe doli i suksesshëm. Mirëpo, për të studiuar si duhet këtë situatë, kuptohet se fillimisht duhet të dimë se si nisi BE-ja, diçka për të cilën kemi folur në kapitullin e parë të kësaj teme. Kuptohet se kjo na vë në dijeni se cilido shtet që do të dëshirojë të anëtarësohet, duhet që të jetë i gatshëm, pra të përgatitet, sepse brenda një bashkimi të këtillë nuk do të mund që një shtet të vendosë kokë më vete, përkatësisht anëtarësimi ka rregulla dhe veprimi brenda ka gjithashtu rregulla të sjelljes së një shteti brenda saj. Prandaj, vetë fillimi i BE-së, hapat e ndërmarrë, lëshimet që gjashtë shtete e para bënë për ta themeluar, ka qenë një pasqyrim i saktë dhe i duhur i asaj se çfarë është dhe ku synon të arrijë ky bashkim forcash ekonomike e politike. Jorastësisht, një shtet si Britania e Madhe, që njihet si një perandori e madhe, që ka pasur (dhe ende ka) qasje thuaj se në tërë globin, në fillim nuk e mbështeti këtë nismë, prandaj edhe nuk u bë pjesë e themeluesve të saj. Madje, britanikët sikur nuk e morën aspak në konsideratë, duke e konsideruar si një hap të ngutshëm dhe të pamatur të vendeve europiane, hap që nuk do të sjell ndonjë rezultat të madh, e as konkurrues, e e3srrjedhimisht do të dështojë shpejtë. E gjithë kjo erdhi si rezultat i besimit se Britania e Madhe është shtet i fuqishëm dhe që ka ndikim të madh në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke marrë parasysh edhe kontributin e saj në fitoren në Luftën e Dytë Botërore. Qasja e këtillë e Britanisë së Madhe ndaj BE-së, në filllet e saj, erdhi edhe si rezultat i mënyrës se si ajo u themelua. Që në fillim, britanikët u frikësuan nga humbja e sovranitetit, apo edhe e primatit ndërkombëtar që e kishin dikur, prandaj ata e shikuan bashkëpunimin e gjashtë shteteve europiane si diçka të dyshinët dhe pa një të ardhme të sigurt.
2. Siç e theksuam, Britania e Madhe nuk ishte në grupin e shteteve themeluese të BE-së. Shteti ishullor ishte mësuar që të veprojë e vetme, dhe vetëm me raste të bëhet pjesë e aleancave të mëdhaja. Ndaj projektit franko-gjerman, Britania e Madhe reagoi me tone negative. Mirëpo, jo të gjithë shtetarët britanikë e shikuan me dyshim nismën më të re europiane. Kishte nga ata të cilët menduan se ndoshta është një hap pozitiv nga i cili Britania e madhe do të përfitojë, pra nëse do të jetë pjesë e saj, të paktën nuk do të

dëmtohet edhe pse mund të mos fitojë kushedi çfarë. Tema europiane, për fat të keq, ndikoi në një përçarje të thellë në politikën britanike. Ata që udhëhiqnin me vendin u reshtuan në taborin kundër projektit europian, ndërkaq ata që ishin në opozitë, u reshtuan në taborin për projektin europian. Megjithatë, ata shtetarë që në ato vite të para udhëhiqnin me Britaninë e Madhe, përfundimisht e vlerësuan nismën si të pazbatueshme, rrjedhimisht nuk u bënë pejsë e saj. Zhvillimet e atëhershme do të marrin një tjetër rrjedhë dhe, si pasojë, Britania e Madhe dë ndryshojë mendim. Ajo do të kërkojë anëtarësimin e saj në BE-në e atëhershme. Ishte shumë e rëndësishme që edhe kjo pjesë të analizohej mirë, sepse na jep një pasqyrim të saktë dhe na mundëson të krijojmë një lidhje me zhvillimet e atëhershme, sa ato zhvillime kanë ndikuar në anëtarësimin e Britanisë së Madhe në BE, qëndrimin e saj në bashkësi dhe deri te dalja e bujshme. Ajo çfarë mund të konkludojmë është se Veto-ja franceze ndaj kërkesës britanike nuk duhej që të ndodhte sepse, në radhë të parë e vonoi për dhjetë vjetë anëtarësimin e Britanisë së Madhe në BE, dhe në radhë të dytë, kjo Veto mund të konsiderohet si frikë franceze ndaj një konkurrenti të fuqishëm si Britania e Madhe. Por, rregullat ishin të atilla dhe pesë shtetet tjera anëtare të BE-së së atëhershme nuk mundën të bëjnë diçka më tepër që të ndryshojnë mendjen e lidërsipit të atëhershëm francez. Kur jemi te francezët, një çështje mund të konsiderohet se ishte pengesë. Marrëdhëniet tepër të afërta të Britanisë së Madhe me SHBA-në ndikoi që francezët të kenë qëndrim kundër anëtarësimit të britanikëve në projektin europian. Largimi i de Gaulle nga pushteti dhe ardhja e Pompidiou-së ishte kyç në ndryshimin e qasjes franceze ndaj anëtarësimit të Britanisë së Madhe. Franca e Pompidiou-së nuk e shihte Britaninë e Madhe si një konkurent, por si një aleat të rëndësishëm. Pikërisht, kjo ishte ajo që duhej të ndodhte që më parë, ndonëse francezët anëtarësimin e Britanisë së Madhe e trajtuan edhe si diçka në interes të Francës brenda Bashkësisë, si një baraspeshim ndaj Gjermanisë, një ekonomi e fuqishme europiane edhe në ditët e sotme të BE-së. Edhe zhvillimet politike në Britaninë e Madhe, në këtë periudhë ndryshimi në Francë, mund të cilësohen si pozitive për t'i hapur rrugë anëtarësimit të shtetit ishullor në familjen europiane. Konservatorët britanikë të viteve 1970 të shekullit XX e konsideronin idenë europiane si diçka mjaftë pozitive. Kjo ishte shtytja që i duhej Britanisë së Madhe dhe kjo e hoqi frikën se ky vend mund të jetë humbëse, nëse anëtarësohet në familjen europiane. Pozitive mund të shihet edhe qasja e

atëhershme e tyre ndaj SHBA-së dhe Comonwealth-it dhe kthimi më shumë drejt Parisit, Bonit e Romës. Përfundimisht, Britania e Madhe u anëtarësua në BE më 1973, por duhet theksuar se ky anëtarësim u shoqërua me reagime të brendshme të cilat janë të rëndësishme të merren parasysh kur diskutohet për temën e Brexit-it. Duhet theksur se anëtarësimi paraprak i Britanisë së Madhe në Asociacionin e Tregtisë së Lirë Europiane (ATLE) nuk duhej të ndodhte. Ky veprim mundet lirisht të konsiderohet si tentim për t'iu kundërvënë projektit europian, diçka që nuk duhej të ndodhte. Si pasojë, edhe rezultatet nga ky anëtarësim ishin të dobëta, prandaj Britania e Madhe hoqi dorë dhe i hodhi sytë nga BE-ja e atëhershme që ishte shumë më e suksesshme. Anëtarësimi mund të konsiderohet dhe si një frikë nga izolimi.

3. Anëtarësimi i Britanisë së Madhe në BE-në e atëhershme nuk i shoi përplasjet politike dhe reagimet brenda këtij shteti. Politikat e tilla si ajo bujqësore dhe kontributi në buxhetin e përbashkët, të cilave duhej t'u bindej Britania e Madhe, shkaktuan edhe më shumë krizë, sa që kryeministri i atëhershëm Harlod Wilson e çoi vendin në referendumin e parë për dalje nga BE-ja. Ky është një zhvillim mjaft dramatik që duhet të merret në konsideratë, kur të flasim Britaninë e Madhe brenda BE-së, sepse mendoj se ka ndikuar në sjelljen e britanikëve brenda familjes europiane. Por, referendumi përfundoi pa suksese, pra populli vendosi që Britania e Madhe të vazhdojë të mbetet anëtare e projektit europian. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se gjërat u rregulluan. Pakënaqësitë e shtetit ishullor nuk morën fund me kaq. Britanikët nuk ishin mësuar që të jenë pjesë e një bashkimi ku vendi duhej të respektojë një vendim të cilin nuk e ka marrë vet, por janë të përfshira disa palë në këtë vendimmarrje. Rrjedhimisht, kjo u pa si një humbje të krenarisë britanike, si një humbje të sovranitetit britanik. Kjo u pa si një lojë pa fitore, dhe britanikët filluan të konsiderojnë se pa humbjen e një pjese të sovranitetit të shtetit nuk mund të mbahej gjallë projekti europian. Jorastësisht qaska e Britanisë së Madhe ndaj BE-së ishte e ashpër, duke bërë që të konsiderohej si “partner i vështirë”. Kjo dëshmohej nga veprimet e njëpasnjëshme britanike që ndërlidheshin drejtpërdrejt me anëtarësimin në BE. Ndonëse patën qëndrim proeuropean dhe britanikëve u kërkuan që të votojnë për qëndrim në familjen europiane, konservatorët e Margareth Thatcher do të shkaktojnë disa përplasje të ashpra me BE-në. Refuzimi i Sistemit Monetar European është një pikë tjetër e rëndësishme në përplasjen e Britanisë së Madhe me anëtarësimin në

BE. Edhe ky rast duhet të merret tepër seriozisht dhe të trajtohet si një hapësirë e paplotësuar që do të jetë bazë e zhvillimeve drejt daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja. Ky veprim paraqet një hap pas drejt bashkimit edhe më të afërt të anëtarëve brenda projektit europian. Ndërkaq, çështja tjetër që shkaktoi përplasje të britanikëve brenda BE-së është edhe ajo e kontributit në buxhetin e BE-së. Mendimi se Britania e Madhe jepte shumë, por merrte pak ishte shkaktar që kjo çështje të bëhej “mollë sherri”. Thjesht, britanikët mendoni se u takon që të marrin më tepër. Por, sektori i bujqësisë i tyre nuk ishte aq i zgjeruar, ndërkaq paratë e buxhetit të BE-s shkonin më tepër në bujqësi. Rrjedhimisht, Britania e Madhe nuk merte aq sa mendonte se duhej që të marrë. Në bisedimet e vështira, britanikët e morën atë që e kërkuan, duke e shndërruar vendin në një konfrontues të hapur ndaj politikave të BE-së. Ky rast është pararendës i përplasjeve tjera që do të rrjedhin deri në referendumin për dalje nga BE-ja.

4. Britania e Madhe nuk arriti që ta gjejë qetësinë e saj as në fillim të viteve 1990 të shekullit XX. Pranimi, e më pas braktisja e Mekanizmit të Kursit të Këmbimit i dha shtytje të mëtutjeshme asaj që më vonë do të bëhet problemi kyç – euroskepticismi, dyshimit ndaj projektit europian. Kjo shkaktoi dobësimin e funtës, rrjedhimisht ndikoi që kriza politike në vend të thellohet. Traktati i Maastricht-it, që e formalizoi Bashkimin Europian të sotëm, ishte përkeqësimi i radhës i Britanisë së Madhe me BE-në. Aspektet e sigurisë, të drejtësisë, të politikës së brendshme dhe të jashtme të BE-së ishin çështja e radhës të cilat Britania e Madhe, ndonëse i pranoi, në të vërtetë nuk i dëshiroi. Kjo shkaktoi edhe më tutje përplasje politike dhe dorëheqje. Ky traktat u pa si humbje ende më e madhe e sovranitetit dhe varësi ndaj Brukselit. Këto zhvillime ndikuan që Britania e Madhe të deklarohet kundër monedhës “euro” dhe kundër Marrëveshjes së Schengen-it. Kjo automatikisht nënkupton një largim ende më të madh nga projekti i BE-së. Duhet theksuar se të gjitha këto zhvillime kundërtënëse ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së u shoqëruan me rezultate pozitive sepse eksporti dhe importi britanik me BE-në u rrit në 60%, pra marrëdhëniet tregtare u thelluan së tepërmi. Zgjerimi i BE-së i vitit 2004 me dhjetë shtete anëtare të reja që vinin nga ish-bloku komunist, u konsiderua si mundësi e artë për Britaninë e Madhe. Si rezultat, vendi ishullor u vërshua nga imigrimi i popullsisë së këtyre vendeve. Kjo situatë nxiti zemërim te britanikët dhe frikë nga imigracioni i papërbalueshëm, pra euroskepticismi iu shtua edhe kundërshtimi i hapur ndaj imigrimit

nga vendet tjera të BE-së drejt Britanisë së Madhe. Ky mjet erdhi si dhuratë për zërat që u bënë tepër të zhurmshëm e që kërkonin dalje të Britanisë së Madhe nga BE-ja. Në pah dolën parti politike populiste të cilat para vetes vunë Brexit-in, si interes më të lartë kombëtar të tyre. Ata do të fitojnë terren edhe në zgjedhjet e mëvonshme deri në përmbylljen me sukses të referendumit për Brexit-in. Zotimi i kryeministrit David Cameron se do të ofrojë një referendum të këtillë e nxiti edhe më shumë aktivitetin e partive të cilat mendonin se Britania e Madhe duhej patjetër të dalë nga BE-ja, që sipas tyre, ta rikthejë sovranitetin e saj dhe shkëlqimin e dikurshëm në arenën ndërkombëtare.

5. Njoftimi i kryeministrit Cameron për rinegocim të marrëdhënieve të Britanisë së Madhe me BE-në, e më pastaj edhe referendumi, që pritej të ndodhte në vitin 2017, nuk mund të konsiderohet si një veprim i papritshëm ose surprizë sepse anëtari ishullor i BE-së ka patur vështirësi qysh në fillim të integritetit europian në vitet 1950. Ky zhvillim erdhi në çastin e ngritjes së lartë të euroskepticizmit dhe të partive populiste të cilat e shfrytëzuan më së miri dhe e arritën rezultatin e dëshiruar – një PO për daljen e Britanisë së Madhe nga BE-ja. Ky zhvillim nuk erdhi hë për hë, por si rezultat i shumë përplasjeve britanike me politikat rregullatore të anëtarësimit në BE dhe të funksionimit të saj. Britania e Madhe e konsideronte veten si një fuqi më superiore sesa ajo europiane dhe kjo ndodhi si rezultat i të qenët fituese në Luftën e Dytë Botërore. Veç kësaj, anëtarësimi në BE tashmë nuk shihej e as trajtohej si një dëshirë e shtetit britanik, por si një nevojë mbijetese e cila u shkaktua nga kriza të shumëta të asaj periudhe, dhe si diçka që është tejkaluar e ky vend mund të hapërojë e vetme më tutje. Vërejtejt e Britanisë së Madhe ndaj BE-së nuk u artikuluan mjaftueshëm, rrjedhimisht nuk pati ndonjë debat brenda BE-së për ankesat e këtij shteti anëtar. Më të zëshme u bënë kërcënimet për dalje nga BE-ja sesa ankesat për reforma brenda BE-së të cilat do ta kënaqnin Britaninë e Madhe dhe do ta ndalonin Brexit-in. Kjo nënkupton se edhe BE-ja nuk ndërmori ndonjë hap të madh drejt dëgjimit të vërejtjeve, sepse ato nuk ishin aq të zëshme dhe bindëse që të merreshin në konsideratë. Si rezultat i kësaj, angazhimi i BE-së për ta bindur Britaninë e Madhe u mund nga angazhimi në Britaninë e Madhe për dalje nga BE-ja. Në këtë drejtim ndikoi edhe presidenca amerikane e udhëhequr nga Donald Trump. Ndërhyrjet e tij, mënyra e qeverisjes së tij, u morën si model dhe u shfrytëzuan nga partitë populiste dhe euroskeptikët britanikë të cilët dolën fitimtar në atë që kërkuar, pra Brexit-i u mbështet

dhe Britania e Madhe filloi përgatitjet për bisedime që të sigurojë një marrëveshje për marrëdhëniet e ardhme të saj me BE-në, anëtare e së cilës ishte për 40 vjet. Askush nuk e priti një rezultat të këtillë, por përplasjet e vazhdueshme në këto vite anëtarësie nuk krijuan mundësi që Britania e Madhe të ndjehej e qetë me anëtarësimin e saj në projektin european më të suksesshëm ndonjëherë.

6. Suksesi i referendumit për Brexit-in shkaktoi tronditje dhe paqartësi të mëdhaja në Britaninë e Madhe, por jo edhe aq në Bashkimin European. Në radhë erdhi mënyra se si palët do të merren vesh për marrëdhëniet dypalëshe tregtare dhe për bashkëpunimin në sferat tjera. Ndarja duhej patjetër ta kishte një marrëveshje sipas së cilës do të zhvilloheshin marrëdhëniet e ardhme tregtare dhe bashkëpunimi ndërmjet Britanisë së Madhe dhe BE-së. Nuk është e lehtë të dilet aq kollaj nga një familje e madhe ku britanikët qëndruan për një periudhë të gjatë sepse kjo sjell pasoja të veta në të gjitha sferat e rregullimit shtetëror. Për më tepër, Britania e Madhe këmbënguli për një marrëveshje nga e cila nuk do të dalë humbëse. Ajo i shfrytëzoi mirë kërcënimet për një dalje pa marrëveshje. Zhvillimi i bisedimeve tregoi se palët nuk e konsideruan aspak njëra-tjetrën, edhe pse ‘bashkëjetuan’. Si Britania e Madhe, ashtu edhe BE-ja u futën në bisedime për të mbrojtur pozitat e tyre, tashmë përballë njëra-tjetrës, si dy palë sovraane, por duke pasur kujdes që të mos kalohet në armiqësim sepse kanë nevojë për njëra-tjetrën. Bisedimet u zhvilluan në kohë pandemie të shkaktuar nga Covid-19, por që ky virus nuk ndikoi në rezultatin përfundimtar. Pas shumë bisedimesh, Britania e Madhe dhe BE-ja e nënshkruan Marrëveshjen e tregtisë dhe të bashkëpunimit. Palët janë ndarë të kënaqura, por çfarë rezultati do të sjellë zbatimi i saj, mbetet të shihet nga 1 janari 2021. Zhvillimet e mëtejshme, si dhe pasojat – pozitive apo negative – të kësaj marrëveshje mbetet të studiohen në ndonjë rast tjetër.

Bibliografia

Fontaine, P. (2010). *Europe in 12 lessons*, Luxembourg: Publication Office of the European Union

REPERES – module 8-0 – explanatory notes – *Birth of the European Union and chronology of the integration* – EN Author & ©: Richard Stock, European Network for Education and Training (EUNET), 2011 English translation: Julie Gratz, Centre européen Robert Schuman

James, W. (2006). *History of the European Union*, CIVITAS Institute for the Study of Civil Society 2015

Handrlica, J. (2018). *The Splendid Durability of the Provisional: A Tribute to Euratom*, in Croatian Yearbook of European Law&Policy 14 (2018)

Siddappa Honnapura, V. (2016). *The Relationship between UK and the European Union: From 1945 to BREXIT*, in Romanian Journal of Social Sciences (RJSS), 2016

Ludlow, P. (2016). *Revisiting the first UK application to the EEC: Does Harold Macmillan's predicament have any relevance to today's debate?*, in Mile End Institute: *Britain and the European Union: Lessons from History*, London 2016

Perisic, B. (2010). *Britain and Europe: a History of Difficult Relations*, Institute for Cultural Diplomacy, Berlin 2010

London Chamber of Commerce and Industry. (2013). *Help or Hindrance? The value of EU membership to London business*, London 2013

Ronek, G. (2013). *Britain's Membership in the European Communities and the European Union*, in POLISH POLITICAL SCIENCE VOL XLII 2013, Poland 2013

GED Study, *Costs and benefits of a United Kingdom exit from the European Union*, Bertelsmann Stiftung, Germany 2015

Baker, D. (2001). *Britain and Europe: The Argument Continues*, in Hansard Society for Parliamentary Government 2001 *Parliamentary Affairs* (2001), 54

Oliver, T. (2015), *Europe's British question: the UK–EU relationship in a changing Europe and multipolar world*, in *Global Society*, 29 (3)

Clemens, B. (2014), *IEA Brexit Prize: Britain outside the European Union*, London 2014

- Taylor, G. (2017), *UNDERSTANDING BREXIT, Why Britain Voted to Leave the European Union*, 2017
- Möller, A; Oliver, T. (2014). *The United Kingdom and the European Union: What would a “Brexit” mean for the EU and other States around the World?*, DGAPanalyse, 2014
- House of Commons Treasury Committee. (2016), *The economic and financial costs and benefits of the UK’s EU membership*, First Report of Session 2016–17, 2016
- Oliver, T. (2013). *Europe without Britain, Assessing the Impact on the European Union of a British Withdrawal*, SWP Research Paper, Berlin 2013
- Mix, E, D. (2020). *The United Kingdom: Background, Brexit, and Relations with the United States*, 2020, Congressional Research Service
- Ford, R; Goodwin, M. (2017). *Britain After Brexit: A Nation Divided*, Journal of Democracy 28 (January 2017)
- Beg, I. (2016), *Brexit: Why, What Next and How?*, Brexit: Why, What Next and How? CESifo Forum 2/2016 (June)
- Hobolt, S. (2016). *The Brexit vote: a divided nation, a dividend continent*, Routledge 2016, Journal of European Public Policy, 23 (9)
- Abrams, D; Travaglino, A, G. (2018), *Immigration, political trust, and Brexit – Testing an aversion amplification hypothesis*, British Journal of Social Psychology, April 2018, Volume 57
- Ries, P. C; Hafner, M; Smith, D. T; Burwell, G. F; Egel, D; Han, E; Stepanek, M; Shatz, J. H. (2017), *After Brexit, Alternate forms of Brexit and their implications for the United Kingdom, the European Union and the United States*, RAND Europe
- Addler-Nissen, R; Galpin, C; Rosamond, B. (2017). *Performing Brexit: How a post-Brexit world is imagined outside the United Kingdom*, The British Journal of Politics and International Relations 2017, Vol. 19(3)
- Wolff, B, G. (2019). *The implications of a no-deal Brexit: is the European Union prepared?*, Bruegel, Policy Contribution Issue 2, January 2019
- Mix, E. D. (2020). *Brexit: Status and Outlook*, Congressional Research Service
- Wel, M; Wessel, A, R. (2017). *The Brexit Roadmap: Mapping the Choices and Consequences during the EU/UK withdrawal and Future Relationship Negotiations*, CLEER Papers 2017/5
- Niblet, R. (2015). *Britain, Europe and the World: Rethinking the UK’s Circles of Influence*, Chatham House, London

Mariani, P; Sacerdoti, G. (2019). *Brexit and trade issues*, European Journal of Legal Studies, Special Issue

Haider Ali Zaidi, S; Xin-Yu, W; Ahmed, S; UR Rehman, S; Sajid, M; Hossein Foroozanfar, M; Ashraf Ali, M. (2017). *Brexit: A review of impact on future of United Kingdom outside the European Union*, IJMRM International Journal of Modern Research in Management

Tetlow, G; Stojanovic, A. (2018). *Understanding the economic impact of Brexit*, Institute for Government

Dhingra, S; Ottaviano, G; Sampson, Th; Van Reenen, J. (2016). *The impact of Brexit on foreign investment in the UK*, CEP BREXIT ANALYSIS No. 3

Ondarza, N. (2020). *The Brexit Revolution New Political Conditions Change the Dynamics of the Next Phase of EU-UK Negotiations*, SWP Comment No. 13

Mix. E, D. (2020). *The United Kingdom: Background, Brexit, and Relations with the United States*, 2020, Congressional Research Service

Mix. E, D; Akhtar Ilias, Sh; Archick, K. (2020). *Brexit: Status and Outlook*, 2020, Congressional Research Service

Möller, A; Oliver, T. (2014). *The United Kingdom and the European Union: What would a "Brexit" mean for the EU and other States around the World?*, DGAPanalyse, 2014

Felbermayr, G; Fuest, C; Gröschl, J; Stöhlker, D. 2017. *Economic effects of Brexit on the European Economy*, Econpol Policy Report

Eeckhout, P. (2018). *Future trade relations between the EU and the UK: options after Brexit*, Policy Department, Directorate-General for External Policies

Government of Ireland. (2020). *Preparing for the end of the transition period, Brexit Readiness Action Plan*

Bank of England. (2020). *UK withdrawal from the EU: Changes before the end of the transition period*, Bank of England Consultation Paper | PRA Consultation Paper CP13/20

Owen, J; Jack, Th, M; Wright, G; Sargeant, J; Stojanovic, A; Etherington, H. (2020). *Getting Brexit done What happens now?*, Institute for Government Insight

Ahad, A; Andriescu, M. (2020). *Brexit on the Backburner Citizens' rights and the implementation of the withdrawal agreement in a pandemic*, Migration Policy Institute Europe

Lawlor, D; Halligan, A. (2020). *Brexit negotiations – progress to date and next steps*, Oireachtas Library & Research Service | L&RS Note

IP/02/898, “*Fifty years at the service of peace and prosperity: the European Coal and Steel Community (ECSC) treaty expires*”, Brussels, 19 June 2002,
https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_02_898

FACT SHEETS ON THE EUROPEAN UNION, *The historical development of European integration*, 18 June 2018,
[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/PERI/2018/618969/IPOL_PERI\(2018\)618969_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/PERI/2018/618969/IPOL_PERI(2018)618969_EN.pdf)

Enlargement of the European Union An historic opportunity, 2001,
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/archives/pdf/press_corner/publications/corpus_en.pdf

Jeet, H. *Britain’s Long, Tortured Relationship With Europe*, June 24, 2016,
<https://newrepublic.com/article/134642/britains-long-tortured-relationship-europe>

Haagedoorn, S. (2017), *The historical evolution of EU-UK relations*,
<https://www.consilium.europa.eu/fr/documents-publications/library/library-blog/posts/the-historical-evolution-of-eu-uk-relations/>

Skidelsky, R. (2018). *The UK was never truly part of the European Union*,
<https://www.fnlonon.com/articles/britain-was-never-truly-part-of-the-eu-20180717>

Moris, C. *12 big moments in the UK-EU relationship*,
https://www.bbc.co.uk/news/extra/D6MgynFwGo/12_big_moments_in_UK_EU_relationship

A growing Community – the first Enlargement, https://europa.eu/european-union/about-eu/history/1970-1979_en

Kirby, J. *A short history of the long road to Brexit*,
<https://www.vox.com/2020/1/31/21083573/brexit-news-boris-johnson-timeline-eu-uk>

Wilson, S. *Britain and the EU: A long and rocky relationship*, (2014)
<https://www.bbc.com/news/uk-politics-26515129>

Mackenzie, L. *Britain and the EU: The History of a Not So Special Relationship*, 2018,
<https://www.historyhit.com/britain-and-the-eu-the-history-of-a-not-so-special-relationship/>

Nugent, C. (2019). *It's Complicated: From the Roman Empire to Brexit, Britain Has Always Struggled to Define Its Relationship With Europe*, <https://time.com/5563689/britain-europe-relationship-history/>

Ababaker, A; Njilo, G; Chima, A. (2019), *The Impact of Brexit on the Future of the European Union*, 2019,

https://www.researchgate.net/publication/330637924_The_Impact_of_Brexit_on_the_Future_of_the_European_Union

Curtice, J; Evans, G. *Britain and Europe Are we all Eurosceptics now?*, British Social Attitude 32, NatCen Social Research, https://www.bsa.natcen.ac.uk/media/38975/bsa32_eu.pdf

Leonard, M. (2015). *The British problem and what it means for Europe*, London 2015, European Council on Foreign Relations/128, https://ecfr.eu/publication/the_british_problem_and_what_it_means_for_europe311252/

Huton, R. (2019), *The roots of Brexit*, <https://www.bloomberg.com/quicktake/will-uk-leave-eu>

Mueller, B. (2019). *What Is Brexit? A Simple Guide to Why It Matters and What Happens Next*, <https://www.nytimes.com/interactive/2019/world/europe/what-is-brexit.html>

Curtice, J. *The vote to leave the EU*, British Social Attitude 34, NatCen Social Research, https://www.bsa.natcen.ac.uk/media/39149/bsa34_brexit_final.pdf

Henley, J. (2018). *Theresa May's Brexit deal: everything you need to know*, <https://www.theguardian.com/politics/2018/nov/14/theresa-mays-brexit-deal-everything-you-need-to-know>

Crerar, P; Weaver, M. (2018). *McVey and Raab quit as May addresses MPs over Brexit deal*, <https://www.theguardian.com/politics/2018/nov/15/dominic-raab-quits-as-brexit-secretary-over-eu-withdrawal-deal>

Theresa May resigns over Brexit: What happened? (2019). <https://www.bbc.com/news/uk-politics-48379730>

Stewart, H. (2019). *Brexit: MPs pass withdrawal agreement bill by 124 majority*, <https://www.theguardian.com/politics/2019/dec/20/brexit-pm-asks-britons-to-move-on-as-mps-debate-withdrawal-bill>

Brexit: European Parliament overwhelmingly backs terms of UK's exit, <https://www.bbc.com/news/uk-politics-51287430>

Menon, A; Armstrong, A; Barnard, C; Begg, I; Portes, J. *A successful Brexit: Four Economic Tests*, The UK in a changing Europe, <https://www.piie.com/system/files/documents/a-successful-brexit-four-economic-tests.pdf>

Oliver, T. (2016). *What impact would a Brexit have on the EU?*, Dahrendorf Analysis, https://www.dahrendorf-forum.eu/wp-content/uploads/2016/03/Dahrendorf-Analysis_Brexit_Tim_Oliver.pdf

The UK in a Changing Europe. (2020). *Brexit: what next?*, <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2020/02/Brexit-what-next-report.pdf>

Government of Netherlands. (2020). *General overview of the Brexit transition period*, <https://www.government.nl/documents/publications/2020/08/20/graphic-overview-of-brexit-preparations-in-the-netherlands>

The UK in a Changing Europe. (2016). *Brexit: six months on*, <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2016/12/Brexit-Six-months-on.pdf>

Leonard, M. (2015). *The British problem and what it means for Europe*, London 2015, European Council on Foreign Relations/128, https://ecfr.eu/publication/the_british_problem_and_what_it_means_for_europe311252/

CBI. (2016). *MAKING A SUCCESS OF BREXIT, A WHOLE-ECONOMY VIEW OF THE UK-EU NEGOTIATIONS*, <https://www.cbi.org.uk/media/1234/cbi-making-a-success-of-brexit.pdf>

European Movement International, *The consequences of a British exit from the European Union*, https://europeanmovement.eu/wp-content/uploads/2016/05/EMI_16_PolicyPosition_Brexit_17_VIEW_FINAL.pdf

Fedex Express, *Brexit: your 2021 checklist, How to prepare your business for the end of the transition period*, https://www.fedex.com/content/dam/fedex/eu-europe/brexit/checklist/FedEx_Brexit_Checklist_2021_EN_GB.pdf

Greater London Authority, (2018). *Preparong for Brexit*, Cambridge Econometric Final Report, https://www.london.gov.uk/sites/default/files/preparing_for_brexit_final_report.pdf

The UK in a Changing Europe, 2020. *Brexit: what next?*, <https://ukandeu.ac.uk/wp-content/uploads/2020/02/Brexit-what-next-report.pdf>

Deloitte. (2020). *Brexit: The transition period and beyond, Define your future*, <https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/uk/Documents/international-markets/deloitte-uk-2020-brexit-impact-assessment-framework.pdf>

Dentons. (2020). *After Brexit: Navigating a new world*, https://www.dentons.com/-/media/pdfs/collateral/brexit-after_brexit.pdf?la=en

Salesforce. (2020). *Brexit Considerations around Salesforce's Data Flows*, https://www.salesforce.com/content/dam/web/en_us/www/documents/legal/misc/brexit-faqs.pdf

Brexit Brief Issue 82. (2020). The Institute of International and European Affairs, https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/03/BrexitBrief_82.pdf

Barochez, H. (2020). *Brexit: Time is running out to reach to reach an agreement*, Eco Flash 20-19, <https://economic-research.bnpparibas.com/Views/DisplayPublication.aspx?type=document&IdPdf=39439>

Brexit Brief Issue 96. (2020). The Institute of International and European Affairs, https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/10/BrexitBrief_96.pdf

Brexit Brief Issue 97. (2020). The Institute of International and European Affairs, https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/11/BrexitBrief_97.pdf

Brexit Brief Issue 98. (2020). The Institute of International and European Affairs, https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/11/BrexitBrief_98.pdf

Brexit Brief Issue 99. (2020). The Institute of International and European Affairs, https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/12/BrexitBrief_99.pdf

Brexit Brief Issue 100. (2020). The Institute of International and European Affairs, https://www.iiea.com/wp-content/uploads/2020/12/BrexitBrief_100.pdf

O'Carroll, L. (2020). *UK drops plans to break international law as Northern Ireland deal is reached*, 8 dhjetor 2020. <https://www.theguardian.com/politics/2020/dec/08/brexit-uk-drops-plans-to-break-international-law-as-northern-ireland-deal-is-reached>

Campbell, J. (2020). *Brexit: UK and EU announce agreement on new Irish Sea border*, 17 dhjetor 2020. <https://www.bbc.com/news/uk-northern-ireland-55354451>

Simpson, C. (2020). *Last-minute Brexit deal reached on Northern Ireland border checks*, 9 dhjetor 2020. <https://www.irishnews.com/news/northernirelandnews/2020/12/09/news/last-minute-brexit-deal-reached-on-northern-ireland-border-checks-2154979/>

Brexit: EU offer 'unacceptable' as trade talks continue, 13 dhjetor 2020, <https://www.bbc.com/news/uk-politics-55290109>

Brexit trade talks: UK and EU to 'go the extra mile' in effort to agree deal, 13 dhjetor 2020. <https://www.bbc.com/news/uk-politics-55292890>

Boffey, D; Henley, J. (2020). *Brexit trade deal possible within days after Johnson concession, says EU*, 14 dhjetor 2020. <https://www.theguardian.com/politics/2020/dec/14/brexit-trade-deal-possible-within-days-after-johnson-concession-says-eu?fbclid=IwAR09QuDm1Nr5Wb0rykddyZ7NG791iIR0DCkJa2SjnK-fY0txtYaSslBFXIE>

Brexit: Trade talks in 'a serious situation' says Boris Johnson, (17 dhjetor 2020). <https://www.bbc.com/news/uk-politics-55347723?fbclid=IwAR09QuDm1Nr5Wb0rykddyZ7NG791iIR0DCkJa2SjnK-fY0txtYaSslBFXIE>

Just a few hours' left to agree Brexit trade deal, says Michel Barnier, (18 dhjetor 2020). <https://www.bbc.com/news/uk-politics-55358963>

Boffey, D; O'Carrol, L. (2020). *UK and EU agree Brexit trade deal*, (24 dhjetor 2020). <https://www.theguardian.com/politics/2020/dec/24/uk-eu-agree-brexit-trade-deal-agreement>

Boffey, D. (2020). *EU states unanimously back Brexit trade and security deal*, (28 dhjetor 2020). <https://www.theguardian.com/politics/2020/dec/28/eu-member-states-unanimously-back-brexit-trade-security-deal?fbclid=IwAR0vkLRwA1Ka4mcmHSDhUwO6r5mUJOyzKkzMBb3qCAKXGuLuUyXg7ZZbkU>

James, W; Baczynska, G. (2020). *UK parliament approves Brexit trade deal with EU as both sides look to future*, (30 dhjetor 2020). https://www.reuters.com/article/uk-britain-eu-idUSKBN2940UZ?fbclid=IwAR1PO3bPkSU6Ya4tbo4IlctFyK4G_iCaoqTzIboWB1cjys1QNnqxy738Nto

Brexit trade deal: History is made as EU chiefs and UK PM sign agreement on future relationship, (30 dhjetor 2020). https://www.euronews.com/2020/12/29/eu-and-uk-leaders-to-sign-post-brexit-trade-deal-on-wednesday-morning?fbclid=IwAR3Tm3TrzOUOxEZtjIqNxi7_hBdY7G3qzAOjUG0HG0Kxi7SeUC_U2BTXXCk